



**INSTITUCIONI I OMBUDSPERSONIT në KOSOVË**

## **RAPORTI I KATËRT VJETOR**

**2003 – 2004**

**drejtuar**

**Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm  
të Kombeve të Bashkuara**

**12 korrik 2004**

**Telephone: ++381 38 545 303**

**Telefax: ++381 38 545 302**

**e-mail: [ombudspersonkosovo@ombudspersonkosovo.org](mailto:ombudspersonkosovo@ombudspersonkosovo.org)**

**web site: [www.ombudspersonkosovo.org](http://www.ombudspersonkosovo.org)**

## PARATHËNIE

Ky është raporti i katërt vjetor që po i dorëzohet Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Puna ime si Ombudsperson ndërkombëtar gjatë katër viteve të fundit, që nga korriku i vitit 2000, ka qenë shumë sfiduese. Me kërkesë të z. Harri Holkeri, jam pajtuar që në Kosovë të qëndroj edhe një vit.

Ky vit do të jetë shumë i rëndësishëm. Në vitin 2005, bashkësia ndërkombëtare do të bëjë vlerësimin e parë të gjërë të progresit që është arritur në Kosovë gjatë procesit të gjatë plot me pengesa të mëdha që kishte për qëllim ndërtimin e një shoqërie moderne dhe demokratike. Kjo shoqëri do të duhej ta respektojë sundimin e ligjit ku respektohen të gjitha të drejtat dhe liritë themelore, duke përfshirë edhe të drejtat e pakicave kombëtare dhe etnike.

Institucioni i Ombudspersonit do të ketë një rol të rëndësishëm si vëzhgues i pavarur dhe mbikëqyrës i rreptë i veprimeve të ndërmarra nga ana e autoriteteve kosovare. Do të duhej të theksohet që një pjesë e “standardeve për Kosovën” përbëhet nga fushat dhe problemet të cilat, në të njëjtën kohë, janë nën juridikcionin e Ombudspersonit.

Raporti i katërt vjetor paraqet një vlerësim përmbledhës të situatës në fusha të caktuara që janë me rëndësi të posaçme nga pikëpamja e të të drejtave të njeriut ashtu si shihen nga perspektiva e Ombudspersonit në Kosovë.

Raporti gjithashtu ofron informata mbi juridikcionin, strukturën momentale dhe aktivitetet e Institucionit të Ombudspersonit dhe perspektivat e tij për të ardhmën. Institucioni është duke u zhvilluar dhe ndikimi dhe kontrolli i tij duke u rritur krahas me numrin e njerëzve që i drejtohen atij me ankesa apo kërkesa për ndihmë. Stafi i Institucionit bën çdo përpjekje për të iu përgjegur në mënyrën më të mirë të mundshme secilit që i qaset zyrës sonë në Prishtinë apo ndonjëherë nga zyret rajonale. Ombudspersoni takohet me shumë njerëz personalisht ose në Prishtinë ose duke udhëtuar në vende të ndryshme në Kosovë.

Një numër në rritje e sipër i ankesave dhe problemeve kanë të bëjnë me institucionet për vetëqeverisje së përkohshme. Shpresoj që do të përmirësohet bashkëpunimi jonë me këto institucione dhe në të njëjtën kohë edhe reagimi i tyre ndaj komenteve dhe rekomandimeve tona. Përkundër një përparimi të arritur, kjo gjithashtu vlen edhe për bashkëpunimin tonë me UNMIK-un, posaçërisht pas ngjarjeve të marsit 2004.

Do të nevojitet shumë punë për të arritur së paku nivelin minimal të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut në Kosovë.

Kosova është ende larg nga arritja e këtyre standardeve. Situata është posaçërisht, por jo ekskluzivisht, e vështirë për komunitetet jo-shqiptare, në veçanti serbët dhe romët. Situata rreth garantimit të të drejtave themelore të tyre është shumë serioze. E vetmja shpresë është që ngjarjet e marsit të vitit 2004 dhe konkludimet e nxjerra do të ndihmojnë në ndryshime të konsiderueshme në këtë aspekt. Megjithatë, personalisht mbetem skeptik. Nuk mjafton të

rindërtohen shtëpitë e shkatërruara. Është shumë më vështirë të krijohet një besim së paku minimal, i cili është esencial për jetesën e përbashkët në territorin e njejtë.

Do të duhej që të gjithë ta kuptojmë që është e kotë të flitet për nivelin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut nëse një pjesë e madhe e banorëve të këtij rajoni, aq të keqtrajtuar nga historia, ende nuk gëzojnë kushtet më themelore të jetës normale, posaçërisht sigurinë. Kjo ndodh për shkak të konfliktit etnik por gjithashtu edhe për shkak të situatës së rëndë ekonomike dhe mungesës së mbrojtjes adekuate sociale.

Një numër i madh i njerëzve nuk mund të kthehen në shtëpitë të cilat është dashur t'i lënë më ose pas vitit 1999. Shpesh takohem me këta njerëz. Ata jetojnë në vende të ndryshme të Kosovës dhe në Serbi dhe Mal të Zi. Ata kanë të drejtë të kthehen dhe duhet të krijohen kushtet adekuate për këtë. Të drejtë kanë edhe familjet e qindra personave të zhdukur të kërkojnë të dijnë çfarë u ka ndodhur anëtarëve të familjeve të tyre. Për këta njerëz, secila ditë e pritjes dhe shpresës për kthimin e familjarëve të tyre është më shumë se e tepërt.

Këto dhe shumë probleme tjera janë thelbi i interesimit dhe brengave të përditshme të Ombudspersonit në Kosovë. Edhe pse është e vështirë të jesh optimist dhe të shihen ndryshimet në të mirë, puna dhe roli jonë ka pasur rëndësi të madhe. Njerëzve të Kosovës u nevojitet Institucioni i Ombudspersonit për shkak se, siç u shpreh një nga e mi bashkëbiseduesit e mi të parë qysh në vitin 2000, falë ekzistimit dhe veprimeve tona ata ndihen më pak të braktisur dhe të lënë vetëvehtes.

Marek Antoni Nowicki  
Ombudspersoni në Kosovë

Korrik, 2004

## **HYRJJE**

Ky Raport vjetor është publikuar në pajtim me Nenin 17.1 të Rregullores Nr. 2000/38 të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) mbi Themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, dhe Rregullën 22.1 të Rregullave procedurale të Institucionit të Ombudspersonit.

Raporti katërt vjetor mbulon vitin e tretë të plotë të veprimeve të Ombudspersonit, nga 1 korriku 2003 deri më 30 qershor 2004. Ai ka tri pjesë kryesore. Pjesa e parë është një prezantim i Institucionit të Ombudspersonit, stafit të tij dhe punës së tij. Pjesa e dytë përbën një analizë të shkurtër të aspekteve të caktuara të situatës së të drejtave të njeriut në Kosovë nga perspektiva e Ombudspersonit, kurse e treta ofron informata rreth aktiviteteve dhe veprimeve të Institucionit të Ombudspersonit gjatë periudhës për të cilën raportohet.

## FAKTE MBI INSTITUCIONIN E OMBUDSPERSONIT

### *Prezentim i Institucionit të Ombudspersonit*

I themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2000/38, Institucioni i Ombudspersonit është një institucion i pavarur, roli i të cilit është që të shqyrtojë çështjet që kanë të bëjnë me shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut apo keqpërdorim të autorizimeve nga administrata e përkohshme civile apo të çdo institucioni qendror ose lokal që do të krijohet. Institucioni i Ombudspersonit është hapur zyrtarisht më 21 nëntor 2000 dhe përbëhet nga Ombudspersoni, dy zëvendësit e tij vendor, juristët për të drejtat e njeriut dhe stafi përkrahës administrativ. Që nga fillimi më i hershëm, stafi i Institucionit të Ombudspersonit ka qenë multi-etnik – shumica e stafit është e përkatësisë etnike shqiptare, kurse pjesa tjetër janë të përkatësisë serbe, turke dhe rome.

Institucioni i Ombudspersonit pranon ankesa nga çdo person që beson të ketë qenë viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut apo keqpërdorimit të autorizimeve dhe zhvillon hetimet mbi këto ankesa. Gjuhët zyrtare të punës në Institucion janë gjuha shqipe, serbe dhe angleze. Institucioni do të përpiqet që t’u ofrojë ankuesve shërbimet në gjuhën e tyre edhe nëse kjo gjuhë nuk është një nga ato të lartëpërmendurat. Përmes punës së tij, Institucioni ndihmon në promovimin e të drejtave të njeriut dhe qeverisjes së mirë në Kosovë dhe jep kontribut që administrata të bëhet transparente dhe e hapur ndaj qytetarëve. Shërbimet e ofruara nga ana e Institucionit të Ombudspersonit janë falas.

Nëse informohet rreth një situatë ose veprimi që mund të ketë përfshirë një shkelje të të drejtave të njeriut, Ombudspersoni mund të hapë hetimet edhe në mungesë të ankesës individuale (të ashtuquajturat “hetime *ex officio* apo hetimet sipas detyrës zyrtare). Kompetencat e Ombudspersonit gjithashtu përfshijnë mbikqyrjen e veprimeve dhe ligjeve të aprovuara nga ana e autoriteteve për të siguruar që ato i respektojnë standardet e të drejtave të njeriut dhe kërkesat e qeverisjes së mirë. Me rastin e pranimit të një ankese ose nëse bindet që një situatë e caktuar kërkon veprim të menjëhershëm, Ombudspersoni fillon letërkëmbimin me autoritetet publike përkatëse që janë objekt i ankesës apo informatave që janë pranuar. Nëse problemi në fjalë nuk kërkon ndërmjetësim ose nuk mund të zgjidhet në mënyrë shoqërore, Ombudspersoni do të nxjerrë raportin pas hetimeve, në të cilin analizon nëse kishte pasur shkelje të të drejtave të njeriut të personave të ndikuar nga ai problem. Në rast se ka pasur shkelje të tillë, raporti i Ombudspersonit gjithashtu do të përmbajë rekomandimet e tij drejtuar PSSP-së si autoritet më i lartë civil në Kosovë, në të cilat do përshkruhet mënyra si të garantohet që në të ardhmën të garantohet pajtimi me të drejtat e njeriut. Në rastet kur Ombudspersoni konsideron që një praktikë ose situatë e përgjithshme ndikon jo vetëm në një individ ose një grup të tyre por në tërë qytetarët si tërësi dhe në të njëjtën kohë nuk është na pajtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ai do të nxjerrë të ashtuquajturin Raport Special, i cili gjithashtu do të përfshijë rekomandimet drejtuar PSSP-së.

Juridiksioni i Ombudspersonit është i kufizuar vetëm për Kosovë, që do të thotë që ai mund të hapë hetimet, të nxjerrë raportet apo të ndërmarrë hapa të tjerë vetëm në lidhje me sjelljen e autoriteteve publike në Kosovë. Në rastet që kanë të bëjnë me ankesat e kosovarëve drejtuar autoriteteve publike jashtë Kosovës, Ombudspersoni mund të ofrojë

shërbimet e tij të mira dhe/ose mund t'i përcjellë ato raste te Ombudsmani kompetent vendor ose ndonjë institucion tjetër i natyrës së njejtë në shtetin përkatës.

Gjithashtu, Ombudspersoni nuk zëvendëson gjykatën dhe nuk mundet që në mënyrë të drejtëpërdrejtë të hetojë krimet, ndryshojë aktvendimet e gjykatës apo të lëshojë vendime detyruese. Ombudspersoni nuk merret me kontestet mes administratës ndërkombëtare dhe stafit të saj apo me kontestet mes personave privatë. Ai nuk ka juridikcion mbi KFOR-in.

Rastet në të cilat kërkohet reagim i menjëhershëm janë të quajtuara “rastet për reagim” (Rastet CR) dhe zakonisht regjistrohen dhe arkivohen ndaras nga shkresat e rregullta të lëndëve që hetohen. Në raste të tilla, është më e rëndësishme që të intervenohet se sa të hapen hetimet në pajtim me procedurën e rëndomtë, edhe pse këto raste, në një fazë të mëvonshme, mund të bëhen rase të rregullta që hetohen dhe me këtë rast i nënshtrohen procedurës së rregullt.

### ***Ombudspersoni***

Ombudspersoni i tanishëm, z. Marek Antoni Nowicki, u emërua Ombudsperson në Kosovë më 11 korrik 2000, nga ana e z. Bernard Kouchner, PSSP në atë kohë, në pajtim me rekomandimin e Kryesuesit të rradhës të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE). Më 11 korrik 2002, z. Michael Steiner, PSSP i dikurshëm, e vazhdoi mandatin e z. Nowicki si Ombudsperson në Kosovë edhe për dy vite tjera deri më 10 korrik 2004. Më 26 maj 2004, z. Harri Holkeri, PSSP në atë kohë, e vazhdoi mandatin e Ombudspersonit edhe për një vit, deri më 10 korrik 2005.

Z. Nowicki ka lindur në vitin 1953 dhe është i nacionalitetit polak. Prej vitit 1987, është anëtar i Odës së Avokatëve të Polonisë. Ai ka një histori të gjatë të aktiviteteve për të drejtat e njeriut që filloi në vitin 1982, kur, gjatë periudhës së qeverisjes ushtarake në Poloni, veprroi si kolumnist i shtypit të rezistencës dhe bashkëpunëtor i lëvizjes “Solidarnosc”. Gjithashtu, në këtë kohë, z. Nowicki bashkë-themloi Komitetin e Helsinkit në Poloni. Gjatë periudhës mes 1990 – 1993, ai ishte anëtar i Komitetit Ekzekutiv të Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut (IHF) në Vienë, kurse gjatë 1992 – 1993 ishte ushtrues i detyrës së kryetarit të këtij Fondacioni.

Gjatë periudhës mes viteve 1993 – 1999, z. Nowicki ishte anëtar i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në Strazburg. Njëkohësisht me pozitën e tij si Ombudsperson në Kosovë, ai është kryetar i Fondacionit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Varshavë dhe anëtar i Rrjetit të Bashkimit Evropian të Ekspertëve të Pavarur për të Drejtat Themelore.

### ***Zëvendësit e Ombudspersonit***

Ombudspersoni ka dy zëvendës vendor, që e ndihmojnë në drejtimin e suksesshëm të punës së Institucionit të Ombudspersonit dhe e zëvendësojnë në mungesë të tij. Ata janë z. Ljubinko Todorovic dhe z. Hilmi Jashari.

Z. Ljubinko Todorovic është lindur në vitin 1951 në Graçanicë. Ai është emëruar zëvendës i Ombudspersonit më 15 shtator 2000 nga ana e z. Bernard Kouchner, PSSP i dikurshëm.

Posti i tij si zëvendës i Ombudspersonit është zgjatur disa herë, kurse herën e fundit më 14 mars 2004 nga ana e z. Harri Holkeri, PSSP në atë kohë.

Z. Todorovic diplomoi në Fakultetin Juridik në Prishtinë më 1981. Më 1991, ai dha provimin e judikaturës. Ai tashmë ka punuar në profesione të ndryshme. Mes tjerash, z. Todorovic ka qenë përfaqësues ligjor i një korporate, inspektor pune dhe avokat publik i vetëqeverisjes për komunën e Prishtinës. Ai gjithashtu ka qenë sekretar i Bordit Ekzekutiv të Këshillit Komunal të Prishtinës, si dhe sekretar i Këshillit Komunal të Prishtinës.

Para vendosjes së Administratës Ndërkombëtare të UNMIK-ut në Kosovë, z. Todorovic ka punuar si drejtor në Qendrën Gjjeriatrike në Prishtinë.

Z. Hilmi Jashari është lindur në vitin 1969 në Mazgit. Ai u emërua zëvendës i Ombudspersonit më 14 mars 2004 nga ana e z. Harri Holkeri, PSSP në atë kohë.

Z. Jashari diplomoi në Fakultetin Juridik në Prishtinë më 1993 dhe filloi të punojë si sekretar i Këshillit për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut në Obiliq. Pas vitit 1994, ishte i përfshirë në aktivitetet e shoqatave të ndryshme shqiptare nga jashtë vendit. Mes viteve 1996 – 1998, z. Jashari punoi si asistent ligjor në zyrën e një avokati në Prishtinë. Ai është duke punuar në Institucionin e Ombudspersonit prej fillimit të punës së tij në tetor të vitit 2000 dhe ka qenë drejtor i hetimeve prej korrikut të vitit 2001.

### ***Qasja në Institucionin e Ombudspersonit***

Qasja në Institucionin e Ombudspersoni është ofruar përmes zyrës qendrore në Prishtinë dhe zyreve rajonale në Gjilan, Pejë, Mitrovicë dhe Prizren, të cilat janë kryesisht të përbëra nga dy juristë dhe një asistent ligjor/përkthyes. Zyra rajonale në Mitrovicë gjithashtu ka nënzyrën e saj në pjesën veriore të qytetit. Të gjitha zyret janë nër përgjithësi të hapura ditëve të javës mes 8:30 – 17:30. Juristët e zyreve rajonale rregullisht vizitojnë komunat, enklavat, zonat në të etnicitete të konsiderueshme joshqiptare, si dhe burgjet dhe qendrat e paraburgimit në komunat e rajoneve të tyre përkatëse. Orari i tyre është i rregulluar në atë mënyrë që çdo vend i tillë të vizitohet së paku një herë në muaj, kurse burgjet dhe qendrat e paraburgimit të vizitohen çdo dy javë.

Çdo muaj, organizohen Ditët e Hapura në komunat e Prishtinës, Gjilanit, Pejës, Mitrovicës, Prizrenit dhe Gjakovës. Këto Ditë të Hapura ua mundësojnë ankuesve të takohen personalisht me Ombudspersonin dhe, në rastë të veçanta, me zëvendësit e tij. Në zyrën qendrore në Prishtinë, Dita e Hapur organizohet çdo të enjte të dytë. Në komunat tjera të përmendura më lart, banorët informohen rreth datave të këtyre Ditëve të Hapura përmes listave që publikohen në ndërtesat e komunave të ndryshme dhe përmes lajmërimeve në mediat lokale. Ombudspersoni dhe zëvendësit e tij gjithashtu vizitojnë personalisht vende të ndryshme të Kosovës edhe në raste tjera. Njëkohësisht, juristët e zyrës qendrore vizitojnë rregullisht vendet afër Prishtinës të cilat nuk kanë zyret e tyre rajonale, siç janë Lipjani, Gllogovci apo Graçanica, për t'u takuar me banorët e këtyre vendeve dhe për të mbledhur ankesat e tyre.

Komunikimi mes Ombudspersonit dhe kosovarëve që janë duke qëndruar përkohësisht në Serbi dhe në masë më të vogël në Mal të Zi është përmirësuar përmes bashkëpunimit me Këshillin Norvegjez për Refugjatë, si dhe përmes marrëveshjes së nënshkruar mes

Ombudspersonit dhe Organizatës humanitare spanjolle “Movimento por la Paz, el Desarme y la Libertad (Lëvizja për Paqë, Çarmatosje dhe Liri – MPDL) me të cilën MPDL u pajtua të ndihmojë aplikantët në plotësimin e formularëve të ankesës dhe kontaktimin me Institucionin e Ombudspersonit.

Duke marrë parasysh kufizimet në qasje të vendosura mbi personat e burgosur dhe të paraburgosur në Kosovë, përfaqësuesit e Institucionit të Ombudspersonit vizitojnë rregullisht burgjet dhe qendrat e paraburgimit në mbarë Kosovën. Gjatë periudhës për të cilën raportohet, Institucioni i Ombudspersonit, në bashkëpunim me autoritetet kompetente të burgjeve, gjithashtu ka vendosur kuti postale speciale në të gjitha burgjet dhe qendrat e paraburgimit në Kosovë, duke ua mundësuar të burgosurve dhe të paraburgosurve që ta kontaktojnë Institucionin e Ombudspersonit në mënyrë të drejtëpërdrejtë. Vetëm anëtarët e stafit të Institucionit të Ombudspersonit kanë qasje në këto kuti dhe i zbrazin ato rregullisht. Të burgosurit dhe të paraburgosurit ishin informuar rreth kësaj mundësie përmes një letre speciale që Ombudspersoni ua kishte dërguar të gjithë personave të burgosur apo të paraburgosur në të gjitha burgjet dhe qendrat e paraburgimit në Kosovë. Vendosja e këtyre kutive postale e përmirësoi në masë të madhe komunikimin mes Institucionit të Ombudspersonit dhe të burgosurve dhe paraburgosurve.

Një jurist i Institucionit të Ombudspersoni rregullisht viziton edhe Institucionin për Përkujdesje Sociale në Shtime.

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, ka pasur përpjekje të shtuara për ta informuar publikun për punën e Institucionit të Ombudspersonit. Një nga këto metoda ishte publikimi i një raporti periodik, i cili tani është i përhapur në tërë Kosovën në të gjitha gjuhët zyrtare në Kosovë, si dhe në gjuhën turke. Ky “Informator Periodik” do të shërbejë për të ofruar informata për ngjarjet dhe rastet më të rëndësishme pranë Institucionit të Ombudspersonit gjatë një periudhe kohore prej tre muajsh. Institucioni i Ombudspersonit ka nxjerrë publikimet e para të këtij lloji për tremujorin e parë dhe të dytë të vitit 2004. Ekzistojnë plane që raportet e këtilla në të ardhmën të publikohen çdo dy muaj.

Një hap tjetër në këtë drejtim ishte edhe përmirësimi i faqes në internet të Institucionit të Ombudspersonit, e cila përmban informata të përgjithshme mbi Insitucionin si dhe verzionet elektronike të të gjitha raporteve dhe informatave mbi aktivitetet e Ombudspersonit. Gjatë periudhës për të cilën raportohet, Ombudspersoni gjithashtu aktivizoi një linjë telefonike për raste urgjente që është funksionale 24 orë të ditës. Ende janë duke u bërë përpjekje që kjo linjë urgjente të bëhet falas për thirrësit.

## **ASPEKTE TË CAKTUARA TË SITUATËS SË TË DREJTAVE TË NJERIUT NË KOSOVË**

### ***Demokracia dhe qeverisja***

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, është vazhduar bartja e kompetencave dhe funksioneve të caktuara të UNMIK-ut në autoritetet qendrore dhe komunale në Kosovë. Megjithatë, UNMIK-u ende mban kontrollin mbi, mes tjerash, gjyqësinë, policinë dhe

legjislaturën. Derisa ka pasur përmirësime në disa sektore, pjesë të UNMIK-ut si duket ende nuk ndihen të jenë të obliguara t'i garantojnë seriozisht sa duhet të drejtat dhe liritë themelore popullatës së Kosovës. Sipas z. Harri Holkeri, ish-PSSP, “misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë ka vetëm një mandat: të garantojë realizimin e të drejtave të njeriut”. Kur merren parasysh problemet e vazhdueshme në lidhje me këtë pjesë të mandatit të UNMIK-ut, është vështirë që kjo deklaratë të merret seriozisht.

Duke marrë parasysh strukturën e UNMIK-ut, nuk duket edhe aq befasues dështimi i tij për të vepruar në pajtim me bazat e të drejtave të njeriut në të cilat është bazuar mandati i tij. Edhe pse sipas nenit 11 të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, detyrat kryesore të pranisë ndërkombëtare civile në Kosovë përfshijnë “organizimin dhe mbikëqyrjen e zhvillimit të institucioneve të përkohshme për një vetëqeverisje demokratike dhe autonome derisa të arrihet një zgjidhje politike”, vetë UNMIK-u nuk është i strukturuar në pajtim me parimet demokratike. Siç tashmë është kritikuar në Raportin e Dytë Vjetor, kur UNMIK-u u vendos si zëvendësim i shtetit, në vitin 1999, ai plotësisht injoroi njërin nga parimet themelore të demokracisë, respektivisht ndarjen e pushtetit. Pothuajse menjëherë pas emërimit të tij, PSSP nxjerri një Rregullore të UNMIK-ut e cila i mvesh atij pushtet total ekzekutiv dhe legjislativ dhe i lejon pushtet administrativ mbi gjyqësinë. Kjo mospërfillje e parimeve demokratike vazhdon të ketë ndikim negativ në funksionimin e misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe, mbi të gjitha, në ligjshmërinë demokratike të këtij misioni.

Deri më tani, as UNMIK-u, as IPVQ-të nuk kanë qenë në gjendje të përballen me paligjshmërinë e përgjithshme që momentalisht ekziston në Kosovë. Është shumë vështirë të anashkalohen pohimet e përhapura dhe të rënda për korrupsion në sektore të ndryshme të jetës publike, duke përfshirë edhe gjyqësinë. Një pengesë tjetër jashtëzakonisht serioze për vendosjen e sundimit të ligjit është krimi i organizuar që përfshin, duke mos qenë i kufizuar vetëm në to, edhe trafikimin e drogës dhe trafikimin e femrave për qëllime të prostitucionit brenda dhe nëpërmjet Kosovës. Përpyekjet e strukturave ndërkombëtare dhe qeverisë vendore për ta luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar që mbizotërojnë në Kosovë ende nuk kanë treguar rezultatet e pritura. Në të njëjtën kohë, strukturat e armatosura dhe ekstremizmi politik vazhdojnë të përbëjnë një faktor shqetësues të jetës publike në Kosovë. Nëse kjo do të vazhdojë apo jo varet nga ajo se sa me efikasitet do të luftohet ky fenomen, edhe politikisht, nga ana e Qeverisë dhe UNMIK-ut.

### *Zhvillimet në sektorin ligjor*

Fatkeqësisht, “kaosi ligjor” i përshkruar në Raportin e Tretë Vjetor nuk duket të jetë zvogëluar në ndonjë masë të madhe. Ende ekziston një konfuzion i përgjithshëm lidhur me atë se cilat ligje të RSFJ-së janë të aplikueshme e cilat jo, në veçanti për shkak të asaj se nuk ekziston ndonjë organ syprem gjyqësor që do të mund të nxjerrë konkludime lidhur me zbatueshmërinë dhe kushtetutësinë e një ligji të caktuar. Kjo çështje ka rëndësi të veçantë lidhur me ligjet e RSFJ-së që kanë hyrë në fuqi pas 22 marsit 1989 dhe të cilat, sipas nenit 1.2 të Rregullorës së UNMIK-ut nr. 1999/24 mbi Ligjin e Aplikueshëm në Kosovë, mund të jenë të aplikueshme nëse mbulojnë një çështje ose një situatë që nuk mund të është e mbuluar nga ligjet tjera në fuqi, nuk janë diskriminuese dhe janë në pajtim me standardet e njohura ndërkombëtare për të drejtat e njeriut e që janë të aplikueshme në Kosovë. Shikuar nga aspekti i përgjithshëm, është e vështirë të vendoset nëse një ligj i caktuar është diskriminues pasi që nuk ekziston ndonjë organ i pavarur gjyqësor që do ta bënte këtë.



Është e qartë që gjykatat e rregullta komunale dhe të qarkut nuk kanë kompetencë për të vendosur mbi çështje të tilla dhe nuk do të ishin në gjendje të marrin një qëndrim unik, i cili mund të garantohet vetëm nga ana e një Ode Kushtetuese të Gjykatës Supreme apo një Gjykate Kushtetuese, me ç'rast kjo e dyta do të ishte opcion më i preferuar. Edhe pse planet për ta formuar një organ të tillë janë të vjetra aq sa edhe vetë UNMIK-u dhe ekzistenca e një organi të tillë është e paraparë sipas Kapitullit 9.4.11 të Kornizës Kushtetuese, ky organ ende nuk është formuar.

Në të njejtën kohë, të gjitha ligjet e shpallura nga Kuvendi dhe të gjitha e UNMIK-ut përmbajnë një dispozitë përmbledhëse që thekson që ai ligj shfuqizon të gjitha ligjet tjera mbi të njejtën çështje. Këto formulime janë të zbehta dhe e lëvë opinionin në një errësirë lidhur me atë se cilat ligje po shfuqizohen nga ana e ligjit të ri dhe cilat po mbesin ende në fuqi. Kjo është në kundërshtim flagrant me parimin e sigurisë ligjore.

Siç tashmë është theksuar në Raportin e Tretë Vjetor, një ligj duhet që, sipas parimeve ndërkombëtare të sundimit të ligjit, të publikohet zyrtarisht para se të mund të konsiderohet të jetë në fuqi. Deri më këtë datë, ende nuk ekziston ndonjë procedurë zyrtare lidhur me publikimin e ligjeve në Kosovë, një problem që ishte ngritur në letrën që Ombudspersoni i dërgoi kryeministrit në fillim të marsit të vitit 2004. Deri më tani, Ombudspersoni nuk ka pranuar përgjegjje në këtë letër.

Standardet ndërkombëtare për ligjshmërinë e ligjeve kërkojnë që ligji duhet të ketë kualitetin adekuat, që do të thotë se, para së gjithash, ai duhet të jetë i qasshëm dhe i parashikueshëm, dy elementë që bashkohen për ta mbrojtur individin nga veprimet qeveritare arbitrare dhe për të ia mundësuar atij të rregullojë sjelljen e tij në pajtim me atë ligj. Deri me këtë datë, asnjë nga këto kërkesa nuk është përmbushur sa duhet nga ana e sistemit ligjor në fuqi, ku opinionin i gjërë as nuk është i vetëdijshëm për shumicën e ligjeve të aplikueshme në Kosovë.

Një nga arsytet për këtë qëndron në faktin që është vështirë të gjenden ligjet e RSFJ-së që ishin në fuqi para vitit 1989 dhe prandaj janë të aplikueshme sipas Rregullorës së UNMIK-ut nr. 1999/24 mbi Ligjin e Aplikueshëm në Kosovë, ashtu si është e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/59. Nuk ekzistojnë versione zyrtare në gjuhën angleze të këtyre ligjeve, edhe pse secili ligj duhet të jetë i publikuar në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Megjithatë, as ligjet e shpallura nga Kuvendi i Kosovës, as rregulloret e UNMIK-ut nuk e ndjekin këtë parim. Shpesh herë kalon shumë kohë derisa rregulloret të përkthehen në në gjuhën shqipe dhe serbe. Edhe kur ekzistojnë përkthimet e ligjeve dhe rregulloreve të lartpërmendura, kualiteti i përkthimit është aq i dobët sa që tekstet ligjore janë të pakuptueshme ose kanë një kuptim tjetër varësisht nga gjuha në të cilën janë përkthyer.

Gjatë tërë periudhës për të cilën raportohet, kanë qenë disa përpjekje për të përmirësuar publikimin dhe distribuimin e Rregullores së UNMIK-ut dhe ligjeve të nxjerra nga Kuvendi i Kosovës. Gjykatësit në tërë Kosovën e kanë informuar Ombudspersonin që ata tani janë duke pranuar rregulisht kopje të instrumenteve të tilla ligjore në formë të kompakt disqeve kompjutorike. Në të njejtën kohë, rregulloret e nxjerra nga UNMIK-u mund të gjenden në faqen e UNMIK-ut në internet kurse ligjet e shpallura nga Kuvendi i Kosovës mund të gjenden në faqen e Kuvendit në internet. Në qershor të vitit 2004, u bë funksionale një bazë e të dhënave në internet e ligjeve që kanë hyrë në fuqi prej të gjashtëdhjetave. Mementalisht, vetëm institucionet qeveritare dhe organizatat e caktuar mund t'i qasen kësaj

baze të të dhënave, por planifikohet që ajo që bëhet e qasshme edhe për opinionin e gjërë. Kur ky projekt njëherë të realizohet, kjo do të shënojë një përmirësim të konsiderueshëm në qasjen ndaj ligjeve në Kosovë.

Megjithatë, kjo zgjidh vetëm problemin e qasjes në ligje për një pjesë të vogël të popullsisë në Kosovë. Shumica e banorëve të krahinës nuk e gëzojnë luksin e qasjes në internet. Këta persona shpesh herë janë plotësisht të pavetëdijshëm për ligjet e reja dhe ndryshimet në ligjet e vjetra, pasi që ende është vështirë të sigurohen kopjet në formë të shtypur të rregulloreve të UNMIK-ut dhe ligjeve të shpallura nga ana e Kuvendit të Kosovës.

Përveç disa përjashtimeve, nuk është bërë ndonjë përparim i dukshëm lidhur me problemin e mungesës së periudhës vacatio legis, të përmendur në Raportin e Tretë Vjetor. Vacatio legis është periudha kohore prej shpalljes së një ligji e deri më kohën kur ai hyn në fuqi. Gjatë periudhës për të cilën raportohet, shumica e ligjeve dhe rregulloreve të UNMIK-ut hynë në fuqi më datën kur PSSP i shpalli ato. Kjo e bën të pamundshme që publiku më i gjërë të jetë i vetëdijshëm për ligjet e reja apo ndryshimet e ligjeve ekzistuese para se këto ligje të hyjnë në fuqi. Është shumë joreale që, në një vend si Kosova, ku pjesë të mëdha të popullsisë ende kanë vështirësi t'i qasen ligjeve në përgjithësi, të pritët që shumica e banorëve të jenë të vetëdijshëm për ndryshimet e ligjeve menjëherë pas hyrjes së tyre në fuqi. Praktika e vazhdueshme e injorimit të parimit të vacatio legis mund të ketë pasoja shumë të rënda praktike, në veçanti në rastet kur ligjet e reja apo të ndryshuara që hyjnë në fuqi më datën e shpalljes së tyre ndikojnë drejtëpërdrejtë në të drejtat dhe liritë e individëve ose kur ato vendosin obligime shtesë në individë apo grupe të personave.

Pa një periudhë adekuate të vacatio legis, jo vetëm individët, por edhe entitetet e ndryshme, duke përfshirë edhe insitucionet publike, nuk kanë kohë të përgatiten në atë mënyrë që të garantojnë zbatimin e duhur të ligjeve të reja apo të ndryshuara.

Një rasti shumë i njohur ku periudha vacatio legis zgjati nëntë muaj ishte hyrja në fuqi e Kodit të ri të Përkohshëm Penal dhe Kodit të Përkohshëm mbi Procedurën Penale, më 6 prill 2004. Këto kode ishin rezultat i punës trivjeçare të UNMIK-ut dhe ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtarë dhe paraqitën një zhvillim pozitiv ligjor. Përkundër të gjitha qëllimeve të mira, të dy kodet nuk u shpërndanë në mënyrë të mjaftueshme në Kosovë. Gjithashtu pati një pasivitet befasues nga ana e UNMIK-ut, që ishte inicijatori i vërtetë i këtyre ligjeve, për të informuar gjykatësit dhe prokurorët, si dhe opinionin e gjërë, për ndryshimet shpesh herë shumë ekstensive dhe praktike që do të sjellnin kodet e reja. Edhe po të ishin organizuar trajnimet për gjykatësit dhe prokurorët, kishte një mungesë e dukshme të përpjekjeve të përqëndruara adekuate nga ana e UNMIK-ut për të përgatitur gjykatësit dhe prokurorët për të zbatuar këto ligje.

Një problem tjetër lidhur me këto kode ishte që ato nuk i mbuluan të gjitha aspektet e sistemit penal të RSFJ-së që më nuk ishte në fuqi pas shpalljes së tyre. Një shembull i kësaj janë kërkesat dhe procedura për të vendosur kryerësit e veprave penale në gjendje të papërgjegjshmërisë ose papërgjegjshmërisë së pakësuar esencialisht nën mjekim të deturueshëm psikijatrik, që është një çështje që i referohet një një ligji të veçantë. Pasi që një ligj i tillë ende nuk është shpallur, nuk ka baza ligjore për të paraburgosur këtë kategori të personave.

Derisa Kodi i ri i Përkohshëm mbi Procedurën Penale parasheh formimin e një policie speciale gjyqësore që do të kryente detyra të caktuara të hetuesisë nën mbikëqyrjen e drejtëpërdrejtë të prokurorit publik, deri më tani nuk ka pasur përpjekje efikase sa duhet për të formuar një polici të tillë gjyqësore, as gjatë nëntë muajve të vacatio legis, as gjatë katër muajve prej kur ky kod ka hyrë në fuqi. Gjithashtu, ka një numër të pamjaftueshëm të prokurorëve dhe lokaleve përkatëse për të implementuar në mënyrë adekuate reformat e konsiderueshme në fazën e hetuesisë që janë të parapara me kodin e ri.

Derisa ligjet e lartpërmendura penale së paku kishin për qëllim të sjellin një reformë të nevojshme në sistemin ligjor penal në Kosovë, kjo fatkeqësisht nuk vlen për pjesë të tjera të sistemit ligjor që ende ka të meta.

Ende nuk ekziston ndonjë kornizë ligjore që garanton që secili person të drejtat e të cilit janë shkelur nga ana e autoriteteve publike mund të mbajë shtetin përgjegjës për këtë dhe të marrë kompenzimin përkatës.

Në të njejtën kohë, ende nuk ekziston asnjë ligj lidhur me ofrimin e kompenzimit personave që kanë qenë viktimë të krimeve të dhunës. Pasi që këta persona nuk janë invalidë të luftës dhe krimet e kryera kundër tyre nuk janë në lidhje me konfliktin e vitit 1999, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/66 mbi Beneficionet e invalidëve të luftës të Kosovës dhe për më të afërmit e tyre që kanë vdekur si pasojë e konfliktit të armatosur në Kosovë nuk është e aplikueshme për ta. Fatkeqësisht, pasi që gjatë periudhës për të cilën raportohet kanë ndodhur një numër i krimeve të tilla, është e rëndësishme së posaçme që këta persona që kanë qenë viktimë e tyre të pranojnë ndihmën adekuate financiare. Në shkurt dhe në fillim të marsit të vitit 2004, Ombudspersoni ngriti këtë çështje te PSSP i atëhershëm dhe te kryetari i Kuvendit të Kosovës. Deri më tani, nuk ka pasur përgjegjje në këtë letër. Në fund të marsit të vitit 2004, Ombudspersoni përsëri ngriti këtë çështje te kryetari i Kuvendit të Kosovës, duke theksuar që, duke marrë parasysh këto ngjarje, kjo çështje është bërë edhe më e rëndësishme dhe urgjente. Deri më tani, nuk ka pasur ndonjë përgjegjje në këto letra.

Në të njejtën kohë, përarësisht 10,000 serbë, prona e të cilëve është dëmtuar pas ardhjes së KFOR-it dhe UNMIK-ut në vitin 1999, kanë ngritur padi civile për kompenzim pranë gjykatave në Kosovë. Shtypi në Serbi vlerëson që rreth 20,000 – 50,000 padi tjera të tilla do të ngriten në një të ardhme të parashikueshme. Megjithatë, në shumë raste kur persona të tillë kanë dashur të ngritin padi të tilla pranë gjykatës, afati i parashkrimit për këto padi kishte kaluar ose mund të kalojë në ndonjë të ardhme të afërt. Në këto raste dhe në raste tjera të padive civile, paditësit shpesh herë nuk kanë mundur që më herët t'i qasen gjykatave kompetente në Kosovë, pasi që shpesh herë kishin qenë të detyruar të largohen nga shtëpitë e tyre pas konfliktit. Në këtë kohë, gjykatat në Kosovë gjithashtu kishin pushuar së funksionuari për periudha të caktuara kohore dhe zyrtarisht nuk e vazhduan punën e tyre për disa muaj, e në disa raste edhe më shumë se një vit. Prej përfundimit të konfliktit, situata e sigurisë në Kosovë e ka parandaluar një numër të madh të personave të lartpërmendur që t'i qasen gjykatave kompetente. Duke marrë parasysh këtë, në fillim të qershorit të vitit 2004, Ombudspersoni i dërgoi një letër ushtruesit të detyrës së PSSP-së për t'u informuar nëse mund të kishte ndonjë zgjidhje përmes së cilës ky grup i personave do të mund të ishte në gjendje që të vazhdojnë procedurën me paditë e tyre përkundër faktit që afatet përkatëse të parashkrimit kishin kaluar ose do të kalojnë së shpejti. Ombudspersoni theksoi që situata momentale do të mund të ngritë çështje lidhur me të drejtën e këtyre

personave për qasje në gjykatë sipas nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Deri më datën e këtij Raporti, ende nuk ka pasur përgjegje në këtë letër.

Ngjarjet e marsit të vitit 2004 gjithashtu zbuluan një mangësi tjetër të sistemit ligjor në Kosovë, respektivisht që ende nuk ka pasur përpjekje të pregtitet një ligj në mënyrë që të mbrohet trashëgimia kulturore, historike dhe natyrore e Kosovës. Në maj të vitit 2004, Ombudspersoni ngriti këtë çështje me kryeministrin e Kosovës dhe e nxiti atë që të garantojë që një ligj i tillë të pregtitet në mënyrë që kulturës dhe identitetit të përbashkët të Kosovës t'u jipet rëndësia që e meritojnë.

Shembuj tjerë të ligjeve që duhet shpallur në mënyrë që të ofrohet një nivel adekuat i mbrojtjes së të drejtave të njeriut por që ende nuk ekzistojnë në Kosovë janë një ligj i përgjithshëm mbi trajtimin e personave me mendje jo të shëndoshë dhe një ligj adekuat mbi tubimet publike që është në pajtim me të drejtën e lirisë së tubimit sipas nenit 11 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Megjithatë, të lartëpërmendurat nuk janë shembujt e vetëm për të theksuar situatën kaotike ligjore që ekziston sot në Kosovë. Një nga vështirësitë specifike në këtë krahinë është problemi që UNMIK-u si zëvendësim i shtetit deri më tani nuk ka arritur të sigurojë që dokumentet e lëshuara nga UNMIK-u të kenë autoritetet dhe validitet të plotë jashtë territorit të Kosovës. Nga një qeveri kërkohet që popullsisë së saj t'i mundësojë të lëvizë jashtë kufijve të saj, përmes të gjitha mjeteve ligjore të nevojshme. Pasi që UNMIK-u ka dështuar ta arrijë këtë qëllim, për çfarëdo arsye, ai ka krijuar një situatë absurde ku zyret paralele administrative të Serbisë, që nuk njihen nga UNMIK-u, e mbushin zbrazëtirën e lënë nga UNMIK-u duke u lëshuar banorëve të Kosovës dokumente që konsiderohen valide në Serbi dhe në shtetet tjera në rajon. Një shembull tipik i kësaj është lëshimi i patentë shoferit. Kështu, personat që dëshirojnë të vizitojnë të vizitojnë familjarët e tyre në Serbi, duke përfshirë këtu edhe pjesën jugore të Serbisë që është e banuar në masë të madhe me shqiptarë, janë të detyruar t'u drejtohen zyreve paralele të Serbisë për të marrë dokumentet përkatëse. Në shumë raste, këta persona janë bërë viktime të këtij standardi të dyfishtë dhe janë dënuar nga ana e gjykatave të Kosovës kur janë zënë me patentë shoferi të tilla derisa ishin duke kaluar nëpër territorin e Kosovës. Kjo krijon një situatë ku UNMIK-u si zëvendësim i shtetit në Kosovë i dënon personat e caktuar për shkak të dobësive ekzistuese dhe që i ka krijuar vetë UNMIK-u.

Asnjë shoqëri demokratike nuk mund të funksionojë pa një system ligjor funksional dhe transparent. Situata e tanishme është një pengesë serioze për administrimin e duhur të sundimit të ligjit në Kosovë.

### *Gjyqësia në Kosovë*

Sa i përket gjyqësisë në Kosovë, do të duhej të theksohet që, përkundër një progresi të arritur, problemet e theksuara në Raportin e Tretë Vjetor nuk janë përmirësuar në masë të madhe gjatë periudhës për të cilën raportohet, kështu që gjyqësia vendore është ende larg nga arritja e një niveli në të cilin do të mund të konsiderohej të jetë një aleat i mirë në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Për shkak të strukturës së lartëpërmendur jodemokratike të UNMIK-ut, është vështirë të flitet për një gjyqësi të pavarur në Kosovë. Administrimi i gjyqësisë është ende në duart e

ekzekutivit. Derisa PSSP është përgjegjës për emërimin dhe shkarkimin e gjykatësve dhe prokurorëve, administrimi i gjykatave bëhet nga ana e Departamentit të Administratës Gjyqësore, që është pjesë e Ministrisë së Shërbimeve Publike. Kështu, ekzekutivit i janë lënë të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me lokalet e gjykatave dhe pagat, jo vetëm të stafit të gjykatës, por edhe në një masë të gjykatësve. Me këtë rast, si ekzekutivi ndërkombëtar ashtu edhe ai vendor kanë një sasi të tepruar dhe jo të shëndoshë të ndikimit në gjyqësinë vendore, gjë që përsëri vë në pyetje ekzistimin e një gjyqësie të pavarur.

Siç e ka theksuar kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës, sistemi gjyqësor vazhdon të përballet me së paku tri probleme kryesore: mungesën e legjislacionit përkatës lidhur me administrimin e gjyqësisë, mungesën e praktikës së qëndrueshme për seleksionimin dhe filtrimin e gjykatësve profesional dhe pagat jashtëzakonisht të mjera të gjykatësve vendorë. Është e pamundshme që gjyqësia në Kosovë të punojë gjithmonë si e pavarur dhe e paanshme, në veçanti kur të merret parasysh madhësia e presionit të vendosur mbi të nga ana e palëve të procedurës ose palëve të treta. Një problem tjetër që kryetari i Gjykatës Supreme në Kosovë nuk e përmendi është fakti që pjesëtarët e komuniteteve të pakicave nuk janë të përfaqësuar sa duhet në gjyqësi.

Ekzistimi i vazhdueshëm i gjykatave paralele Serbe edhe më shumë e prish përshkrimin tashmë jo të mirë të gjyqësisë në Kosovë. Aktgjykimet e nxjerra nga to konsiderohen jovalide në një krahinë që në anën tjetër është zyrtarisht e qeverisur nga ana e strukturave të UNMIK-ut. Megjithatë, në komunat në veri të Mitrovicës, të cilat kryesisht janë të banuara me serbë, gjykatat e themeluara nga UNMIK-u ende nuk janë duke funksionuar si duhet kështu që banorët e rajoneve të tilla shpesh herë nuk kanë zgjidhje tjetër përveç që me rastet e tyre t'u drejtohen gjykatave paralele. Kjo e forcon pozitën e këtyre gjykatave dhe shkakton konfuzion të madh, kryesisht në mesin e komunitetit serb.

Kur bisedohet për gjykatat e rregullta, ende ekziston një zhbilancim i madh sa i përket numrit të rasteve në pritje për t'u shqyrtuar nga secila gjykatë. Derisa një numër i gjykatave, posaçërisht gjykatat komunale në qytetet kryesore të Kosovës dhe disa gjykata që qarkut, vazhdojnë të përballen me mungesën e vazhdueshme të stafit të mjaftueshëm për të shqyrtuar numrin e konsiderueshëm të rasteve në pritje për t'u zgjidhur, gjykatat në qytetet e vogla shpesh herë kanë shumë pak punë. Për arsye të paqarta, procedura e emërimit të gjykatësve dhe prokurorëve zgjat jashtëzakonisht shumë, nganjëherë edhe një vit e më tepër.

Edhe nëse ka numër të mjaftueshëm të gjykatësve në një gjykatë, nuk ka zëvendësim për një gjykatës i cili, për arsye të paparashikueshme, më nuk është në gjendje të ushtrojë funksionin e tij. Pas vdekjes së një gjykatësi në Gjykatën Supreme të Kosovës dy vite më parë, i cili ishte përgjegjës për rastet që kishin të bëjnë me konflikte administrative dhe heshtjen administrative, u nevojiti një kohë e konsiderueshme për të gjetur një zgjidhje tjetër, gjë që rezultoi me një ngarkesë të madhe me raste të këtyre kategorive që momentalisht janë në pritje për t'u zgjidhur pranë Gjykatës Supreme të Kosovës.

Në rastet kur gjykatat e qarkut kthejnë një lëndë për rishqyrtim pranë gjykatës komunale, kjo mungesë e gjykatësve krijon probleme lidhur me paanësinë pasi që rastet e kthyer rishqyrtohen nga i njëjti gjykatës që tashmë kishte qenë i përfshirë në marrjen e aktvendimit të parë. Kjo duket të jetë praktikë e përbashkët në tërë Kosovën dhe ngrit çështje serioze

lidhur me parimet e të drejtës për një proces të rregullt gjyqësor të përmbajtura në nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Zgjatja e procedurës pranë shumë gjykatave komunale dhe disa gjykatave të qarkut vazhdon të jetë e tepruar kurse numri i lëndëve në pritje për t'u zgjidhur është në rritje e sipër. Në lëndët penale, kjo zakonisht do të thotë që koha e kaluar e të akuzuarve në paraburgim gjithashtu rritet, përkundër parimit të njohur ligjor ndërkombëtar sipas të cilit duhet të tregohet vëmendja e duhur në procedurën penale nëse i akuzuari gjendet në paraburgim. Në të njejtën kohë, nuk ekziston ndonjë mjet ligjor që do të ofronte lehtësim në formë parandalimi ose kompenzimi për personat e ndikuar nga zgjatjet e tepruara të procedurës, në kundërshtim me të drejtën për ankim efektiv ligjor të garantuar me nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Një problem lidhur me vetë procedurën pranë gjykatës është mungesa e ekspertëve që gjykatës do të mund t'i ofronin prova nga mjekësisë ligjore. Është e kuptueshme që vetëm një numër i vogël i personave kanë vullnetin të kryejnë punën e ekspertit të mjekësisë ligjore, posaçërisht duke marrë parasysh pagesat e ulëta qesharake që janë të parapara për këto shërbime.

Më shpesh se e kundërta, aktgjykimet e gjykatave nuk janë duke u përmbuar me kohë. Derisa numri i referentëve ekzekutiv është rritur, ai ende nuk është i mjaftueshëm për të siguruar funksionimin e duhur të procedurës së përmbuarimit.

Megjithatë, suksesi i procedurës së përmbuarimit nuk varet vetëm nga gjykatësi kompetent dhe administrimi i gjyqësisë. Bankat private në përgjithësi refuzojnë të lejojnë gjykatat që t'i qasen xhirollogarisë së një individi si pjesë e procedurës së përmbuarimit apo të lejojnë bllokimin e ndonjë xhirollogarie si masë e përkohshme. Përkundër një refuzimi të tillë të qartë të bashkëpunimit, nuk ekziston ndonjë mekanizëm ligjor që do t'i obligonte bankat të bashkëpunojnë me gjykatat.

Në disa raste, pronat tani janë administrimin e Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit (AKM), një organ i themeluar nga ana e UNMIK-ut për të administruar pronat e dikurshme shoqërore. Në raste të tilla, një gjykatë mund të urdhërojë përmbuarimin e një aktgjykimi lidhur me këtë pronë në favor të një pale private që gjykata e konsideron të jetë pronar i ligjshëm i kësaj prone vetëm nëse AKM pajtohet me këtë, edhe në rastet kur një aktgjykimi i formës së prerë daton para ekzistimit të AKM-së. Suksesi i përmbuarimit të aktgjykimeve në raste të tilla varet nga një organ administrativ, që prapë ngrit çështje serioze rreth pavarësisë së gjyqësisë në Kosovë dhe mbrojtjes së të drejtës së njerëzve për gjykatë.

Një problem tjetër i pranishëm në lidhje me përmbuarimin e aktgjykimeve penale është fakti që nuk ka mjaft vende të lira në burgjet dhe qendrat e paraburgimit ekzistuese për të pranuar të gjithë personat të cilët janë privuar lirie me urdhër të gjykatës. Kjo shkakton një situatë ku shumë individë, posaçërisht ata që ishin dënuar me burg për periudha të shkurtëra kohore, nuk dërgohen fare në burg. Në këtë mënyrë, gjithmonë ekziston një gjasë reale që vepra të caktuara penale të mbesin të pandëshkuara, gjë që dobëson kredibilitetin dhe autoritetin e gjyqësisë dhe rrezikon efikasitetin e sundimit të ligjit në Kosovë.

Ky është viti i pestë prej kur UNMIK-u ka marrë kontrollin mbi gjyqësinë dhe administrimi i drejtësië ende nuk është ende duke funksionuar ashtu si duhet.

## ***Papërshatshmëria e mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë dhe roli i Ombudspersonit***

Edhe pse mbrojtja e të drejtave të njeriut është e theksuar në mënyrë të veçantë në Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, të shpallur përmes Rregullorës së UNMIK-ut Nr. 2001/9, më 15 maj 2001, dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut ishte një nga arsyet që Këshilli i Sigurisë ta miratojë Rezolutën 1244 në vitin 1999, në Kosovë ende nuk ekzistojnë mekanizma të duhur ligjor për të garantuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut në praktikë.

Një problem është mungesa e informatave në opinionin e gjërë lidhur me instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të përmbajtura në Kornizën Kushtetuese. Ato janë Deklarata Univerzale e të Drejtave të Njeriut, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj, Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike të Njeriut dhe Protokollet e saj, Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial, Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas, Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, Karta Evropiane e Gjuhëve Rajonale dhe Minoritare dhe Kornizën e Konventës së Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare.

Përkundër faktit që, përmes kapitullit 3.2 të Kornizës Kushtetuese, këto dokumente janë të aplikueshme në mënyrë të drejtëpërdrejtë në Kosovë për tani më shumë se tri vite, opinioni i gjërë mbetet i pavetëdijshëm për këtë fakt pasi që këto instrumente ende nuk janë publikuar dhe shpërndarë në të tri gjuhët zyrtare në Kosovë, posaçërisht në gjuhën shqipe dhe serbe. Pasi që shumica e gjykatësve, prokurorëve dhe juristëve nuk kanë fare dijeni as për ekzistimin e këtyre konventave, zbatimi i tyre në praktikë në sistemin ligjor në Kosovë vazhdon të mbetet vetëm një mit. Në maj të vitit 2004, Ombudspersoni ngriti këtë çështje me kryeministrin e Kosovës dhe e nxiti atë që t'i japë prioritetin më të lartë publikimit dhe shpërndarjes së marrëveshjeve të lartëpërmendura ndërkombëtare.

Në anën tjetër, juridiksioni i gjykatave vendore, të cila në sistemet demokratike shihen si garantues kryesor i të drejtave të njeriut, është i kufizuar në disa fusha të rëndësishme përmes rregulloreve të UNMIK-ut. Një nga shembujt shumë të rëndësishëm për këtë janë paditë e ngritura nga ana e personave të cilët kanë qenë pronarë, posedues ose mbajtës të së drejtës së shfrytëzimit të pronës së banimit para 24 marsit të vitit 1999 dhe të cilët tani nuk gëzojnë të drejtën e pronës dhe ku prona nuk është transferuar në mënyrë vullnetare. Çështjet e tilla janë vendosur nën juridiksionin ekskluziv të Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore (DÇPB) të Kombeve të Bashkuara. Kështu, gjykatat të cilat do të duhej të përbënin shtyllën kryesore në mbrojtjen e të drejtave të tilla janë të penguar në një masë të konsiderueshme për ta marrë atë rol në Kosovë në një fushë të rëndësishme së posaçme nga pikëpamja e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Një pengesë tjetër në themelimin e mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë është fakti që paditësit që dëshirojnë që pranë gjykatave të ngritin rastet lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut kundër UNMIK-ut si institucion, si dhe kundër pronës, fondeve dhe pasurisë, janë të parandaluar nga ajo që rastet e tyre të vendosen nga ana e gjykatës për shkak të imunitetit total që e gëzon vetë UNMIK-u. Derisa një imunitet i tillë i organizatave ndërkombëtare është i nevojshëm për të siguruar funksionimin e tyre efikas,

ky parim i përgjithshëm do të duhej të ishte i aplikueshëm në mënyrë tjetër në rrethanat në Kosovë, ku UNMIK-u kryen funksionin e një zëvendësimi të shtetit. Askund në botë një shtet demokratik që vepron nën sundimin e ligjit nuk i jep vetëvehtës imunitet nga përgjegjësia administrative, civile apo penale. E njëjta vlen edhe për KFOR-in.

Sipas nenit 3 të Rregullorës së UNMIK-ut Nr. 2000/47, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, Zëvendësit e tij, Komisioneri i Policisë, dhe zyrtarët e tjerë të lartë të UNMIK-ut lirohen nga jurisdiksioni vendor në lidhje me çfarëdo veprimi civil apo kriminal të kryer apo të ndërmarrë nga ata në territorin e Kosovës, derisa personeli i UNMIK-ut, duke përfshirë edhe personelin e punësuar vendës, është i liruar nga proceset ligjore lidhur me fjalët e folura dhe të gjitha veprimet e kryera nga ata në cilësinë e tyre zyrtare. Edhe pse imuniteti i antëtarëve individual të personelit mund të hiqet, veprimet e tilla janë diskrete. Problemi i imunitetit të UNMIK-ut si një institucion apo i anëtarëve të tij të personelit është shqyrtuar më hollësisht nga ana e Ombudspersonit në Raportin Special Nr. 1, të publikuar në prill të vitit 2001, në të cilin, për arsyet e theksuara më lart, dhënia e imunitetit UNMIK-ut dhe KFOR-it ishte konsideruar të jetë në kundërshtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Në qershor të vitit 2001, PSSP-ja i atëhershëm u përgjegj në këtë raport duke theksuar që çështjet e ngritura në raport ishin dukë u marrë në konsiderim në mënyrë aktive nga ana e zyrës së tij dhe që ai do konsulttohej më tutje me Zyrën Qëndore të Kombeve të Bashkuara dhe të tjetërt para se të japë një përgjegjje substanciale në këtë raport. Deri më datën e nxjerrjes së këtij raporti vjetor, ende nuk ka pasur një përgjegjje substanciale të UNMIK-ut lidhur me këtë çështje.

Imuniteti i lartëpërmendur pasqyron një mospërgjegjësi të caktuar e UNMIK-ut pasi që vetë Kombet e Bashkuara nuk ofrojnë mbrojtje përkatëse të brendshme për të garantuar ligjshmërinë e veprimeve të tilla. Edhe nëse ekzistojnë pohime për kryerjen e veprave penale nga ana e anëtarëve të UNMIK-ut, autoritetet vendore të prokurorisë nuk mund t'i hetojnë ato kurse në të njëjtën kohë nuk ka organe tjera të pavarura që do të ishin kompetente për ta bërë këtë. Momentalisht në Kosovë nuk ekziston asnjë mekanizëm tjetër që do të ishte në gjendje të garantojë zhvillimin e hetimeve efikase dhe të drejta në raste të tilla pasi që hetimet e brendshme të policisë së UNMIK-ut, për nga vetë natyra e tyre, nuk mund të përbëjnë hetime të plota të pavarura dhe janë të pamjaftueshme për të garantuar së paku nivelin minimal të pajtueshmërisë me standardet ndërkombëtare. Për më tepër, hetime të tilla nuk zhvillohen me qëllim që një person që supozohet të ketë kryer një veprë penale të sjellet para drejtësisë, por në vend të kësaj janë vetëm të përqëndruara në zhvillimin e procedurës disiplinore kundër policit përkatës.

Në të njëjtën kohë, është e pamundshme për personalin vendor të UNMIK-ut që pranë gjykatave kosovare të kontestojnë vendimet e UNMIK-ut lidhur me punësim. Kështu, këta persona nuk gëzojnë mbrojtje gjyqësore lidhur me kontestet e punës. E njëjta vlen edhe për nëpunësit civil të cilët dëshirojnë të fillojnë konteste të punës kundër IPVQ-ve. Sipas nenit 11.1 të Rregullorës së UNMIK-ut Nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës, nëpunësi civil i cili është dëmtuar me një vendim të organit të punësimit mund t'i ankohet Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, që është një njësi autonome brenda Ministrisë së Shërbimeve Publike. Edhe pse kjo rregullore hyri në fuqi në dhjetor të vitit 2001, një këshill i tillë ende nuk është formuar. Në këto rrethana, për nëpunësit civil nuk ekziston kurrfarë organi për ankim.



Kështu, në rastet kur Kosovarëve u shkelen të drejtat e njeriut nga ana e UNMIK-ut apo anëtarëve të personelit të tij, nuk ekziston kurrfarë organi i pavarur me karakter gjyqësor që do të mund të intervenonte ose përmes të cilit këta persona do të mund të merrnin ndonjë lloj dëmshpërblimi për dëmet apo lëndimet. Edhe nëse gjykatat vendore në Kosovë nuk mund të analizojnë ligjshmërinë e sjelljeve të UNMIK-ut, do të duhej të ekzistojë ndonjë tribunal i posaçëm që së paku do të ofronte mundësinë e shqyrtimit ligjor të veprimeve të UNMIK-ut që kishin pasur ndikim në të drejtat e subjekteve vendore ose të drejtën e punës së anëtarëve të personelit të UNMIK-ut. Neni 7 i Rregullorës së UNMIK-ut nr. 2000/47 parasheh krijimin e një Komisioni për Kërkesa, për të zgjidhur kërkesat e palës së tretë për humbjen apo dëmtimin e pronës, të cilat shkaktohen ose drejtëpërdrejtë i atribuohen UNMIK-ut apo personelit të tij përkatës, nuk ofron mekanizmat adekuatë për zhvillimin e hetimeve të pavarura, adekuate dhe të drejta në veçori të kërkesave të tilla kështu që deri më tani ka qenë një ndihmë shumë e kufizuar në këtë drejtim. E njëjta vlen edhe për Komisionin e Ankesave të KFOR-it.

Kjo situatë në përgjithësi e krijon një paradoks, ku vetë entitetet që janë në Kosovë për të mbrojtur të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit nuk mbajnë përgjegjësi ndaj vetë personave të cilët janë të obliguar t'i mbrojnë. Kjo gjithashtu ngrit çështje lidhur me njërën nga të drejtat më themelore, respektivisht e drejta për gjykatë sipas nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që parasheh që çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht dhe publikisht nga ana e një gjykate të krijuar ligjërisht gjatë përcaktimit të drejtave dhe detyrimeve të tij me karakter civil. Efektet e ngjarjeve të marsit nënvizuan në mënyrë drastike ndikimet praktike lidhur me këtë dilemë, pasi që nuk duket të ekzistojë ndonjë mënyrë përmes së cilës individët që kanë pësuar lëndime dhe dëme gjatë këtyre ngjarjeve mund të kërkojnë kompensim nga UNMIK-u si zëvendësim i shtetit që, në veçanti, është përgjegjës për rendin dhe qetësinë publike. Kjo situatë është e paqëndrueshme dhe përjashton çdo mundësi të thirrjes në, për shembull, dispozita të caktuara të Ligjit të RSFJ-së mbi Detyrimet, sipas të cilit autoritetet publike mund të mbahen përgjegjëse për dëmet dhe lëndimet e caktuara të shkaktuara, mes tjerash, nga demonstratat e dhunshme, nëse organizuesit e demonstratave ose kryerësit e veprave përkatëse penale nuk mund të identifikohej. Ligjeve të tilla u humb efekti i tyre nëse strukturat që ushtrojnë funksionin e shtetit në Kosovë kanë imunitet total para gjykatave vendore.

Ombudspersoni, edhe pse nuk është kompetent të hetojë ankesat kundër KFOR-it, është momentalisht i vetmi instrument ligjor që përbën një mekanizëm për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Ai ka juridiksion të mbikëqyrë si punën e administratës së UNMIK-ut, ashtu edhe atë të organeve të përkohshme të qeverisjes, por ende ekzistojnë shumë pengesa praktike dhe ligjore që e parandalojnë atë ta ushtrojë këtë mandate në mënyrën më të mirë të mundshme.

Një nga ato është mungesa e bashkëpunimit adekuat mes UNMIK-ut dhe Institucionit të Ombudspersonit në shumë raste, në veçanti në ato që kanë të bëjnë me policinë e UNMIK-ut. Edhe pse mund të vërehet një përmirësim i bashkëpunimit, posaçërisht pas ngjarjeve të dhunshme të marsit të vitit 2004, praktika e UNMIK-ut në çështje të tilla është larg nga ajo që të jetë në pajtim me nenin 4.7 të Rregullorës së UNMIK-ut nr. 2000/38 mbi Themelimin e Institucionit të Ombudspersonit, i cili vendos që administrata e përkohshme civile dhe çdo institucion qëndror dhe lokal që do të krijohet janë të obliguar bashkëpunojnë me Ombudspersonin duke i ofruar atij informatat përkatëse, dokumentet dhe dosjet.

Qasja në dosje mund të refuzohet vetëm nga ana e vetë PSSP-së, me kusht që Ombudspersonit i ipen arsyetimet me shkrim. Prandaj, autoritetet tjera të UNMIK-ut nuk janë të lejuara të mos i ofrojnë dokumente Ombudspersonit apo personelit të tij, një fakt që si duket është i panjohur për personelin e UNMIK-ut, në veçanti për policinë e UNMIK-ut. Gjatë periudhës për të cilën raportohet, ka pasur shumë raste kur pjesëtarët e policisë së UNMIK-ut kanë refuzuar me këmbëngulje qasjen në dosje të caktuara, që është një praktikë që e ka bllokuar në mënyrë efektive procedurën e hetimeve në rastet përkatëse. Në anën tjetër, PSSP-ja në një rast ka refuzuar qasjen në dosjen e policisë për shkak të arsyeve të sigurisë, kurse për rastet tjera nuk është përgjegjur fare, përkundër kërkesave të vazhdueshme për qasje të Institucionit të Ombudspersonit.

Gjatë punës me ankesa dhe pohime të ndryshme kundër Institucioneve të Përkohshme për Vetëqeverisje në Kosovë (IPVQ), Ombudspersoni përballet me dy probleme kryesore: një është fakti që Ombudspersoni as nuk ka fuqi fuqi ekzekutuese, as nuk mund të marrë pjesë në procedurën gjyqësore, qoftë si palë e tretë; kurse tjetri ka të bëjë me mungesën e shpeshtë të përkrahjes adekuate nga autoritetet e UNMIK-ut në rastet kur strukturat vendore nuk reagojnë në kërkesat e Ombudspersonit, duke përfshirë kërkesat për intervenime të ndryshme dhe rekomendimet e tij.

Pamundësia e Ombudspersonit për të marrë pjesë në procedurën në gjykatë apo në çfarëdo procedure tjetër rezulton pjesërisht nga lëshimet në Rregullorën e UNMIK-ut mbi themelimin e Institucionit të Ombudspersonit, por gjithashtu edhe nga dobësitë e përmbajtura në kornizën e tashme ligjore në Kosovë, në veçanti mungesa e Odës Kushtetuese apo Gjykatës Kushtetuese. Derisa Ombudspersoni mund të ngritë çështje të caktuara në një raport dhe mund ta rekomandojë PSSP-në të ndërrojë një praktikë ose ligj të caktuar, ai nuk mundet që në mënyrë të drejtëpërdrejtë, përmes mjeteve ligjore, të fillojë një procedurë për të siguruar që të ndërrohet një situatë e paligjshme.

Sa i përket mungesës së përkrahjes adekuate nga ana e UNMIK-ut gjatë punës me organet vendore administrative dhe të qeverisë, është e rëndësishme të theksohet që një përkrahje e tillë është më se e nevojshme në një situatë kur të gjitha organet e IPVQ-ve ende mbesin nën mbikëqyrjen e përgjithshme të PSSP-së i cili, sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit, mban përgjegjësinë përfundimtare për të gjitha veprimet e tyre dhe në të njëjtën kohë është përgjegjës për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut.

Fatkeqësisht, ende janë tepër të shpeshta rastet kur institucionet vendore nuk reagojnë në veprimet e Ombudspersonit, ose rastet kur reagimi i tyre është larg nga ajo që të jetë adekuat. Edhe pse UNMIK-u është gjithmonë i informuar për veprimet apo kërkesat e Ombudspersonit lidhur me një temë që është nën kompetencën e drejtëpërdrejtë të IPVQ-ve, UNMIK-u tepër shpesh dështon të ndërmarrë ndonjë veprim të dukshëm në përkrahje të Ombudspersonit në ato raste.

Derisa UNMIK-u të mos përgjegjet në çështjet e ngritura nga ana e Ombudspersonit dhe të dështojë të garantojë në mënyrë efektive që institucionet vendore nën mbikëqyrjen e tij të reagojnë në mënyrë adekuate në hapat e ndërmarrë nga ana e Ombudspersonit, efikasiteti i Institucionit të Ombudspersonit si mekanizëm për mbrojtjen e të drejtave të njeriut do të kufizohet në një masë të konsiderueshme. Një mbrojtje e tillë është posaçërisht e nevojshme në Kosovë pasi që, për dallim nga vendet tjera, ajo nuk është e pajisur me

instrumente tjera ligjore të forta aq sa për të garantuar pajtueshmërinë e veprimeve të autoriteteve me standardet për të drejtat e njeriut.

Ende ka tepër shumë situata ku kërkesat apo rekomandimet e Ombudspersonit injorohen në tërësi ose merret ndonjë përgjegjje e pakënaqshme. Në raste të tilla, Ombudspersoni nuk ka në dispozicion ndonjë mekanizëm ligjor për të reaguar në këtë shpërfillje nga ana e UNMIK-ut ose IPVQ-ve. Nëse rekomandimet e tij drejtuar PSSP-së do të ndjeken ose merren në konsiderim varet në masë të madhe nga zgjedhja e PSSP-së përkatës. Kur njëherë të jetë dorëzuar një raport, më nuk ka vend për debat të mëtejshëm ligjor – nëse PSSP vendos, për arsye të caktuara, të mos ndjekë rekomandimet e Ombudspersonit, të dy anët mbajnë pozitat e tyre kundërshtuese dhe nuk arrihet zgjidhja.

Në raste të tilla, nuk ekziston ndonjë organ më i lartë i karakterit gjyqësor i cili do të mund të zgjidhte një kundërshtim të tillë të mendimeve. Për dallim nga Bosna dhe Hercegovina, në Kosovë ende nuk është formuar Oda e të Drejtave të Njeriut apo ndonjë organ tjetër i ngjajshëm me kompetencë për të nxjerrë aktvendime me fuqi të ligjit me të drejtat e njeriut. Në të njejtën kohë, derisa Serbia dhe Mali i Zi tashmë kanë ratifikuar KEDNj-në, mekanizmat mbrojtës të Konventës ende nuk zbatohen në Kosovë. Pasi që UNMIK-u nuk është pjesë e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut apo sistemeve tjera të konventave ndërkombëtare, banorët e Kosovës me këtë rast janë të privuar nga ata mekanizma ndërkombëtarë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të cilët u janë mundësuar rishtas banorëve të Serbisë dhe të Malit të Zi.

Në mënyrë që të përmirësohet situata e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Kosovë e cila, siç tashmë është përmendur në Raportin e Tretë Vjetor, vazhdon të përbëjë një “vrimë të zezë të të drejtave të njeriut” në Evropë, Këshilli i Evropës, i nxitur nga ana e Ombudspersonit, ka filluar diskutimet me UNMIK-un si të vendoset Kosova nën ombrellën e mekanizmave ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Këto diskutime duket të kenë qënë të suksesshme në disa aspekte, së paku sa i përket Kornizës së Konventës së Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare dhe Konventës kundër Torturës dhe Dënimeve ose Trajtimeve tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese. Së shpejti, pritet që UNMIK-u dhe Këshilli i Evropës të nënshkruajnë një marrëveshje teknike në të cilën UNMIK-u zotohet të ushtrojë përgjegjësitë e tij në pajtim me parimet e përmbajtura në këto instrumente ligjore pa u bërë, në të njejtën kohë, një nga palët në këto konventa. Kudo që të jenë të përshatshme, këto përgjegjësi gjithashtu do të mbulojnë edhe veprimet e PSSP-së. Ky do të jetë një hap i konsiderueshëm në përmirësimin e të drejtave të njeriut në Kosovë.

### *Situata e komuniteteve jo-shqiptare në Kosovë*

Një nga standardet më fundamentale që duhet të prezentohet në Kosovë është e drejta e garantuar e pjesëtarëve të bashkësive minoritare në Kosovë të jetojnë, udhëtojnë dhe punojnë të lirë në Kosovë, me fjalë tjera e drejta për të jetuar një jetë normale me dinjitet në kushte paqësore dhe të pashqetësura.

Edhe para sulmeve të dhunshme në mars të vitit 2004 kundër pjesëtarëve të komuniteteve jo-shqiptare, kushtet e jetës së komunitetit serb, rom, ashkali, egjiptian dhe goran kanë qënë shumë të vështira, në një masë më të madhe apo më të vogël, varësisht nga secili komunitet.

Prej konfliktit të vitit 1999, nuk ka qenë e mundur për pjesëtarë të komuniteteve të caktuara jo-shqiptare, në veçanti për komunitetet serbe dhe rome, të lëvizin të lirë në Kosovë. Në vend të kësaj, ata kanë qenë të mbyllur në shtëpitë e tyre duke lëvizur vetëm përmes transporteve me përcjellje, për të vizituar ndonjëherë vendet tjerat të Kosovës të banuara me minoritete ose kufirin administrativ me Serbinë.

Mbyllja e këtyre personave në zona të kufizuara ka implikime afatgjata praktike siç janë qasja në punësim, arsim dhe shumicën e aspekteve tjera të jetës normale. Në të njëjtën kohë, enklavat serbe shpesh herë nuk kanë mjetet e mjaftueshme të komunikimit, ku format e rëndomta të komunikimit siç është shërbimi postal ose linjet telefonike shpesh herë nuk ekzistojnë fare ose janë të ndërprera.

Papunësia në Kosovë është e madhe në përgjithësi, por ajo arrin në 70 – 80 % në zonat e banuara me komunitetet jo-shqiptare. Përrfaqësimi i komuniteteve jo-shqiptare në shërbimin civil të Kosovës në përgjithësi është larg ajo që të jetë i kënaqshëm. Në shumë raste, është e pamundur për personat e minoriteteve etnikem, në veçanti nëse janë bujq, që të ushtrojnë çfarëdo aktiviteti të punës, pas që shumica e tokës së tyre bujqësore nuk është e qasshme ose është duke u shfrytëzuar nga ana e fqinjve të tyre shqiptarë. Edhe nëse të mira të caktuara arrihet të prodhohen, ka për së tepërmi pak qasje ndaj tregjeve përkatëse brenda dhe jashtë Kosovës.

Gjatë viteve të fundit, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Kosovës ka filluar implementimin e reformave arsimore në kuptim të ndryshimit të sistemit të arsimit për të qenë në pajtim me standardet e shumicës së vendeve evropiane mbi arsimin. Fatkeqësisht, këto reforma nuk marrin parasysh interesat specifike të atyre komuniteteve jo-shqiptare që flasin gjuhët sllave. Gjithashtu ka pasur një mospërfillje të plotë të fazës së nivelit të reformave në zonat fqinje, respektivisht në Serbi, në Mal të Zi, Bosne dhe Hercegovinë dhe IRJM. Për shkak të kësaj situate, fëmijët e disa nga këto komunitete, në veçanti një numër i fëmijëve të komunitetit boshnjak dhe goran, për pak humbën tërë vitin shkollor 2003/2004 dhe mundën ta kompenzojnë këtë vetëm përmes vijimit të “mësimeve plotësuese” të caktuara gjatë pushimeve të tyre verore. Vetëm rishtas dhe në masë të madhe për shkak të insistimit të Ombudspersonit dhe UNMIK-ut, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë filloi të kontaktojë ministrinë në shtetet fqinje për të shikuar mundësinë e arrijtes së një marrëveshjeje në këtë çështje.

Qasja e pjesëtarëve të komuniteteve jo-shqiptare në gjykata dhe në çfarëdo forme tjetër të mbrojtjes ligjore vazhdon të mbetet jashtëzakonisht e kufizuar. Në disa komuna, personat që dëshirojnë të vizitojnë gjykatën e ardhshme duhet të mbështeten në Zyrën e Bashkësisë Lokale të UNMIK-ut, që ndihmon për të kontaktuar stacionin lokal të policisë për të aranzhuar transportin. Në komunat tjera, Departamenti i Drejtësisë i UNMIK-ut ka formuar zyret e ndërlidhjes me gjykatën. Në qytetin etnikisht të ndarë të Mitrovicës, të gjitha gjykatat janë të vendosura në pjesën veriore të dominuar nga serbët. Policia e UNMIK-ut ofron një formë transporti për të bartur palët dhe dëshmitarët nga pjesa jugore e qytetit në gjykatat në veri të tij.

Edhe pse gjuha serbe është një nga tri gjuhët zyrtare në Kosovë, ajo në praktikë faktikisht është e zhdukur nga jeta publike. Edhe pse Korniza Kushtetues ofron përdorimin zyrtar si të gjuhës shqipe ashtu edhe të asaj serbe, qeveria qendrore e Kosovës, si dhe disa komuna,

deri më tani nuk i kanë ndjekur këto dispozita në nivel të caktuar. Komunikimi mes organeve të ndryshme të qeverisë qendrore dhe komunave të banuara kryesisht me serbë zhvillohet pothuajse në tërësi në gjuhën shqipe, që e vështirëson nëse jo edhe pamundëson komunikimin mes këtyre organeve. Ombudspersoni ngriti këtë çështje disa herë me kryeministrin e Kosovës, në fillim të marsit dhe në maj të vitit 2004, dhe e nxiti atë të garantojë që dispozitat e Kornizës Kushtetuese të implementohen pa vonesë të mëtutjeshme. Zyrja e kryeministrit u përgjegj dhe theksoi që si organet qendrore ashtu edhe IPVQ-të i respektojnë dhe i implementojnë dispozitat përkatëse të Kornizës Kushtetuese dhe që, përkundër pagave të vogla, zyrja e përkthimeve funksionon rregullisht. Megjithatë, në një mënyrë duke e vërtetuar qëndrimin e Ombudspersonit, përgjegjja e dërguar ishte vetëm në gjuhën shqipe.

Në mars të vitit 2004, diskriminimi dhe aktet tjera të dhunës pak a shumë të fshehta kundër atyre pjesëtarëve të komuniteteve jo-shqiptare, posaçërisht serbëve, të cilët kishin vendosur të qëndrojnë në Kosovë pas konfliktit të vitit 1999, u shëndrrua në një shpërthim brutal të dhunës kundër pothuajse të gjithëve që nuk ishin të etnicitetit shqiptar.

Viktimat kryesore të këtyre sulmeve ishin pjesëtarët e komunitetit serb, rom, ashkali dhe egjiptian – vetëm në Vushtrri, rreth pesëdhjetë familje ashkali u detyruan të largohen nga shtëpitë e tyre dhe pjesa më e madhe e tyre ende qëndron në një bazë të KFOR-it francez. Në incidente të vetmuara, serbët ishin linçuar brutalisht nga ana e turmës hysterike dhe të zemëruar. Gjithashtu, u kërcënuan shqiptarët të cilët nuk deshën të marrin pjesë në shkatërrimin masiv të pronave, kishave dhe lokaleve publike.

Sipas Raportit të UNMIK-ut të nxjerë nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara më 30 prill 2004, ky sulm kishte qenë një fushatë e organizuar, e përhapur dhe me një cak të definuar. Ishin shkatërruar pronat dhe kishat, ishin shkatërruar lokalet siç janë shkollat dhe qendrat shëndetësore, ishin rrethuar dhe kërcënuar komunitetet dhe banorët e këtyre komuniteteve ishin detyruar të largohen nga shtëpitë e tyre. Cak kishin qenë rajonet e minoriteteve, duke u dërguar një porosi që minoritetet dhe të kthyerit nuk janë të mirëseardhur në Kosovë. Sekretari i Përgjithshëm e pa këtë si një përpjekje që për cak kishte dëbimin e serbëve të Kosovës dhe komuniteteve romë dhe ashkali dhe shkatërrimin e strukturave sociale të ekzistencës së tyre në Kosovë. Kjo gjithashtu tregoi një mungesë të angazhimit në mesin e pjesës së madhe të popullsisë shqiptare të Kosovës për të krijuar një shoqëri të vërtetë multietnike në Kosovë.

Konkludimi i arritur nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm përkrahu qëndrimet e shumë personave brenda dhe jashtë Kosovës lidhur me ngjarjet e marsit, duke përfshirë këtu edhe Ombudspersonin, respektivisht që ato ngjarje kishin arritur të jenë asgjë më pak se përpjekje e koordinuar për pastrim etnik në disa pjesë të Kosovës.

Pas dhunës, premtimi i politikanëve për të rindërtuar ndërtesat e shkatërruara deri më tani nuk ka treguar rezultatet e pritura reale. Ende mbetet të shihet kur dhe si do të përmbushen këto premtime dhe nëse kryerësit e krimeve të dhunshme të marsit të vitit 2004 do të sjellen para drejtësisë. Për momentin, rreth 2,000 njerëz vazhdojnë të jenë të zhvendosur dhe mbetet vetëm të shpresohet që ata do të mund të kthehen në shtëpitë e tyre para dimrit.

Në kundërshtim me atë që ishte para ngjarjeve të marsit, tani është bërë gjithnjë e më vështirë të mbahet çfarëdo pretendimi që ekziston një mundësi e arsyeshme për të krijuar

një shoqëri multietnike më Kosovë në një të ardhme të parashikueshme. Për Serbët, në veçanti, është përsëri e nevojshme në shumë vende që të u sigurohet përcjellja e armatosura nëse dëshirojnë të udhëtojnë jashtë vendbanimeve të tyre.

Për arsye të panjohura, para dhe pas ngjarjeve të marsit, KFOR-i vendosi të largojë pikat e kontrollit në fshatra të caktuara të banuara kryesisht me serbë, përkundër kundërshtimeve nga banorët. Në janar të vitit 2004, Ombudspersoni kërkoi nga autoritetet kompetente të KFOR-it të informohet për arsyet e largimit të këtyre pikave të kontrollit. Asistenti ligjor i KFOR-it u përgjegj në emër të Komandantit të KFOR-it, duke theksuar që vendimi i KFOR-it ishte bazuar kryesisht në përmirësimin e situatës së sigurisë në Kosovë. Vetëm dy muaj pas kësaj, ngjarjet e marsit të vitit 2004 treguan që këto qëndrime nuk përputheshin edhe aq me realitetin.

Pak më shumë se dy muaj prej dhunës së marsit, KFOR-i suedeze vendosi ta largojë pikën e kontrollit të vendosur në hyrje të fshatit serb të Graçanicës. Dy ditë më vonë, një veturë erdhi në Graçanicë në mesnatë, nga e cila dolën dy persona që gjuajtën me armë drejt një grupi të të rinjve serbë, me ç'rast vranë një serb gjashtëmbëdhjetë vjeçar. Ky incident përsëri tregoi që vlerësimi i KFOR-it i situatës së sigurisë nuk kishte qenë medoemos i saktë.

Të lartëpërmendurit janë vetëm disa nga shembujt e problemeve të vazhdueshme me të cilat përballen komunitetet jo-shqiptare në Kosovë. Një situatë e tillë nuk do të duhej të tolerohet nga ana e pranisë ndërkombëtare në Kosovë, as nga ana e udhëheqësve të Kosovës, të cilët duhen të angazhohen haptas dhe të veprojnë në mënyrë efektive, jo vetëm me fjalë, për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të njeriut të të gjithë banorëve të Kosovës, ne veçanti të atyre që janë minoritete etnike në këtë krahinë.

### *Situata e personave të zhvendosur brenda dhe jashtë Kosovës*

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, një numër në rritje e sipër, mirëpo prapëseprapë i kufizuar i personave të zhvendosur është kthyer në Kosovë. Arsyet për këtë, shpesh herë të përmendura në deklaratat publike të Ombudspersonit, si dhe në Raportin e Tretë Vjetor, kanë të bëjnë të shumtën me mungesën e sigurisë, situatën e mjerë ekonomike dhe faktin që ende nuk është zgjidhur statusi përfundimtar i Kosovës. Në të njejtën kohë, megjithëse i kufizuar, ka vazhduar emigrimi i serbëve dhe pjesëtarëve të komuniteteve tjera joshqiptare në Kosovë. Vetëm në vitin 2003, Komesari për Refugjatë në Serbi ka regjistruar zyrtarisht 600 persona që janë larguar nga Kosova për në Serbi.

Pas ngjarjeve të dhunshme në mars të vitit 2004, situata është bërë edhe më e vështirë. Mes 17 – 19 marsit 2004, u sulmuan edhe vendbanimet në të cilat ishin vendosur të kthyerit dhe kishte pasur raste, sikur ai në Bellopojë, kur këto vendbanime edhe u shkatërruan në tërësi.

Një numër i konsiderueshëm i personave të zhvendosur ende jetojnë në territorin e Kosovës që nga përfundimi i konfliktit në Kosovë më 1999. Ngjarjet e dhunshme të marsit të vitit 2004 e kanë rritur në masë të madhe këtë numër. Gjatë këtyre ngjarjeve, më shumë se 4000 persona u detyruan të largohen nga shtëpitë e tyre, që pastaj u dogjën nga ana e turmave të zemëruara. Tani, më shumë se tre muaj më vonë, përafërsisht 2000 nga këta persona janë ende të zhvendosur dhe jetojnë në kushte të mjera, shumica nga ta në tenda, ndërtesa të shkollave dhe, në disa raste, edhe në kampet e KFOR-it. Asnjë nga këto strehime nuk ishte

paramenduar për të pranuar një numër aq të madh të personave për një periudhë më të gjatë kohore.

Ombudspersoni mbetet aktivisht i përqëndruar në fatin e personave të zhvendosur nga Kosova që janë duke qëndruar në Serbi, Mal të Zi dhe IRJM. Gjatë periudhës për të cilën raportohet, ai vizitoi kampet e personave të zhvendosur brenda vendit në rajonin e Kraljevës në Serbi, dhe u takua në Podgoricë me përfaqësuesit e personave të zhvendosur që janë duke qëndruar në Mal të Zi. Për dallim nga personat të cilëve u është dashur të largohen nga Kroacia dhe Bosna dhe Hercegovina, që tani janë shtete të pavarura, personat që erdhën në Serbi dhe Mal të Zi nga Kosova nuk gëzojnë statusin e refugjatit, pasi që Kosova ende shihet të jetë pjesë e territorit të Serbisë dhe Malit të Zi. Megjithatë, problemet me të cilat ballafaqohen personat e zhvendosur brenda vendit nga Kosova dhe të njejtit nga Kroacia dhe Bosna dhe Hercegovina janë pothuajse identike në shumë raste. Ombudspersoni ngriti këtë çështje me kryeministrat e Serbisë dhe Malit të Zi dhe gjatë takimeve me udhëheqësit tjerë politik të të dy entiteteve. Duke vërejtur që një numër i madh i personave të zhvendosur brenda vendit nga Kosova ishin duke jetuar në kushte shumë të mjera të jetës për gati pesë vite, Ombudspersoni nxiti kryeministrat të shohin nëse do të ekzistonte mundësia që personave të zhvendosur brenda vendit të u jipen disa nga të drejtat dhe beneficionet që i gëzojnë refugjatët në kohën e tashme. Ombudspersoni është i mendimit që nuk ka ndonjë arsytim të vlefshëm pse këto dy kategori të personave të mos trajtohen në mënyrë të ngjajshme.

Për më tepër, personat e zhvendosur nga Kosova që janë duke jetuar në Mal të Zi nuk kanë mundësinë të marrin pjesë në zgjedhjet që mbahen në Serbi, edhe pse konsiderohen të jenë qytetarë të këtij shteti. Duke marrë parasysh zgjedhjet presidenciale që u mbajtën në Serbi në mes të vitit 2004, Ombudspersoni ngriti këtë çështje me Komisionin Republikan Zgjedhor të Serbisë dhe Këshillin e Evropës. Është e papranueshme që për shkaqe politike dhe probleme të brendshme që ekzistojnë mes dy entiteteve që përbëjnë unionin e Serbisë dhe Malit të Zi, personat e zhvendosur brenda vendit nga Kosova që janë duke jetuar në Mal të Zi të mos kenë mundësinë të ushtrojnë të drejtën e tyre për të marrë pjesë në zgjedhjet që mbahen në Serbi dhe me këtë rast janë privuar nga një nga të drejtat themelore për të garantuar një demokraci funksionale.

Sa u përket refugjatëve nga Kosova në IRJM, problemi kryesor në lidhje me këtë çështje janë vështirësitë e personave të etnicitetit rom të cilët ikën atje nga Kosova pas konfliktit të vitit 1999. Sipas organizatave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, në IRJM momentalisht jetojnë diku rreth 2500 romë nga Kosova. Pas mbylljes së “Shuto Orizari”, kampit më të madh të refugjatëve romë në IRJM, në maj të vitit 2003, banorët e këtij kampi iu lanë vetëvehtes, pa kurrfarë përkrahje nga qeveria vendore apo organizatat ndërkombëtare humanitare. Në letrën dërguar kryeministrin të IRJM-së në maj të vitit 2004, Ombudspersoni ngriti këtë çështje dhe nxiti kryeministrin të shohë nëse do të ishte e mundshme të gjejë një zgjidhje për këta persona, qoftë në bashkëpunim me agjencitë ndërkombëtare për të drejtat e njeriut brenda IRJM-së, ose përmes negociatave me shtetet e treta.

Sa i përket refugjatëve romë dhe ashkali që janë duke qëndruar në shtetet e Evropës perëndimore, qeveritë e disa nga këto shtete, respektivisht Belgjikës, Danimarkës, Gjermanisë, Norvegjisë, Suedisë dhe Holandës, ende kanë për qëllim t'i kthejnë këta njerëz në Kosovë. Në një letër publike drejtuar ministrave kompetent të këtyre shteteve,

Ombudspersoni u shpreh fuqimisht kundër një hapi të tillë, duke theksuar kushtet e mjera në të cilat shumica e pakicave etnike jetojnë në Kosovë dhe situatën e përgjithshme të sigurisë, posaçërisht pas ngjarjeve të dhunshme të marsit të vitit 2004. Deri sa të mos përmirësohet në masë të madhe situata e sigurisë në Kosovë dhe të mos ketë shenja të përmirësimit të konsiderueshëm të ekonomisë kosovare, shtetet që parashohin të kthejnë pjesëtarët e komuniteteve jo-shqiptare në Kosovë do të duhet të rishqyrtojnë qëndrimet e tyre.

Padyshim, të gjithë personat e zhvendosur, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike, kanë të drejtë të kthehen në shtëpitë dhe pronat e tyre në Kosovë dhe është obligim i udhëheqësve dhe autoriteteve të Kosovës që, së bashku me bashkësinë ndërkombëtare, të krijojnë kushtet e sigurta dhe të qëndrueshme për të gjithë kosovarët që dëshirojnë të vazhdojnë jetën e tyre në Kosovë. Në të njëjtën kohë, të gjithë personat e zhvendosur brenda vendit të cilët, për shkaqet e lartpërmendura, kanë qenë të detyruar të largohen nga Kosova pas vitit 1999, do të duhej të kenë lirinë e zgjidhjes nëse dëshirojnë të qëndrojnë në vendet të cilat i kanë strehuar ata apo dëshirojnë të kthehen në Kosovë. Nëse këta persona vendosin të mos kthehen në Kosovë dhe të qëndrojnë në Serbi dhe në Mal të Zi, qeveritë përkatëse të këtyre vendeve do të duhej të krijojnë kushtet e nevojshme për realizimin edhe të këtij opcioni.

Numri i madh i personave të zhvendosur, në veçanti në Serbi dhe në Mal të Zi, vendos një barrë të rëndë mbi infrastrukturën dhe ekonominë tashmë shumë të dobët të këtyre shteteve. Kjo është arsyeja ose kjo situatë kërkon angazhim serioz të bashkësisë ndërkombëtare në mënyrë që të ndihmohen këto shtete për t'u ballafaquar me këtë barrë. Ata persona që janë zhvendosur në këto vende kanë të njëjtën të drejtë për ta jetuar një jetë normale si të gjithë të tjerët dhe është e rëndësishme që fuqitë vendore dhe ndërkombëtare të bashkëpunojnë në realizimin e këtij obligimi që e kanë ndaj këtyre individëve.

### ***Personat e zhdukur dhe mungesa e hetimeve mbi krimet e rënda***

Fatkeqësisht, është ende i paqartë fati i mijëra kosovarëve që u zhdukën para dhe gjatë konfliktit të vitit 1999 në Kosovë, ose par ardhjes së UNMIK-ut dhe KFOR-it. Derisa gjatë periudhës për të cilën raportohet është identifikuar një numër i kufomave dhe mbetjeve trupore që u kanë takuar personave të zhdukur, përparimi i arritur në këtë drejtim është ende larg nga niveli i kënaqshëm. Sa i përket rasteve të pazgjidhura të personave që u zhdukën pas ardhjes së KFOR-it dhe më vonë UNMIK-ut, të shumtën serbë dhe pjesëtarë të komuniteteve tjera jo-shqiptare, autoritetet ndërkombëtare në Kosovë, së pari ato ushtarake e më vonë ato civile, dështuan të hetojnë këto raste si duhet menjëherë pasi që personat në fjalë u zhdukën. Me kalimin e kohës, do të bëhet vështirë e më vështirë të mbledhen dëshmitë që supozohet të zbulojnë fatin e këtyre personave të zhdukur.

Dështimi i policisë së UNMIK-ut për të arritur rezultate të duhura gjatë hetimeve mbi krime tjera të rënda që kanë ndodhur pas vendosjes së prezencës ndërkombëtare në Kosovë tashmë është kritikuar në raportet e mëparme dhe situata nuk ka ndryshuar prej atëherë, në veçanti në rastet kur krimet e tilla supozohen të kenë prapavijë politike ose etnike. Në raste të caktuara, viktimat e krimeve të tilla ose familjet e tyre janë në pritje të rezultateve të hetimeve të policisë për më shumë se tri vite, shpesh herë duke mos qenë të informuar me kohë as për zhvillimet e reja në rastet e tyre. Siç është theksuar në Raportin e Tretë Vjetor, një nga arsyet kryesore për këtë dështim të policisë së UNMIK-ut për të hetuar krimet e tilla në mënyrë efektive vazhdon të jetë ndërrimi i vazhdueshëm dhe i shpeshtë i stafit të



hetuesisë. Mungesa e bashkëpunimit nga komunitetet vendore dhe dëshmitarët, në të cilën shpesh herë thirren autoritetet përgjegjëse të zbatimit të ligjit, nuk mund të shërbejë si arsytim valid për paaftësinë e këtyre autoriteteve për të arritur rezultatet e pritura nga hetimet, në veçanti në rastet që kanë të bëjnë me krimet më të rënda.

### *E drejta në pronë*

Garantimi i të drejtës në pronë vazhdon të jetë një sfidë e madhe. Shumë persona në Kosova nuk i respektojnë të drejtat në pronë të të tjerëve, një fakt që vërtetohet me numrin gjithnjë në rritje e sipër të ndërtimeve të reja dhe anekseve të ndërtesave ekzistuese pa i përfilluar ligjet e aplikueshme në Kosovë. Personat e përfshirë në ndërtimet e tilla të egra qartas nuk ndihen të obliguar të u përmbahen këtyre ligjeve dhe kjo mospërfillje evidente e sundimit të ligjit nuk kontrollohet në mënyrë serioze dhe adekuate nga ana e autoriteteve qendrore dhe komunale. Tepër shpesh, gjykatat vendore gjithashtu mëdyshen për të nxjerrë urdhërat për masa të përkohshme për të ndaluar ndërtimet e egra. Në letrën drejtuar kryeministrit në nëntor të vitit 2003, Ombudspersoni ngriti këtë çështje, duke kërkuar nga ai që të ndërmarrë hapat përkatës për t'i dhënë fund këtij mosrespektimi të hapur dhe në një mënyrë të lejuar të ligjeve ekzistuese mbi ndërtimet.

Pas konfliktit të vitit 1999, një numër i madh i shqiptarëve etnikë mori në posedim tokën që i takon serbeëve dhe pjesëtarëve të komuniteteve tjera jo-shqiptare. Kjo tokë është momentalisht duke u punuar nga ana e këtyre uzurpuesve të paligjshëm, duke mos u lënë pronarëve të vërtetë kurrfarë mundësie për ta ushtruar të drejtën e tyre në pronë. Situata është edhe më e vështirë për personat e zhvendosur brenda vendit që gjenden në Kosovë dhe jashtë saj, për të cilët toka e tyre është si e humbur – ata nuk mund t'i qasen asaj dhe në të njëjtën kohë nuk kanë në dispozicion kurrfarë mënyre efikase për t'u informuar çfarë ka ndodhur me pronën e tyre.

Edhe në rastet kur toka që është pronë e personave të përkatësisë etnike jo-shqiptare nuk është uzurpuar në mënyrë të paligjshme, situata e sigurisë në Kosovë i parandalon shpesh herë pronarët e kësaj toke për të iu qasur asaj. Në këtë mënyrë, mijëra serbë dhe një numër i pronarëve tjerë të pakicave etnike nuk janë në gjendje ta punojnë tokën e tyre për shkak se kjo mund të paraqesë rrezik të konsiderueshëm ndaj jetës dhe sigurisë së tyre. Në shumë raste, kjo plotësisht i parandalon njerëzit ta punojnë tokën e tyre dhe në zona të caktuara kjo ka ndikimin në 70 – 80 % të tokës.

Uzurpimi i paligjshëm i banesave dhe shtëpive vazhdon të jetë një praktikë e përhapur, përkundër përpjekjeve të UNMIK-ut që personavë të cilët janë privuar nga prona e tyre të ua kthejë atë në posedim. Në nëntor të vitit 1999, UNMIK-u e krijoi DÇPB-në në mënyrë që të merret me kërkesat e personave privatë të cilët kishin qenë pronarë, posedues ose shfrytëzues të së drejtës së banimit të ndonjë prone të paluajshme para 24 marsit 1999. DÇPB pati një fillim jashtëzakonisht të ngadalshëm të punës të shkaktuar nga mungesat kronike të resurseve, udhëheqja e dobët dhe konfliktet ndër-institucionale. Pas vitit 2002, kjo situatë u përmirësua, mirëpo një mungesë që duket të ekzistojë e fondeve të mjaftueshme për të angazhuar një numër të mjaftueshëm të juristëve për të punuar me numrin e rasteve në pritje për t'u zgjidhur ka rezultuar me atë që të mos zvogëlohet numri i ankesave kundër DÇPB-së. Në shumë raste, kërkuarit janë në pritje për ta kthyer në posedim pronën e tyre për më shumë se tri apo katër vite.

Shumica e ankesave kundër DÇPB-së kanë të bëjnë me zgjatjen e tepruar të procedurës pranë Komisionit për Kërkesat Pronësore dhe Banesore pranë DÇPB-së, vonesat e konsiderueshme në dorëzimin e vendimeve të marra nga ana Komisionit për Kërkesat Pronësore dhe Banesore pranë DÇPB-së dhe ekzekutimi i ngadalshëm ose joefikas i vendimeve të tilla.

Ekzekutimi i vendimeve të DÇPB-së shpesh herë zvarritet për shkak të situatës së sigurisë. Në shumë raste, uzurpuesit e paligjshëm të banesave ose shtëpive të cilët janë dëbuar me vendim të DÇPB-së kthehen më vonë dhe i kërcënojnë pronarët e ligjshëm, kurse në rastet më të rënda i kërcënojnë edhe me djegje ose shkatërrim të banesave ose shtëpive. Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2000/60 mbi Kërkesat Pronësore dhe Banesore dhe Rregullat e Procedurës dhe të Provave të Drejtorisë Për Çështje Pronësore dhe Banesore si dhe të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore nuk ofron zgjidhje adekuate për këtë problem. Si duket, gjatë përpilimit të këtij ligji dhe ligjeve tjera mbi procedurën pranë DÇPB-së, UNMIK-u nuk kishte paraparë që ekzekutimi i vendimeve të DÇPB-së do të pengohej në një mënyrë kaq të ligë dhe të paligjshme.

Kjo pamundësi për të zbatuar në mënyrë efikase vendimet e DÇPB-së rrezikon efikasitetin e tërë mekanizmit për të kthyer pronat në posedim pronarëve të ligjshëm. Momentalisht, nuk është duke ju kushtuar vëmendja e duhur kësaj situatë të rëndë, ku një organ i Kombeve të Bashkuara i cili është themeluar enkas për të kthyer pronat në posedim personave që janë privuar nga ato në mënyrë të paligjshme, gjatë këtyre tri deri katër viteve nuk ka pasur as mjetet e duhura financiare, as fuqinë për të përmbushur obligimet e vendosura mbi të.

Sa i përket pronës së komuniteteve tjera jo-shqiptare në Kosovë, ngjarjet e dhunshme të marsit të vitit 2004 kishin përfshirë djegjen dhe shkatërrimin sistematik të shumë shtëpive dhe gjësendeve të këtyre personave. Menjëherë pas këtyre ngjarjeve, kryeministri dhe udhëheqësit tjerë politik u deklaruan publikisht që këto shtëpi do të rindërtohen brenda disa muajve në mënyrë që këtyre personave të u mundësohet të kthehen në shtëpitë e tyre sa më shpejte që të jetë e mundur. Tani, më shumë se katër muaj pas ngjarjeve të marsit, ende nuk ka pasur ndonjë përparim të dukshëm në lidhje me rindërtimin e këtyre shtëpive. Si duket, vlerësimi i dëmeve është duke u bërë pa praninë e pronarit të ligjshëm të pronës së shkatërruar. Në anën tjetër, nuk ka mekanizëm ligjor të ankimit përmes të cilit do të mund të kontestohet një vlerësim i tillë. Në të njëjtën kohë, vlerësimi i bërë i dëmit ka të bëjë vetëm me dëmin që i është shkaktuar pronës së paluajtshme. Asistenca lidhur me humbjen ose dëmtimin e pronës së luajtshme ka qenë shumë e kufizuar dhe nuk ka përfillur situatën e veçantë të secilit individ. Deri më tani, autoritetet publike në Kosovë nuk duket të ndiejnë kurrfarë obligimi ligjor ndaj humbjeve të viktimave të ngjarjeve të marsit të vitit 2004. Autoritetet kompetente duket të konsiderojnë që ngjarjet e marsit të vitit 2004 ndodhën si rezultat ekskluziv i një *force majeure* dhe prandaj ndihen të obliguar të ofrojnë vetëm disa forma të ndihmës humanitare.

### ***Situata e personave me aftësi të kufizuara mendore***

Që nga përfundimi i konfliktit të armatosur të vitit 1999 në Kosovë, nuk i është kushtuar shumë vëmendje problemit të personave me mendje jo të shëndoshë në Kosovë. Momentalisht, institucioni i vetëm shëndetësor i kësaj natyre në Kosovë është Klinika e Neuropsikijatrisë në Spitalin Univerzitar të Prishtinës, e cila fatkeqësisht nuk është e

pregatitur për numrin e personave që është duke u dërguar atje dhe nuk ka lokalet përkatëse për të siguruar mjekimin afatgjatë psikijatrik. Në të njëjtën kohë, nuk ka ndonjë ligj që rregullon vendosjen e personave me mendje jo të shëndoshë në institucione përkatëse shëndetësore, që do të thotë që vendosja e këtyre personave në institucione të tilla momentalisht nuk ka bazë ligjore. Prandaj, ky privim lirie është i paligjshëm.

Kjo situatë është edhe më e rëndë në rastet e kryerësve të veprave penale që konsiderohen të jenë në gjendje të papërgjegjshmërisë ose papërgjegjshmërisë së pakësuar esencialisht. Kodi i ri i Përkohshëm Penal i Kosovës, i cili hyri në fuqi në prill të vitit 2004, nuk përmban kurrfarë dispozita mbi atë se kur dhe nën çfarë kushte do të mund të vendosen kryerësit e tillë të veprave penale në institucionet përkatëse shëndetësore. Në vend të kësaj, ai vendos që procedurat e urdhërimit të mjekimit të detyrueshëm psikijatrik do të ofrohen ndaras përmes një ligji të veçantë. Megjithatë, një ligj i tillë ende nuk është shpallur.

Kjo krijon një zbrazëti të caktuar në ligj dhe gjithashtu shkakton një konfuzion të madh. Për shkak të mungesë së një rregullore të re në këtë fushë, gjykatat penale në Kosovë vazhdojnë të zbatojnë ligjin e RSFJ-së, i cili më nuk është në fuqi. Kështu krijohet një situatë kur gjykatësit kompetentë janë të detyruar të nxjerrin urdhëra të gjykatës që nuk janë në pajtim me ligjin në fuqi, vetëm për të siguruar që kryerësit e veprave penale në gjendje të papërgjegjshmërisë ose papërgjegjshmërisë së pakësuar esencialisht t'i nënshtrohen mjekimit adekuat psikijatrik. Përkundër kërkesave të përsëritura të UNMIK-ut për të urdhëruar lirin e këtyre kryerësve të veprave penale të paraburgosur në mënyrë të paligjshme, gjykatësit janë mëdyshur për ta bërë këtë, që është e kuptueshme kur të merret parasysh fakti që individët e paraburgosur nuk kanë treguar shenja të shërimit.

Duke lënë anash problemin që paraburgimi i tyre nuk ka baza sipas ligjit në fuqi, shumica e kryerësve të veprave penale në gjendje të papërgjegjshmërisë ose papërgjegjshmërisë së pakësuar esencialisht janë të shumtën të preokupuar me problemet praktike lidhur me paraburgimin e tyre. Për shkak të mungesës së përgjithshme të vendeve të lira në institucionin përkatës shëndetësor në Prishtinë, këta persona, paraburgimi i të cilëve ishte urdhëruar nga gjykata të caktuara, më nuk mund të pranoheshin për mjekim. Në vend të kësaj, ata janë vendosur në burgje të rëndomta në pritje për t'u vendosur në Klinikën e Neuropsikijatrisë në Prishtinë, nganjëherë edhe për shumë muaj me rradhë. Burgjet e rëndomta nuk kanë lokale për të ofruar mjekimin përkatës për këta persona. Kjo praktikë e vendosjes së këtyre kryerësve të veprave penale në burgje të rëndomta ka ndikim negativ në suksesin e mjekimit të tyre dhe nuk është i paraparë me ligjet e dikurshme të RSFJ-së e as me Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës që është momentalisht në fuqi. Qëndrimi i Departamentit të Drejtësisë pranë UNMIK-ut është që Ministria e Shëndetit është përgjegjëse për krijimin e lokaleve për të vendosur personat për të cilët është urdhëruar t'i nënshtrohen mjekimit të detyrueshëm. Si duket, ekzistojnë plane të kësaj Ministrie për të ndërtonur një objekt për mjekimit intenziv në të cilin, megjithatë, nuk do të mund të vendosen personat që kanë nevojë për mjekim afatgjatë. Edhe nëse shpallet ndonjë ligj mbi shëndetin mendor apo ndonjë ligj penal i cili do të parashikonte urdhërat për mjekim të detyrueshëm, duket që Ministria nuk ka në plan të ndërtojë lokalet përkatëse për këtë qëllim.

Momentalisht, paraburgimet e kryerësve të veprave penale që konsiderohen të jenë në gjendje të papërgjegjshmërisë ose papërgjegjshmërisë së pakësuar esencialisht nuk janë të mbuluara me ligj. E njëjta vlen edhe për vendosjen e lartpërmendur të këtyre personave në burgje të rëndomta në pritje për t'i vendosur në Klinikën e Neuropsikijatrisë në Prishtinë.

Prandaj, që të dy këto situata janë të paligjshme dhe shkelin të drejtën e këtyre njerzve për liri, të garantuar me paragrafin 1 të nenit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Ata kryerës të veprave penale që kanë gjetur vend në Klinikën e Neuropsikijatrisë në Prishtinë deri më tani janë vendosur shpesh herë në të njëjtat repartee me pacientët e rëndomtë të psikijatrisë, një situatë që në disa raste ka rezultuar edhe me akte të dhunës. Fakti që disa nga këta kryerës të veprave penale vazhdojnë të jenë të ruajtur nga ana e policisë gjithashtu shqetëson pacientët tjerë dhe ka pasoja negative në përmirësimin e gjendjes së tyre mentale. Në mes të vitit 2004, pas kërkesave të Ombudspersonit që kjo situatë të zgjidhet, autoritetet kompetente të UNMIK-ut e informuan Ombudspersonin që ata kishin marrë autorizimin nga Ministria e Shëndetit që ta mbyllin një krah të Klinikës së Neuropsikijatrisë në Prishtinë, që do të mundësonte që kryerësit e veprave penale të ndahen nga pacientët e rëndomtë dhe do të lejonte zvogëlimin e numrit të policëve të emëruar për të ruajtur pacientët e sektorit të drejtësisë.

## **AKTIVITETET DHE VEPRIMET E INSTITUCIONIT TE OMBUDSPERSONIT**

### ***Aktivitetet kryesore***

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, ka pasur një rritje konstante të aktiviteteve të Institucionit të Ombudspersonit, si në aspektin ligjor ashtu edhe në atë praktik.

Një shembull i tillë është bashkëpunimi me Kordinatorin e ri të UNMIK-ut për Standarde. Në nëntor të vitit 2003, gjatë diskutimit rreth asaj se çfarë duhet të jenë standardet për Kosovën, Ombudspersoni i dorëzoi një listë sugjerimesh rreth standardeve të cilat ai i konsideronte si më të rëndësishmet dhe të cilat nuk ishin përfshirë në draftin e standardeve të përpiluar nga UNMIK-u për PSSP-në. Gjatë tërë periudhës për të cilën raportohet, Koordinatorin e UNMIK-ut për Standarde është informuar rreth intervenimeve të rëndësishme ose letrave të cilat Ombudspersoni ua ka dërguar Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes.

Hartimi i standardeve për Kosovën, i prezantuar nga UNMIK-u dhe IPVQ në dhjetor 2003 poashtu thotë se institucionet demokratike do të konsiderohen të jenë duke vepruar si duhet vetëm nëse “rekomandimet e Ombudspersonit merren plotësisht parasysh”.

Më 6 nëntor 2003, PSSP publikoi Rregulloren e UNMIK-ut No. 2003/32, përmes së cilës u miratua Ligji për Qasje në Dokumentet Zyrtare (No.2003/12). Në Paragrafin 7.1. A të këtij Ligji, Institucioni i Ombudspersonit është përmendur si një prej dy zgjidhjeve për personat, të cilëve nuk u është dhënë përgjegjje ose u është refuzuar kërkesa për qasje në dokumente. Në mënyrë që t'i përshtatet kësaj fushe të aktiviteteve, stafi i Ombudspersonit ka ndjekur një trajnim më 31 maj dhe më 1 qershor 2004, të organizuar dhe financuar nga Këshilli i Evropës.

Më 25 shkurt 2004, një delegacion i Institucionit të Ombudspersonit u takua me udhëheqësit politik të minoriteteve ashkali, romë, boshnjak, goran dhe turk në mënyrë që të vlerësojë situatën e këtyre minoriteteve. Ky takim u mbajt në Prizren në zyret e OJQ “Inicijativa 6”, e cila është aktive në fushën e të drejtave të minoriteteve në Kosovë. Ishte

ky takimi i parë shqyrtues me liderët e minoriteteve jo-serbe, që në të ardhmën do të mbahet rregullisht. Një takim i tillë do të mbahet në fillim të korrikut.

Poashtu në shkurt 2004, Ombudspersoni vizitoi të gjitha Gjykatat e Qarkut dhe Prokuroritë e Kosovës, si dhe Gjykatën Supreme të Kosovës, në mënyrë që të vlerësojë situatën e gjyqësisë si dhe problemet me të cilat ballafaqohen prokurorët.

Krahasuar me periudhën e fundit për të cilën është raportuar, Ombudspersoni dhe përfaqësuesit e Zyrës së UNMIK-ut për Kthim dhe Komunitete kanë rritur gjithnjë e më shumë bashkëpunimin e tyre në interes të personave të kthyer si dhe atyre të zhvendosur. Në një rast, përpjekjet e përbashkëta të Ombudspersonit dhe zyres së lartëpërmendur mundësuan rikyçjen e rrymës elektrike në qendrat kolektive në Brezovicë dhe Shtërpce, ku personat e zhvendosur ishin duke qëndruar. Në një rast tjetër, Ombudspersoni ngriti çështjen e masave adekuate të sigurisë në mënyrë që fëmijëve serbë t'u mundësohej shkollimi në gjuhën e tyre amtare. Pas kësaj Zyra e UNMIK-ut për Kthim dhe Komunitete bëri përpjekje që të sigurojë përpjekje përkatëse për transport deri në shkollë.

Bashkëpunimi poashtu u arrit edhe me Zyrën për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Çështje Gjinore, që është krijuar rishtas në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës. Ombudspersoni poashtu mbajti konsultime me Ministrinë e Punës lidhur me çështjen e pensioneve dhe asistencës sociale për personat e moshuar dhe invalidët në Kosovë.

Edhe pse Institucioni i Ombudspersonit nuk ka juridiksion mbi KFOR-in, bashkëpunimi me KFOR-in ka vazhduar edhe gjatë kësaj periudhe. Përfaqësuesit e Institucionit të Ombudspersonit kanë pasur disa takime dhe forma tjera të kontaktit me Këshilltarin Ligjor të KFOR-it dhe ka bashkëpunuar me njësitë të ndryshme nacionale të KFOR-it rreth çështjes së sigurisë dhe ndihmës humanitare, posaçërisht për personat e zhvendosur, të cilët qëndronin në ato kampe pas trazirave të 17 – 20 marsit. Ombudspersoni poashtu ka vënë kontakt me KFOR/NATO-n rreth njohjes dhe kompensimit të mundshëm për viktimat e autobusit të udhëtarëve që NATO aksidentalisht e bombardoi në urën afër fshatit Luzhan.

Gjatë periudhës për të cilën raportohet ka pasur disa konsultime mes Ombudspersonit dhe Përfaqësuesit Special të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, gjatë të cilave Ombudspersoni i ka siguruar Përfaqësuesit Special raportet e Institucionit të Ombudspersonit dhe dokumentet tjera relevante lidhur me situatën e të drejtave të njeriut në Kosovë. Me 16 mars 2004, Ombudspersoni udhëtoi në Paris për të prezantuar Mekanizmin për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut në Kosovë në seancën e Komitetit për Çështje Juridike dhe të Drejta të Njeriut të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës. Ai poashtu pati kontakte me struktura të Këshillit të Evropës për situatën e të drejtave të njeriut në Kosovë, posaçërisht lidhur me personat e zhvendosur që për momentin jetojnë në Serbi dhe Mal të Zi. Konsultime të ngjashme janë mbajtur edhe me përfaqësues të Parlamentit Evropian, Bashkësisë Evropiane, OSBE-së, si dhe me qeveri të vendeve të ndryshme dhe OJQ-ve.

Ka pasur poashtu edhe një shkëmbim të gjërë informatash dhe forma të tjera të bashkëpunimit mes Ombudspersonit dhe Zyreve të Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut në Beograd dhe Prishtinë. Ombudspersoni poashtu është konsultuar dhe ka bashkëpunuar me Komisionerin e Serbisë për Refugjatë rreth situatës së personave të

zhvendosur, të cilët aktualisht jetojnë në Serbi, si dhe me Kryetarin e Qendrës Koordinuese për Kosovën dhe Metohinë rreth kushteve të jetesës së komunitetit serb në Kosovë.

Për më tepër, Ombudspersoni ka vazhduar bashkëpunimin dhe komunikimin me OJQ-të ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë, posaçërisht me ICG dhe Human Rights Watch, në mënyrë që të shkëmbej mendime rreth zhvillimeve të fundit në Kosovë nga perspektiva e të drejtave të njeriut.

Është rritur niveli i bashkëpunimit me mediat lokale dhe ndërkombëtare, qoftë përmes intervistave që Ombudspersoni i ka dhënë, qoftë përmes komunikatave për shtyp të zyrtarit për shtyp të Institucionit të Ombudspersonit. Ombudspersoni shpesh herë shfrytëzoi mediat për të publikuar reagimet e tij kundër zhvillimeve të caktuara ose incidenteve në Kosovë lidhur me të drejtat e njeriut. Gjatë periudhës për të cilën raportohet, përafërsisht 1000 raporte dhe intervista të tilla janë publikuar nga mediat në Kosovë dhe Serbi dhe Mal të Zi.

Gjatë muajve qershor, korrik dhe gusht të vitit 2003, studentët e Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës kanë ndjekur trajnime në Institucionin e Ombudspersonit. Kjo praktikë do të vazhdojë gjatë muajve të verës së vitit 2004. Ka pasur poashtu plan për të bashkëpunuar edhe me Universitetin e Mitrovicës.

Në mënyrë që të përmirësohet mbrojtja e kategorive specifike të të drejtave të njeriut, siç janë të drejtat e fëmijëve dhe e drejta për të gjithë personat për të mos qenë të diskriminuar, Ombudspersoni ka themeluar dy grupe speciale – Grupin për Mosdiskriminim (GMD) dhe Grupin për të Drejtave të Fëmijëve (GDF). Në bazë të një marrëveshjeje speciale, Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë (UNICEF) do të përkrahë punën e GDF-së, me të cilin do të ketë bashkëpunim të afërt.

Në janar 2004, Institucioni i Ombudspersonit, në bashkëpunim me Fondin Zhvillues të Kombeve të Bashkuara për Femra (UNIFEM), organizoi trajnim rreth barazisë gjinore për të gjithë juristët që punojnë me Institucionin e Ombudspersonit. Në mars të vitit 2004, të dy ekipet filluan punën, nën mbikëqyrjen e Zëvendës Drejtorit të Hetimeve, të emëruar enkas për këtë qëllim, dhe të ndihmuar nga një konsultant ndërkombëtar. Që nga prilli 2004, një këshilltar ndërkombëtar iu bashkangjiti këtij konsultanti për ta ndihmuar rreth monitorimit dhe mbikëqyrjes së punës këtyre dy grupeve. Tashmë janë organizuar takimet me OJQ-të për të drejtat e fëmijëve, që planifikohen të jenë të rregullta, dhe pritet që kjo praktikë të fillohet së shpejti edhe me OJQ-të që merren me të drejtat e femrave.

Edhe pse GDF ka filluar të veprojë që nga marsi i vitit 2004, ceremonia inauguruese nuk është mbajtur deri në fund të majit 2004. Me këtë rast, Institucioni i Ombudspersonit ftoi përfaqësues të institucioneve qeveritare vendore, OJQ-ve, dhe entiteteve të tjera të përkushtuara në mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Në fillim të qershorit të vitit 2004, Ombudspersoni takoi përfaqësues të Programit Ndërkombëtar për Eliminim të Punës së Fëmijëve të Zyres Ndërkombëtare të Punës në mënyrë që të diskutojë situatën e fëmijëve që punojnë në Kosovë si dhe mundësitë për bashkëpunim të mëtutjeshëm.

Aktivitetet primare të GDF-së janë hetimet rreth aspekteve të përgjithshme të shkeljes së të drejtave të fëmijëve, si dhe shqyrtimi i ankesave individuale të fëmijëve ose përfaqësuesve të fëmijëve. Në bazë të hetimeve, GDF pastaj do të diskutojë me Ombudspersonin se cilat

veprime do të jenë të përshtatshme, gjithmonë duke pasur parasysh atë që është më e mira për fëmijët në fjalë.

Një prej rasteve të para të GDF-së përfshinte problemin e fëmijëve të të vejave të luftës që jetonin pa siguri sociale, dhe që për shume vite kanë qenë në gjendje të marrin pjesë në udhëtime verore të organizuara në bregdetin e Shqipërisë, falë punës së OJQ-së *Lift Kosovo*. Përkundër praktikave të mëhershme, policia kufitare e UNMIK-ut nuk kishte lejuar këta fëmijë të hyjnë në Shqipëri pa pasur dokumente udhëtimi të UNMIK-ut. Për këtë arsye, në maj të vitit 2004, Ombudspersoni intervenoi dhe kërkoi nga Zëvendës PSSP (ZPSSP) për Administratë Civile që t'i liroj këto të veja nga obligimi i pagesës për dokumente udhëtimi, pasi që ato nuk ishin në gjendje të paguanin për një taksë të tillë. ZPSSP kompetent u përgjigj pas një jave dhe informoi Ombudspersonin se Drejtoria për Çështje Administrative do t'i pajiste këtë grup fëmijësh me një dokument të përbashkët të përkohshëm të udhëtimit që do të ishte i lirë nga çfarëdo lloj pagese.

Një rast tjetër me të cilin është marrë GDF-ja ka qenë në lidhje me pohimet e mediave kosovare që Ministria e Shëndetësisë nuk i kishte pajisur repartet e materniteteve në spitalet publike me vaksinën BCG, përderisa kjo vaccine me sa dukej mund të blehej në farmacitë e Kosovës, pa kaluar paraprakisht kontrollin e domosdoshëm mjekësor.

Sa i përket GMD-së, ky ekip do të kryejë hetime të të gjitha formave të diskriminimit, duke përfshirë, por duke mos qenë i kufizuar vetëm në to, diskriminimin në bazë të gjinisë, religjionit, origjinës, bindjes politike apo lidhjes me ndonjë minoritet kombëtar. Këto hetime mund të jenë të natyrës së përgjithshme ose të bazuara në ankesa individuale.

Mes tetorit të vitit 2003 and marsit të vitit 2004, Ombudspersoni publikisht kritikoi aspekte të caktuara të Projekligjit për Barazi Gjinore, të hartuar nga Parlamenti i Kosovës, lidhur me idenë për të caktuar një Ombudsperson për t'u marrur enkas me çështje gjinore. Sipas Ombudspersonit, themlimi i një organi të tillë rezultonte në përputhjen e kompetencave të të dy Ombudspersonave. Duke pasur parasysh se të drejtat e njeriut lidhur me barazinë gjinore janë patjetër të drejta të njeriut, do të ishin dy Ombudspersona që punojnë në të njëjtën fushë, që do të shkaktonte huti dhe do të rezultonte në shpenzime të panevojshme të qeverisë. Ombudspersoni poashtu paralajmëroi se caktimi i një Ombudspersoni të tillë do të ishte në kundërshtim me Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme dhe Rregulloren 2000/38 të UNMIK-ut për Themelimin e Institucionit të Ombudspersonit. PSSP-ja gjithashtu e përkrahu këtë qëndrim.

Kjo kritikë rezultoi në përgjegje të vullshme nga Kryetari i Komisionit për Barazi Gjinore, i cili akuzoi publikisht Ombudspersonin për “ndërhyrje flagrante” në kompetencat e institucioneve të Kosovës. Në qershor të vitit 2004, pas shumë diskutimeve, PSSP shpalli Ligjin për Barazi Gjinore. Sipas këtij ligji, rastet e diskriminimit në bazë të gjinisë dhe çështjeve tjera gjinore do të hetoheshin nga ana e një njësie të posaçme të Institucionit të Ombudspersonit, të krijuar enkas për këtë qëllim. Procedura që do të duhej ndjekur në këto raste do të ishte e njëjtë si ajo për të gjitha çështjet tjera të të drejtave të njeriut pranë Institucionit të Ombudspersonit.

Institucioni i Ombudspersonit poashtu mori pjesë në debatet rreth aspekteve të caktuara të Projektligjit të ri Kundër Diskriminimit, i cili deri diku parashtron probleme të ngjashme sikurse edhe Projektligji për Barazi Gjinore.

GMD inicioi hetimet rreth rastit të reagimeve të autoriteteve publike lidhur me bartjen e shamive të kokës në shkolla publike. Si rrjedhim i kësaj, një raport special lidhur me këtë çështje u publikua në qershor të vitit 2004. GMD poashtu punoi edhe në rastin që kishte të bëjë me diskriminimin e nxënësve goranë, të cilët nuk mund të vijonin mësimin në gjuhën e tyre amtare. Për më tepër, Ombudspersoni inicioi hetimet *ex-officio* lidhur me përdorimin publik të gjuhës serbe në Kosovë.

### ***Aktivitetet që përrollën ngjarjet e dhunshme të Marsit 2004***

Menjëherë pas shpërthimit të dhunës më 17 – 20 mars 2004, Ombudspersoni publikisht apeloj te popullata e Kosovës, duke kërkuar nga personat e involvuar që të distancoheshin nga dhuna a mëtejshme dhe u bëri thirrje të gjithë politikanëve që të bëjnë përpjekje maksimale për t'i dhënë fund gjakderdhjes. Ai poashtu iu bëri thirrje mediave që t'i raportojnë ngjarjet në mënyrë të përgjegjshme dhe të ndershme, në mënyrë që mos të acarojnë krizën ekzistuese.

Pas disa ditësh, Ombudspersoni dhe zëvendësi i tij vizituan vende të ndryshme të Kosovës në mënyrë që të merrnin pasqyrë të qartë rreth dëmeve dhe situatës në të cilën gjendeshin minoritetet pas këtyre ngjarjeve. Ata u takuan me përfaqësues të serbëve dhe disa komuniteteve jo-serbe dhe diskutuan dhunën e fundit të drejtuar kundër tyre, nevojën për ndihmë humanitare dhe perspektivën për të ardhmen e tyre në Kosovë.

Ombudspersoni poashtu vizitoi Kampin e KFOR-it në Prishtinë, ku ishin evakuuar shumë persona të cilët kishin qenë viktima të protestave të dhunshme. Ombudspersoni dhe përfaqësuesit e këtyre personave diskutuan rreth situatës aktuale dhe, mes tjerash, u siguria që fëmijët e vegjël dhe gratë shtatzënë do të dërgoheshin menjëherë në fshatin Graçanicë për trajtim dhe pajisje adekuate. Pas kësaj vizite, Ombudspersoni poashtu publikoi një apel urgjent për organizatat lokale dhe ndërkombëtare që vepronin në Kosovë që menjëherë të siguronin strehim të përkohshëm dhe gjëra elementare për të evakuarit serbë dhe jo-shqiptarë të cilët gjendeshin në kampet e KFOR-it.

Ombudspersoni poashtu vizitoi Kampin e KFOR-it në Prizren, ku ishin evakuuar persona të nacionalitetit jo-shqiptar si dhe kampin e KFOR-it në Novosellë, ku gjendeshin anëtarë të komunitetit ashkali, të evakuuar nga Vushtrria. Sipas kërkesës së përfaqësuesve të këtyre ashkalive, Ombudspersoni organizoi dhe udhëhoqi një konferencë për shtyp, e cila u mundësoi këtyre personave që të përkujtojnë gazetarët e mediave lokale reth verzionit të tyre për ngjarjet e marsit.

Në ditët dhe javët që pasuan, Ombudspersoni dha disa intervista për mediat e Kosovës, Serbisë dhe vendeve të tjera, në të cilat ai diskutoi situatën në Kosovë pas ngjarjeve të dhunshme të marsit nga perspektiva e të drejtave të njeriut.

Pas informative dhe raporteve individuale rreth këtyre ngjarjeve të dhunshme, Ombudspersoni inicioi hetime rreth aspektit të të drejtave të njeriut në regimet e autoriteteve lokale dhe ndërkombëtare lidhur me ngjarjet e marsit 2004. Këto hetime ende vazhdojnë.

Ombudspersoni poashtu ka intervenuar tek policia e UNMIK-ut në Mitrovicën veriore, duke kërkuar prej tyre që të zhvillojnë hetime rreth pohimeve se pas dhunës së marsit grupe



njerëzish kanë larguar me force familje shqiptare nga shtëpitë e tyre në Mitrovicën veriore. Me sa duket, hetimet e policies ende vazhdojnë, por Ombudspersoni ende merret me këtë çështje.

### *Ndërmjetësimi*

Një prej detyrave të Ombudspersonit është ndërmjetësimi dhe ofrimi i shërbimeve të mira në raste kur ka gjasa që ngatërresa ose konflikti të zgjidhet në këtë mënyrë. Kjo pjesë e punës së OIK-së konsiderohet si pjesë e rëndësishme e aktiviteteve të tij. Juristët kanë ndjekur trajnime të zgjeruara në këtë fushë gjatë tërë periudhës për të cilën raportohet.

Më 5 shtator 2003, pas trazirave të dhunshme në burgun e Dubravës, në të cilat pesë të burgosur humbën jetën dhe shumë të tjerë u lënduan, të burgosurit hyrë në grevë urie kundër kushteve në burg. Më 7 shtator 2003, përfaqësues të Ombudspersonit morrën pjesë në shumë diskutime dhe bisedime me të burgosurit dhe administratën e burgut dhe eventualisht arritën kompromis mes palëve në fjalë. Më 8 shtator 2003, tre të burgosur vazhduan protestën dhe kërcënuan se do t'i vinin zjarrin koridorit të burgut, në të cilin ata ishin barrikaduar. Në të njëjtën ditë, përfaqësuesit e OIK-së sërish u angazhuan në ndërmjetësimin e këtyre të burgosurve dhe administrates së burgut dhe arritën të gjenin zgjidhje edhe për këtë situatë. Më vonë, Ombudspersoni bashkëpunoi me komisionin e posaçëm që ishte krijuar nga ana e PSSP-së për ta analizuar situatën në burgun e Dubravës.

Gjatë tërë periudhës për të cilën raportohet, Ombudspersoni ka qenë i përfshirë në ndërmjetësimin mes përfaqësuesve të nxënësve boshnjakë dhe goranë, që kishin dëshirë të vazhdonin shkollimin në gjuhën e tyre duke përdorur një planprogram tjetër, dhe përfaqësuesve kompetentë të Ministrisë së Arsimit dhe UNMIK-ut. Në maj të vitit 2004, është gjetur një zgjidhje afatshkurtër për këtë problem edhe pse kjo çështje është larg nga zgjidhja e kënaqshme. Kjo çështje është përshkruar në mënyrë më të hollësishme në pjesën e Raportit që ka të bëjë me situatën e komuniteteve joshqiptare në Kosovë.

Ombudspersoni gjithashtu u angazhua në bisedimet me pjesëtarët e komunitetit ashkali nga Vushtrria. Pas sulmeve në shtëpitë e tyre gjatë ngjarjeve të dhunshme të marsit të vitit 2004, të gjithë pjesëtarët e komunitetit ashkali nga Vushtrria ishin evakuuar në një bazë të KFOR-it francez ku janë duke qëndruar ende. Institucioni i Ombudspersonit ofroi shërbimet e tij të mira në bisedimet mes përfaqësuesve të komunitetit ashkali dhe autoriteteve kompetente publike për të gjetur një zgjidhje të përshatshme. Ka pasur përpjekje të vazhdueshme që të organizohet transferimi i pjesëtarëve të komunitetit ashkali në një motel në Vushtrri, me ç'rast ata hynë në grevë urie. Pas intervenimit të sërishëm të Institucionit të Ombudspersonit, pjesëtarët e komunitetit ashkali u pajtuan të përfundojnë grevën e urisë.

### *Bashkëpunimi me Institucione të tjera të Ombudspersonit dhe organe të ngjashme*

Gjatë kësaj periudhe për të cilën raportohet, OIK ka vazhduar të bashkëpunojë për së afërmi me institucione të ngjashme në ato vende ku angazhimi i autoriteteve ka qenë i domosdoshëm për të zgjedhur problemet me të cilat ballafaqoheshin individë nga Kosova, si p.sh. Ombudspersonin në Bosne dhe Hercegovinë, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Norvegji, Slloveni, Suedi, Ombudspersonin në kantonë në Zvicër, Holandë dhe Mbretëri të Bashkuar, si dhe Komitetet e Peticioneve të Parlamenteve të Landeve të

caktuara Gjermane. Disa prej këtyre situatave përfshinin ankesa kundër trupave kombëtare të KFOR-it.

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, përfaqësues të Institucionit të Ombudspersonit prezentuan punën e OIK-së në takimin e Ombudspersonëve në Bosne dhe Hercegovinë, Bullgari dhe Greqi, si dhe në Tavolinën e Rrumbullakët të Ombudspersonëve të Evropës në Norvegji. Institucioni i Ombudspersonit poashtu dorëzoi raportin rreth punës së Institucionit në prezantimin komparativ të Institucioneve të Ombudspersonit në Evropën Juglindore, të publikuar nga Ombudspersoni i Greqisë dhe Këshilli i Evropës si pjesë e projektit Eonomia për promovimin e Institucioneve të Ombudspersonit në këtë pjesë të Evropës.

Në tetor 2003, Zëvendës Ombudspersoni i Finlandës vizitoi Zyrën Kryesore të Institucionit të Ombudspersonit në Prishtinë.

Gjatë kësaj periudhe për të cilën raportohet, Institucioni i Ombudspersonit poashtu ka vënë themelet e bashkëpunimit dhe ndihmës së mëtutetjeshme me Institucionin e Ombudmanit të themeluar rishtas në rajonin autonom të Vojvodinës dhe në Mal të Zi. Më 26 – 28 maj 2004, një delegacion i Institucionit të Ombudspersonit mori pjesë në seminarin e organizuar me ndihmën e Zyres për Institucione Demokratike dhe të Drejta të Njeriut të OSBE-së (ODIHR), së bashku me delegacionet e Institucioneve të Ombudmanëve të lartëpërmendur në Podgoricë, Mal i Zi. Varësisht nga zhvillimet e ardhshme të Institucionit të Ombudspersonit të Kosovës dhe këtyre dy Institucioneve të Ombudmanit në Vojvodinë dhe Mal të Zi, ekzistojnë plane për të organizuar më shumë takime të kësaj natyre dhe forma tjera të bashkëpunimit të ngushtë në të ardhmen.

### *Përmbledhje e rasteve*

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, më shumë se 4,000 persona e kontaktuan Institucionin e Ombudspersonit për këshillë ose për të paraqitur ankesat formale.

Gjatë 72 Ditëve të Hapura që janë mbajtuar gjatë periudhës për të cilën raportohet, përafërsisht 300 persona u takuan me Ombudspersonin ose zëvendësin e tij. Numri i personave që kanë ardhur në Ditët e Hapura ka treguar një zbritje të vogël ngase Ombudspersoni nuk ka qenë në gjendje që t'i pranojë të gjithë personalisht për shkaqe shëndetësore.

Si edhe gjatë periudhave tjera për të cilat është raportuar, shumica e rasteve të hetuara nga ana e Ombudspersonit kishin të bëjnë me të drejtën e pronës, mungesën e hetimeve mbi vepra penale, keqpërdorimin e autorizimeve, heshtjen administrative, çëshje lidhur me procesin e rregullt gjyqësor, posaçërisht ankesa lidhur me zgjatjen e procedurës gjyqësore, dhe çështje lidhur me punësimin (Shih Aneksin 1).

Ombudspersoni pranoi shumë ankesa që ishin shënuar si raste për veprim (raste CR). Këto raste përfshinin tema të ndryshme të lëndës siç janë çështjet lidhur me ndihmën dhe mirëvajtjen sociale, në veçanti lidhur me njerëzit e pastrehë, ankesat individuale kundër Korporatës Energjetike të Kosovës, problemet lidhur me autoritetet publike hashtë territorit të Kosovës, rastet lidhur me rindërtimin e shtëpive dhe ankesat e ndryshme të të burgosurve anëmbanë Kosovës.

Në periudhën kohore mes 1 korrikut 2003 dhe 30 qershorit 2004, Ombudspersoni publikoi njëzet e dy raporte përfundimtare, prej të cilëve tëtëmbëdhjetë ishin raporte mbi rastet kurse katër ishin raporte speciale (shih Aneksin 3 për përmbledhjet e këtyre raporteve).

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, Ombudspersoni bëri gjashtë kërkesa për masa të përkohshme autoriteteve të qeverisë ose PSSP-së. Një nga këto kërkesa ishte e suksesshme, një ishte pjesërisht e suksesshme dhe katër ishin të pasuksesshme (shih Aneksin 2).

Procedura hetuese është ende në vazhdim e sipër për shumë raste në të cilat ende pritet të verifikohet pajtueshmëria e praktikave të caktuara publike me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Një nga këto raste ka të bëjë me përdorimin e gjuhës serbe në publik nga ana e autoriteteve qendrore dhe komunale në Kosovë, tjetri ka të bëjë me pamundësinë e personave të paaftë për të marrë patentë shoferi për shkak të mungesës së automjeteve të pajisura në mënyrë adekuate. Një procedurë tjetër hetuese ishte hapur lidhur me pajtueshmërinë e paraburgimit të personave me mendje jo të shëndoshë në Repartin e Neuropsikijatrisë të Qendrës Univerzitare Spitalore të Prishtinës dhe Entin për Përkujdesje Sociale në Shtime me standardet ndërkombëtare ligjore. Si edhe në periudhat tjera për të cilat është raportuar, gjithashtu ka shumë raste në pritje për t'u zgjidhur pranë Ombudspersonit lidhur me pohimet e dhunës policore dhe mungesën e hetimeve efektive mbi ato pohime, si dhe një numër i madh i rasteve që kanë të bëjnë me pamundësinë e Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore (DÇPB) për të marrë dhe për të ekzekutuar vendimet e Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore brenda një afati të arsyeshëm. Numri i rasteve që kanë të bëjnë me zgjatjen e procedurës gjyqësore gjithashtu është mjaft i madh.

Pas ngjarjeve të dhunshme në mars të vitit 2004, Ombudspersoni hape hetimet mbi reagimin e autoriteteve publike ndërkombëtare dhe vendore ndaj këtyre ngjarjeve, shikuar nga perspektiva e të drejtave të njeriut. Këto hetime të shumtën kanë të bëjnë me çështjen nëse autoritetet ndërkombëtare dhe vendore përmbushën në mënyrë të duhur obligimin e tyre për të mbrojtur të gjithë banorët e Kosovës dhe pronën e tyre, nëse kishte pasur hetime efikase dhe të pavarura mbi sjelljen e tyre gjatë protestave të dhunshme në mars dhe nëse autoritetet publike janë të obliguara që t'i kompenzojnë viktimat e këtyre ngjarjeve për humbjet e tyre.

Gjithashtu pas trazirave të marsit të vitit 2004, Ombudspersoni hapi hetimet pas ankesave të një numri të familjeve shqiptare nga pjesa veriore e Mitrovicës që pohonin të ishin dëbuar nga banesat e tyre nga ana e një grupi të personave.

### ***Përkrahja financiare dhe në të mira***

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, Institucioni i Ombudspersonit ka përdorur fonde të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, Këshillit të Përhershëm të OSBE-së, si dhe donatorëve të përbashkët vijues: Danimarkë, Lihtenshtajn, Norvegji, Poloni, Zvicër, Turqi dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Projekte speciale janë financuar nga Këshilli i Evropës, ODIHR, UNICEF dhe UNIFEM.

Kah fundi i majit të vitit 2004, Ombudspersoni u dërgoi letra disa qeverive Evropiane duke kërkuar ndihmë financiare në mbështetje të punës dhe efikasitetit të Institucionit të Ombudspersonit.

Në qershor të viti 2004, Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA) miratoi projektin për edukim të avancuar për stafin e Institucionit të Ombudspersonit në fushën e të drejtave të njeriut, qeverisjes së mirë, administrates së përgjithshme, pajtimit dhe ndërmjetësimit. Metodatat për ta arritur këtë përfshijnë trajnime të avancuara në fushën e të drejtave të njeriut ose në fusha të ngjajshme, kurse të gjuhës angleze dhe vizita studimi në institucione të ndryshme të Ombudsmanit.

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, Këshilli i Evropës ka organizuar dhe financuar, mes tjerash, vizita studimi në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strazburg, Francë, trajnimin për qasje në dokumente në Prishtinë në maj/qershor 2004 dhe vizita këshillimi të Ombudspersonit në Strazburg në nëntor të vitit 2003 dhe maj të vitit 2004.

Pjesëmarrja në një takim të Ombudsmanëve në Sofie, Bullgari u financua nga projekti Eunomia, i cili është një projekt i përbashkët i Këshillit të Evropës dhe Ombudspersonit të Greqisë. Një vizitë studimi Ombudsmanit të Greqisë në dhjetor të vitit 2003 u financua nga Këshilli i Evropës dhe OSBE-ja.

Në shtator të vitit 2003, Fondacioni i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut financoi vizitën e dy juristëve të Institucionit të Ombudspersonit në shkollën verore të Fondacionit të Helsinkit për të drejtat e njeriut, që u mbajt në Varshavë.

### *Përspektivat e ardhshme për Institucionin e Ombudspersonit*

Që nga korriku i vitit 2003, në vijë me kosovarizimin e tij gradual, Institucioni i Ombudspersonit ka reduktuar dukshëm stafin e tij ndërkombëtar, kështu që duke filluar nga ajo datë të gjitha pozitat e larta të Institucionit janë plotësuar nga kosovarët. Ombudspersoni mbeti i vetmi ndërkombëtar në institucion. Më 26 maj 2004, PSSP vendosi të zgjasë mandatin e Ombudspersonit deri më 10 korrik 2005.

Në ndërkohë, me qëllim të vazhdimit të trajnimit në formë të pjesëmarrjes aktive për stafin vendor të institucionit të Ombudspersonit dhe të zgjidhjes së rasteve që përfshinin prezencën ndërkombëtare dhe problemeve ndëretnike të cilat ende ekzistojnë, Institucioni ka pranuar mbështetje të konsiderueshme nga konsulentë dhe këshilltarë që punojnë brenda dhe jashtë Kosovës. Një ndihmë e tillë mbetet e domosdoshme për një periudhë të caktuar kohore. Ajo poashtu do të ndihmojë në zgjerimin dhe zhvillimin e strukturave të Ombudspersonit, jo vetëm me qëllim të përmirësimit të funksionimit të institucionit, por edhe me qëllim që t'i përgjegjet në mënyrë adekuate zgjerimit të juridiksionit të Ombudspersonit në fusha të reja.

Një problem që kërcënoi të pengojë rëndë funksionimin e Institucionit të Ombudspersonit ishte çështja e pagave të stafit vendor. Me vendim të OSBE-së, këto paga u reduktuan dukshëm në mes të vitit 2003. Pagat e stafit të Institucionit të Ombudspersonit u vunë nën kompetencat e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës. Këto paga ishin të pamjaftueshme për stafin vendor për të siguruar angazhim adekuat dhe punë profesionale nga ana e tyre. Përkundrazi, pagat ishin aq të vogla sa që pothuajse provokuan largimin masiv të stafit

kryesor profesional të Institucionit, të cilët gjatë tri viteve të fundit ishin trajnuar për të pranuar gjithnjë e më shumë përgjegësi. Humbja e këtij stafi do të vënte në pikëpyetje ekzistencën dhe qëndrueshmërinë e institucionit të Ombudspersonit. Pas diskutimeve intensive, posaqërisht me UNMIK-un, Ombudspersoni më në fund arriti të merrte pëlqimin e PSSP-së për një skemë të përkohshme të pagave që do të siguronte paga më të larta për stafin profesional dhe nivel më të lartë pavarësie nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, së paku për vitin 2004. Çështja e pagave për vitin 2005 ka mbetur e hapur.

Këto ngjarje ishin një mësim i rendësishëm për ne, në kuptim të asaj se tërë puna dhe funksionimi i një institucioni, siç është institucioni ynë, lidhet në shkallë të lartë me çështjen e pagave. Nuk duhet të ketë kompromis rreth sigurimit të pagave adekuate për stafin profesional për punën dhe kualitetin e tyre. Stafi kryesor duhet të marrë paga përkatëse në mënyrë që Institucioni i Ombudspersonit të mund të vazhdojë punën e tij të kualitetit të lartë. Më duhet të theksoj se ne kemi arritur një zgjidhje të kënaqshme për deri në fund të vitit 2004 falë bashkëpunimit me PSSP-në dhe, në një pikë, me zyrtarët e qeverisë që janë përgjegjës për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës. Sidoqoftë, Ombudspersoni është i bindur që stafi i Institucionit do të marrë pagat përkatëse edhe në vitet e ardhshme.

Sa i përket natyrës së institucionit të Ombudspersonit në të ardhmen dhe parashikimet e përgjithshme në këtë aspekt, qëllimi përfundimtar mbetet transformimi i institucionit në një organ të përbërë dhe të udhëhequr tërësisht nga Kosovarët. Ende nuk është arritur ndonjë vendim përfundimtar se kur do të ndodhë kjo. Një ide është që Institucioni të kosovarizohet tërësisht posa të arrihen standardet për Kosovën, në të cilat Ombudspersoni do të vazhdojë të luajë një rol aktiv. Ideja tjetër, e sugjeruar nga shumica dhe e përkrahur edhe nga vetë Ombudspersoni, është që një Ombudsperson ndërkombëtar të udhëheqë institucionin aq sa bashkësia civile ndërkombëtare të jetë prezente në Kosovë. Së paku për momentin, vetëm një Ombudsperson ndërkombëtar do të ishte në gjendje të garantonte funksionimin e Institucionit të Ombudspersonit si një institucion i pavarur që mbulon strukturat qeveritare ndërkombëtare dhe vendore, duke marrë parasysh në të njëjtën kohë interesat e të gjitha bashkësive etnike në Kosovë. Këtë qëndrim, mes tjerësh, e kanë përkrahur politikanët kryesorë të Kosovës si dhe qeveria e Serbisë në letrën dërguar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara dhe Sekretarit të Përgjithshëm të OSBE-së në verën e vitit 2003.

Marek Antoni Nowicki  
Ombudspersoni

## Aneksi 1: Përmbledhje statistikore e rasteve

(1 korrik 2003 deri më 30 qershor 2004)

<u>ÇËSHTJET E REGJISTRUARA PËRKOHËSISHT (APLIKACIONET):</u>	<u>420</u>
<u>PËRKATËSIA ETNIKE E APLIKANTËVE:</u>	
Shqiptarë:	289
Serbë:	96
Të tjerë:	35
<u>PALËT PËRGJEGJËSE:</u>	
UNMIK:	269
IPVQ:	85
DÇPB:	54
KFOR:	24
Të tjera:	22
<u>ÇËSHTJET E SHPALLURA TË PAPRANUESHME</u>	<u>124</u>
<u>ÇËSHTJET E FSHIRA NGA LISTA:</u>	<u>148</u>
ÇËSHTJET E ZGJEDHURA POZITIVISHT:	63
ÇËSHTJET E NDËRPRERA GJATË PROCEDURËS PËR ARSYE TJERA:	85
<u>HETIMET E HAPURA</u>	<u>75</u>
HETIMET E BAZUARA NË APLIKACIONE:	62
HETIMET <i>EX OFFICIO</i> :	13
<u>REPORTET PËRFUNDIMTARE TË PUBLIKUARA</u>	<u>22</u>
RAPORTE MBI RASTET:	18
RAPORTE SPECIALE:	4

<u>KËRKESAT PËR MASA TË PËRKOHSHME:</u>	<u>6</u>
<u>RASTET PËR VEPRIM (GJITHSEJT)</u>	<u>753</u>
RASTET E ZGJEDHURA POZITIVISHT:	172
RASTET E NDËRPRERA GJATË PROCEDURËS PËR ARSYE TJERA:	319
<u>KORRESPONCA E PRANUAR:</u>	<u>1576</u>
<u>KORRESPONDENCA E DËRGUAR:</u>	<u>1483</u>

## **Aneksi 2: Përmbledhje e kërkesave për masa të përkohshme (1 korrik 2003 – 30 qershor 2004)**

### **Kontestet pronësore në Suharekë**

*Më 21 dhjetor 2002, Ombudspersoni pranoi një ankesë, në të cilën aplikanti ankohej për zgjatjen e procedurave para Gjykatës Komunale të Suharekës/Suwareka lidhur me ankesën civile të aplikantit kundër Drejtorisë së Planifikimit Urban në Suharekë/Suwareka lidhur me pronësinë e një pjese toke në Suhareke/Suwareka. Më 20 maj 2003, pas informatës se Drejtoria e lartëpërmendur në ndërkohë kishte lëshuar leje ndërtimi lidhur me pjesët e pronave në fjalë, Ombudspersoni i dërgoi kërkesë Kryetarit të Gjykatës Komunale në Suharekë/Suwareka, duke kërkuar prej tij që të ndërmirrite masa urgjente në mënyrë të Drejtorati i Planifikimit Urban në Suharekë/Suwareka të anulonte vendimin për lejimin e ndërtimit në pronat, pronësia e të cilave ishte e diskutueshme dhe të siguronte se ndërtimi do të ndalej menjëherë. Më 2 qershor 2003, për shkak të mospërgjegjjes në kërkesën në fjalë, Ombudspersoni i dërgoi kërkesë PSSP-së për masa të përkohshme, duke kërkuar prej tij që të urdhëronte Drejtorinë e Planifikimit në Suharekë/Suwareka që të anulonte vendimet që ai i kishte lëshuar për lejimin e ndërtimit në pronat të cilat ishin subjekt i procedurave gjyqësore dhe të siguronte se të gjitha ndërtimet do të ndaleshin menjëherë.*

**4 gusht 2003:** Ombudspersoni i dërgoi U.D. PSSP-së një kërkesë tjetër për masa të brendshme duke shprehur brengën e tij lidhur me mospërgjegjjen në kërkesën e tij të mëparshme.

**31 dhjetor 2003:** Ombudspersoni pranoi letër nga PSSP-ja, i cili informonte atë për aksionin - Përfaqësuesi Komunal i UNMIK-ut kishte hetuar çështjen. Nga ky hetim doli se lejet e domosdoshme për ndërtim ishin lëshuar në bazë të provave ligjore, pasi që dokumentet përkatëse pronësore ishin dorëzuar në Drejtorinë për Planifikim Urban. Zëvendës PSSP-ja më tutje spjegonte se, duke pasur parasysh se deklarata pronësore e aplikantit ende priste të shqyrtohej nga gjykata dhe duke pasur parasysh këshillën e Këshilltarit Ligjor të UNMIK-ut ai nuk e kishte konsideruar atë si të përshtatshme për UNMIK-un për të intervenuar para se gjykata kompetente të merrte vendim final.

**6 qershor 2004:** Ombudspersoni i dërgoi letër Kryemistrit të Kosovës, duke shprehur brengën e tij lidhur me situatën e lartëpërmendur, dhe duke theksuar se nuk ishte e lejueshme që të fillonte ndërtimi në ato prona, pronësia e së cilës është e diskutueshme. Ky lloj i sjelljes do të krijohet fait accompli, i cili do t'i shkaktonte interesave të palës tjetër dëme të pariparueshme. Ombudspersoni konsideronte se Drejtoria për Planifikim Urban e Komunës së Suharekës/Suwareka në veçanti kishte ndihmuar qartas në krijimin e kësaj situatë duke lëshuar lejet e domosdoshme për ndërtim. Kjo sjellje në veçanti ishte e papranueshme duke pasur parasysh se, pasi që komuna ishte direkt e involvuar në procedura relevante lidhur me pronësinë, ajo është dashur ta dinte se asnjë vendim lidhur me këtë pjesë të veçantë të pronës nuk është dashur të mirret para se Gjykata Komunale të merrte vendim përfundimtar rreth pronësisë. Ombudspersoni theksonte se nëse Gjykata Komunale mund të vendoste në favor të aplikantit, do të ishte shumë vështirë për tu kthyer në status quo ante dhe do të krijohet situatë në të cilën aplikanti do të duhej të kompensohej



për këtë humbje. Ombudspersoni kërkoi nga Kryeministri që të përdorte pozitën e tij për t'i dhënë fund situatës së lartëpërshkruar.

### **Mbrojtja e pemishteve private në fshatin Morinë**

*Më 27 mars 2002, Ombudspersoni pranoi një ankesë nga një numër personash, banorë të fshatit Morinë, të cilët ankoheshin se pemët e mbjellura në pronat e tyre private ishin prerë dhe se policia nuk kishte reaguar fare pas marrjes së informatës. Më 8 maj 2002 Ombudspersoni i dërgoi një kërkesë për masa të përkohshme PSSP-së, duke kërkuar prej tij që të siguronte mbrojtje të pemishteve private. Më 30 gusht 2002, për shkak të mos përgjegjjes ndaj kërkesës paraprake, Ombudspersoni i dërgoi PSSP-së kërkesën e dytë, duke kërkuar sërish nga ai që të ndërmirte masa urgjente lidhur me çështjen e lartëpërmendur.*

**6 qershor 2003:** Ombudspersoni i dërgoi PSSP-së kërkesën e tretë për masa të përkohshme duke shprehur brengosjen e tij për shkak të mospërgjegjjes në kërkesat e mëparshme.

**16 mars 2004:** Ombudspersoni pranoi letër nga Zëvendës PSPP-ja për Polici dhe Drejtësi, i cili e informonte Ombudspersonin se Komandanti i Stacionit të UNMIK-ut në Gjakovë/Djakovica, i cili ishte përgjegjës për këtë territor, kishte këshilluar policinë që t'i kushtonte vëmendje të veçantë këtij regjioni në mënyrë që të reduktoheshin incidentet e prerjeve ilegale të drunjve. Zëvendës PSSP-ja shpjegonte se në veçanti në vendet ku terreni ishte i vështirë dhe popullata ishte e shpërndarë, siq ishte rasti me rajonin rreth fshatit Morinë, policia duhej të dislokonte resurset e veta në mënyrë strategjike. Ai poashtu theksonte se policia do të pranonte të kishte bashkëpunim më të ngushtë me komunitetin dhe inkurajonte komunitetin që të kontaktonte stacionin policor për të ofruar informata sa më shpesh që të jetë e mundur, në mënyrë që t'i mundësonte policisë rreth vendosjes së trupave si dhe të përmirësonte përgjegjjen e tyre ndaj çfarëdo ankese.

### **Largimi me forcë i një kiosku në Prishtinë**

*Në mars 2004, Ombudspersoni pranoi një ankesë, në të cilën aplikanti ankohej rreth vendimit të Drejtorisë së Inspektoratit të Komunës së Prishtinës për të inicuar procedurë ekzekutive kundër tij për të larguar kioskun e tij. Aplikanti kishte qenë pronar i kioskut që nga viti 1992, kur kishte marrë lejen për të punuar në të. Më 14 shkurt 2003, ai kërkoi nga Komuna e Prishtinës të vazhdonte lejen për kioskun, por nuk mori asnjë përgjegjje. Më 25 shkurt 2004, pas inspektimit në vendngjarje, Drejtoria e Inspektoratit të Komunës së Prishtinës vërtetoi se kiosku ishte përdorur pa leje dhe rrjedhimisht inicioi procedurë ekzekutive për të larguar kioskun. Aplikanti u ankua kundër vendimit për të inicuar procedurë ekzekutive më 3 mars 2004, por sipas ligjit të aplikueshëm, ankesa e tij nuk kishte fuqi për të ndaluar procedurën ekzekutive.*

**8 mars 2004:** Ombudspersoni i dërgoi Kryetarit të Komunës së Prishtinës një kërkesë për masa të përkohshme, duke kërkuar prej tij që të suspendonte procedurën ekzekutive për largimin me forcë të kioskut të aplikantit, duke pritur për rezultatet e hetimeve të Ombudspersonit. Ai poashtu shpjegonte se nëse komuna vendoste t'ij ndiqte procedurën ekzekutive aplikanti do të humbte kioskun e tij përkundër kërkesës së tij të mëparshme për

vazhdimin e lejes, dhe në këtë mënyrë do të bëhej viktimë e dështimit të komuës në konsiderimin e kërkesës së tij për leje brenda një periudhë të arsyeshme kohore.

**Nuk ka pasur përgjegjje për këtë letër.**

### **Largimi me forcë i një shitoreje në Prishtinë**

*Më 17 mars 2004, Ombudspersoni pranoi një ankesë, në të cilë aplikanti ankohej kundër procedurave të inicuar nga Komuna e Prishtinës për të larguar lokalit të tij, që gjendej në qendrën tregtare. Aplikanti kishte blerë këtë shitore në vitin 2002 prej një ndërmarrjeje shoqërore. Më 27 shkurt 2004, Njësi Inspektorial i Komunës së Prishtinës urdhëroi ndërmarrjen shoqërore të lartëpërmendur që të largonte shitoren e aplikantit, në bazë të ankesës së pronarit të shitores fqinje. Ky urdhër u zbatua më 11 mars 2004. Aplikanti kuptoi për këtë urdhër rastësisht. Më 14 mars 2004 aplikanti u ankua pranë Njësisë Inspektuese Komunale kundër këtij urdhëri, duke u thenë se ndërmarrja shoqërore nuk ishte më pronare e shitores dhe se urdhëri i 24 shkurtit 2004 nuk kishte baza ligjore. Në të njëjtën kohë, aplikanti deklaronte se ishte e pakuptimtë që Komuna mos t'a dinte se kush ishte pronari i vërtetë i shitores, duke pasur parasysh se ai kishte paguar taksa që nga viti 2003. Në fund, aplikanti theksonte se në maj 2003, një komision komunal kishte inspektuar tërë qendrën tregtare dhe kishte konkluduar se teknikisht gjithçka ishte në rregull dhe në përputhje me standardet ligjore të aplikueshme.*

**31 mars 2004:** Ombudspersoni i dërgoi Kryetarit të Komunës së Prishtinës një kërkesë urgjente për masa të përkohshme, duke kërkuar prej tij që të suspendonte procedurat lidhur me largimin me forcë të lokalit të lartëpërmendur, dhe të pritëshin rezultatet e hetimeve të Ombudspersonit.

**Nuk ka pasur përgjegjje për këtë letër.**

### **Rrënimi i shtëpisë që gjendej në një pronë për të cilën thuhej të ishte pronë e komunës së Prizrenit**

*Më 5 prill Ombudspersoni pranoi një ankesë, në të cilën aplikanti ankohej rreth vendimit të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër dhe Çështje Pronësore Juridike në komunën e Prizrenit për rrënimin e një shtëpie në një cope toke për të cilën thuhej të ishte prone e komunës. Në këtë vendim, aplikanti, i cili kishte jetuar në shtëpinë në fjalë për 40 vite ishte urdhëruar që t'ia kthente këtë copë të tokës komunës së Prizrenit në kushtet e mëparshme në afat prej dhjetë ditësh nga data e marrjes së vendimit. Sipas drejtorisë për Kadastër dhe Çështje Pronësore Juridike, aplikanti kishte uzurpuar këtë tokë në mënyrë arbitrare më herët. Më 12 qershor 2004, aplikanti i dërgoi ankesë Kryeshefit Ekzekutiv të Prizrenit dhe kërkoi suspendimin e ekzekutimit të vendimit para se ky autoritet të shqyrtonte rastin. Sipas aplikantit, ai e kishte blerë shtëpinë në këtë copë toke nga një person i tretë, i cili e kishte ndërtuar këtë shtëpi para se disa rregulla të caktuara për ndërtim të hynin në fuqi. Më 16 shkurt 2004, Bordi Ekzekutiv refuzoi ankesën e aplikantit. Më 3 mars 2004, aplikanti parashtrroi ankesë në Ministrinë e Shërbimeve Publike në Prishtinë, para së cilës ankesa ishte në procedurë shqyrtimi.*

**6 prill 2004:** Ombudspersoni i dërgoi PSSP-së një kërkesë urgjente për masa të përkohshme, duke kërkuar prej tij që të suspendonte ekzekutimin e vendimit të Drejtorisë për Kadastër dhe Çështje Pronësore Juridike në Komunën e Prizrenit, në mënyrë që mos t'i shkaktohej dëm i pariparueshëm aplikantit dhe familjes së tij, dhe të pritëshin rezultatet e hetimeve të Ombudspersonit.

**16 qershor 2004:** Ombudspersoni pranoi letër nga Përfaqësuesi i UNMIK-ut në Prizren, së bashku me kopje të udhëzimeve të Zëvendës PSSP-së për Adminsitratë Civile, që urdhëronte suspendimin e ekzekutimit të vendimit të lartëpërmendur para se të bëhej ndonjë lajmërim tjetër.

### **Dështimi për të ekzekutuar vendimin për ndalimin e ndërtimeve të egra në Pejë**

*Më 13 maj 2004, Ombudspersoni pranoi ankesë, në të cilën aplikanti ankohej kundër mosekzekutimit të vendimit të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Rural në Komunën e Pejës. Në këtë vendim, pas kërkesës së aplikantit, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Rural kishte urdhëruar një person të tretë të ndalte ndërtimin ilegal të një ndërtese banimi dhjetë metra larg shtëpisë së aplikantit në Pejë. Më 5 maj 2004, aplikanti i dërgoi letër Drejtorit Ekzekutiv të Komunës së Pejës, në të cilën ai kërkonte nga Komuna të ekzekutonte vendimin e lartëpërmendur. Ai poashtu informonte Drejtorin Ekzekutiv se ndërtimi ilegal i ndërtesës së banimit të lartëpërmendur po vazhdonte. Në të vërtetë, gërmimi për themelet e ndërtesës së lartëpërmendur të banimit ishte bërë aq afër garazhës së aplikantit sa që garazha kishte rrëshqitur në gropë, duke paraqitur rrezik madje edhe për shtëpinë e aplikantit.*

**11 qershor 2004:** Ombudspersoni i dërgoi PSSP-së kërkesë urgjente për masa të përkohshme, duke kërkuar nga PSSP-ja të siguronte që Komuna e Pejës të ndërprejë ndërtimin e egër dhe të presë rezultatet e hetimeve të Ombudspersonit, në mënyrë që të parandalohet dëmtimi i mëtutjeshëm i pronës afër vendit ku bëhej ndërtimi i egër.

**Nuk ka pasur përgjegjje për këtë letër.**

### **Aneksi 3: Përmbledhjet e raporteve**

#### PËRMBLEDHJE

Nr. i Regjistrimit 631/02

Lidhur me zgjatjen e procedurës në rastin

**SELIM ZYMI**

Më **1 gusht 2003**, Ombudspersoni në Kosovë, në pajtim me Nenin 4.4 dhe 4.9 të Rregullorës së UNMIK-ut Nr. 2000/38 mbi Themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë dhe Rregullës 18 dhe 19 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, ka publikuar raportin mbi rastin e lartpërmendur.

Në këtë rast, Ombudspersoni gjeti që dështimi i Gjykatës komunale në Gjakovë për të marrë një vendim mbi rastin civil të aplikantit prej 12 tetorit 1992 e deri më datën e publikimit të raporti mbi rastin kishte përbërë shkelje të të drejtës së tij për një proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm, siç është e garantuar me nenin 6 § 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti kishte të bëjë me kërkesën e aplikantit për të iu kthyer parcela që ishte ekspropriuar më herët nga ana e komunës së Gjakovës dhe për të iu dhënë kompenzim i drejtë për pamundësi të shfrytëzimit të saj. Ombudspersoni gjeti që procedura nuk kishte qenë e ndërlikuar dhe që aplikanti nuk kishte qenë fajtor për ngecjet në të. Në anën tjetër, Ombudspersoni gjeti që arsyet e ofruara për ngecje, që kishin të bëjnë me numrin e pamjaftueshëm të punonjësve në gjykata, nuk ishin të mjaftueshme për të arsyetuar mosveprimin e paarsyeshëm të gjykatës, që përfshinte dështimin për ta mbajtur një seancë të vetëm për disa vite para konfliktit të vitit 1999, një vonesë prej 10 javësh për të ia dorëzuar aktgjykimin me shkrim aplikantit, dhe dështimin për të iu përgjegjur për gati dy vite ankesës së aplikantit që ishte ushtruar brenda afatit ligjor. Si shtesë kësaj, Ombudspersoni vërejt që vetë Gjykata komunale kishte kishte bërë gabime gjatë punës me këtë rast dhe kishte ndjekur procedurë joadekuate. Ombudspersoni gjithashtu vërejt që që mungesa e një mjeti efektiv ligjor kundër shkeljes së të drejtës së aplikantit për një proces të rregullt brenda afati të arsyeshëm kishte përbërë shkelje të të drejtës për ankim efektiv sipas nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Ombudspersoni rekomandoi që Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Komeve të Bashkuar, do të duhej që, pa vonesë të metejme dhe jo më vonë se më 15 shtator 2003, të sigurojë shqyrtimin dhe zgjidhjen e rastit të aplikantit pa vonesë të mëtejshme dhe të emërojë një numër të mjaftueshëm të gjykatësve në gjykatat në Pejë ose të ndërmarë masa tjera të domosdoshme për të garantuar shqyrtimin e rasteve dhe dorëzimin e aktgjyqimeve për të gjitha palët brenda një afati të arsyeshëm. Ombudspersoni gjithashtu rekomandoi që PSSP do të duhej të nxjerrë një Rregullore që siguron një mjet efektiv, në kuptim të nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që siguron lehtësim në formë të parandalimit apo kompenzimit lidhur me ankesat për zgjatje të tepruar të procedurës në rastet civile.

Përmes letrës së datës 26 gusht 2003, PSSP u përgjegj duke e informuar Ombudspersonin që një gjykatës shtesë i specializuar në çështjet civile ishte emëruar në Gjykatën e qarkut në Pejë, që do të përmirësonte efikasitetin e kësaj gjykate në zgjidhjen e rasteve civile. PSSP më tutje informoi Ombudspersonin që që Këshilli Gjyqësor dhe i Prokurorisë i Kosovës kishte përgatitur një vlerësim të përgjithshëm që mes tjerash kishte trajtuar edhe nevojat e gjykatave në Kosovë lidhur me punonjësit. Sa i përket kërkesës së Ombudspersonit që rasti i aplikantit të zgjidhet pa vonesë të mëtejshme, PSSP vërejtqië periudha kohore për procedurën civile varet gjithmonë nga veprimet e palëve të përfshira. PSSP shtoi që propozimi i Ombudspersonit që kishte të bëjë me ofrimin e një mjeti efektiv kundër zgjatjes së tepruar të procedurës në çështjet civile ishte duke u marrë parasysh në mënyrë aktive.

## PËRMBLEDHJE

Nr. i Regjistrimit *ex officio* 27/2003

Lidhur me shkatërrimin dhe largimin e pohuar të librave në gjuhën serbe nga biblioteka e qytetit në Gjilan

Më 4 gusht 2003, Ombudspersoni në Kosovë, në pajtim me Nenin 4.4 dhe 4.9 të Rregullorës së UNMIK-ut Nr. 2000/38 mbi Themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë dhe Rregullës 18 dhe 19 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, ka publikuar raportin mbi rastin e lartpërmendur.

Në këtë raport, Ombudspersoni hetoi raportet nga mediat, sipas të cilave libra dhe artikuj tjerë në gjuhën serbe ishin larguar nga biblioteka e qytetit në Gjilan dhe hudhur në deponinë e qytetit. Ombudspersoni hetoi nëse këto veprime kishin përbërë shkelje të të drejtave të njeriut ose keqpërdorim të autorizimeve. Pas hetimeve, doli që edhe pse disa libra në gjuhën serbe me të vërtetë kishin përfunduar në deponinë e qytetit, kjo kishte qenë pjesë e një programi më të gjërë të inventORIZIMIT të bibliotekës duke larguar librat e dëmtuar apo të papërdorshëm. Ky program gjithashtu kishte përfshirë shpërndarjen e librave në gjuhën serbe në bibliotekat lokale në zonat e banuara me serbë në mënyrë që për këto libra të ofrohet qasje më e mirë për një numër më të madh të lexuesve të interesuar. Në pajtim me këtë, Ombudspersoni gjeti që kjo praktikë normale dhe e nevojshme në punën e bibliotekës, e zhvilluar në mënyrë profesionale, nuk ishte largim i paarsyeshëm i librave dhe nuk mund të konsiderohej keqpërdorim i autorizimeve apo shkelje e të drejtave të njeriut.

## PËRMBLEDHJE

RAPORTI SPECIAL Nr. 6

Mbi pajtueshmërinë e praktikës gjyqësore lidhur me një kategori të rasteve kundër personave që kanë përdorur patentë shoferi jovalide të lëshuar nga autoritetet e Republikës Federative të Jugosllavisë, me standardet e pranuar ndërkombëtare

Më **20 nëntor 2003**, Ombudspersoni në Kosovë, në pajtim me autoritetin e dhënë atij sipas nenit 1.1 dhe 4.1 të Rregullorës së UNMIK-ut nr.2000/38 mbi Themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë dhe paragrafeve 3 dhe 4 të Rregullës 22 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit, Ombudspersoni ka publikuar Raportin e lartpërmendur Special.

Në këtë raport, Ombudspersoni konkludoi që rastet kur individët që ishin duke përdorur leje jovalide të lëshuara nga ana e autoriteteve të RFJ-së ishin dënuar për falsifikim sipas nenit 203 të Ligjit Penal të KSAK-së kishin përbërë shkelje të të drejtave të këtyre individëve sipas nenit 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ombudspersoni së pari vërejtë që neni 7 vë në jetë parimin e përgjithshëm që vetëm ligji mund të definojë një krim dhe që një ligj i tillë nuk do të duhej që në masë të madhe të interpretohet të jetë në dëm të të akuzuarit. Në vend të kësaj, sipas nenit 7, ky ligj duhet të jetë i konstruktuar në atë mënyrë që të ofrojë mbrojtje efektive kundër ndjekjes, gjetjes fajtor dhe dënimit arbitrar. Shkurtimisht, interpretimi gjyqësor i ligjit penal duhet të jetë i parashikueshëm në mënyrë të arsyeshme dhe në të njëjtën kohë në pajtim me esencën e veprës penale. Ombudspersoni gjeti që praktika momentale e interpretimit të dispozitave të ligjit penal mbi dokumentet e falsifikuara nuk ishte e parashikueshme. Në fakt, ajo ishte një interpretim i gjërë arbitrar i ligjit, pasi që ekzistonte një dallim fundamental mes një patent shoferi që konsiderohej të jetë jovalid dhe një patent shoferi të falsifikuar.

Ombudspersoni rekomandoi që PSSP, jo më vonë se më 20 dhjetor 2003, të sigurojë që do të shfrytëzohen të gjitha mjetet ligjore përkatëse në dispozicion për ta rivendosur sundimin e së drejtës në këtë kategori të rasteve dhe ta shpërndajë raportin special përmes të gjitha kanaleve përkatëse në të gjitha gjykatat, prokuroritë dhe autoritetet publike.

**Përmes letrës së 18 dhjetorit 2003, ZPSSP për Polici dhe Drejtësi u përgjegj në Raportin Special Nr. 6, duke theksuar që, ashtu siç është e përmendur në këtë raport special, një qarkore e lëshuar nga ana e Departamentit të Drejtësisë e kishte bërë të qartë që aktakuzat për falsifikim nuk ishin të përshatshme për personat që ishin duke përdorur leje jovalide dhe i kishte përkujtuar gjykatësit dhe prokurorët që ngritja dhe/ose konfirmimi i aktakuzave të paligjshme do të mund të rezultonte me sanksionim për sjellje të pahijshme profesionale. Megjithatë, prokurorët kishin vazhduar të ngritnin aktakuza për falsifikim sipas nenit 203 të Ligjit Penal të KSAK-së. Këto raste ishin sjellur në vëmendje të Njësisë për Inspeksion Gjyqësor pranë Departamentit të Drejtësisë.**

**Departamenti i Drejtësisë i kishte shkruar kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe ushtruesit të detyrës së Prokurorit Publik të Kosovës për të kërkuar informata rreth masave që ata kishin ndërmarrë apo planifikonin të ndërmarrin për të siguruar që zbatimin e njejtë dhe të ligjshëm të ligjit të aplikueshëm. Viktimat e dënimeve dhe paraburgimeve të gabuara do të informoheshin rreth asaj që kanë të drejtë të kërkojnë kompensim sipas Qarkores së Departamentit të Drejtësisë Nr. 2001/01 mbi Komisionin për Kompensimin e të Dënuarëve dhe Akuzuarëve Gabimisht dhe/ose Personave të Paraburgosur Gabimisht.**

**Lidhur me rekomandimin e dytë të Ombudspersonit, Shtylla I e UNMIK-ut do të siguronte që Raporti të shpërndahej përmes të gjitha kanaleve përkatëse në të gjitha gjykatat, prokuroritë dhe autoritetet e policisë.**

## PËRMBLEDHJE

Nr. i Regjistrimit 896/03

Lidhur me zgjatjen e procedurën në rastin

FATMIR REXHEPI

Më **25 nëntor 2003**, Ombudspersoni në Kosovë, në pajtim me paragrafin 4.4 dhe 4.9 të Rregullorës së UNMIK-ut nr. 2000/38 mbi Themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë dhe Rregullës 18 dhe 19 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, ka nxjerrë raportin në rastin e lartpërmendur.

Ombudspersoni vërejti që Gjykatës komunale në Ferizaj iu nevojitën gjashtë muaj, deri më 23 tetor 2002, për t'ia dorëzuar Gjykatës së qarkut në Prishtinë ankesën e aplikantit kundër aktgjykimit me të cilin ai u gjet fajtor për falsifikim të dokumenteve dhe që Gjykata e qarkut në Prishtinë nuk kishte marrë ndonjë vendim mbi këtë ankesë deri më datën e nxjerrjes së Raportit mbi rastin. Ombudspersoni vërejti që arsyeshmëria e zgjatjes së procedurës duhet të vlerësohet në bazë të rrethanave të veçanta të një rasti, në veçanti komplikueshmërinë e rastit, sjelljen e palëve dhe autoritetet të përfshira, si dhe atë çfarë është në interes për aplikantin. Kryetari i Gjykatës së qarkut në Prishtinë bëri përpjekje që t'i arsyetojë ngecjet si pasojë e stërngarkesës me punë për një numër të vogël të gjykatësve në gjykatë. Ombudspersoni në vazhdim gjeti që arsyeja e dhënë nuk ishte e mjaftueshme për të arsyetuar ngecjet në procesin e ankimit në këtë rast relativisht të thjeshtë, në të cilin ishte në pyetje liria e aplikantit, dhe që kjo situatë për këtë arsye kishte përbërë shkelje të të drejtës së aplikantit për një proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm siç është e garantuar me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ombudspersoni gjithashtu vërejti që mungesa e ndonjë mjeti juridik kundër shkeljes së të drejtë për një proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm kishte përbërë shkelje të të drejtës për ankim efektiv sipas nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Ombudspersoni rekomandoi që Përfaqësuesi special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (PSSP) do të duhej që të sigurojë që Gjykata e qarkut të përshpejtojë procedurën në rastin në fjalë në mënyrë që të merrtë ndonjë aktvendim pa vonesë të mëtutjeshme dhe të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që, në përgjithësi, shqyrtimi i rasteve penale pranë Gjykatës së qarkut në Prishtinë të kryhet brenda një kohe të arsyeshme. Ombudspersoni gjithashtu rekomandoi që PSSP do të duhej të nxjerrë një Rregullore që siguron një mjet efektiv në kuptim të nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe që ofron zgjidhje si në formë parandalimi ashtu edhe në formë kompenzimi lidhur me ankesat rreth zgjatjes së procedurës në rastet penale.

**Përmes letrës së datës 18 dhjetor 2003, ZPSSP për Polici dhe Drejtësi u përgjegj duke e informuar Ombudspersonin që Gjykata e qarkut në Prishtinë e kishte pranuar në ndërkohë ankesën e aplikantit dhe e kishte kthyer rastin për rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë. ZPSSP gjithashtu theksoi që Këshilli Gjyqësor dhe i Prokurorisë i Kosovës kishte përgatitur një studim të sistemit gjyqësor, që paramendohej të publikohet në janar të vitit 2004, në mënyrë që të identifikohen faktorët me ndikim në paefektshmëritë dhe të sugjerohen reformat përkatëse. Në ndërkohë, PSSP kishte emëruar 19 gjykatës shtesë dhe 7 prokurorë të ri, duke e sjellë numrin e tyre total në**

**316, respektivisht 53. Dy nga gjykatësit e ri dhe një nga prokurorët e ri do të punonin në Gjykatën e qarkut në Prishtinë. Në fund, ZPSSP theksoi që pritej që Departamenti i Drejtësisë të implementojë reforma të caktuara si përgjegje në raportin e Ombudspersonit dhe do të përcaktonte çfarë forme e mekanizmit do të ishte e përshtatshme për të kompenzuar të paditurit në procedurat penale me ngecje të tepruar si dhe për të parandaluar ngecjet e mëtejme.**

## **PËRMBLEDHJE**

Nr. i Regjistrimit 988/03

Lidhur me zgjatjen e procedurës në rastin **HAMIJETE QOROLLI** dhe **FEJZULLAH QOROLLI**

Më **4 dhjetor 2003**, Ombudspersoni në Kosovë, në pajtim me Nenin 4.4 dhe 4.9 të Rregullorës së UNMIK-ut Nr. 2000/38 mbi Themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë dhe Rregullës 18 dhe 19 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, ka publikuar raportin mbi rastin e lartëpërmendur.

Në këtë rast, Ombudspersoni vërejt qe dështimi i Gjykatës së qarkut në Prishtinë për të vepruar lidhur me ankesën e aplikantit kundër vendimit të Gjykatës komunale në Prishtinë për të refuzuar përsëritjen e procedurës qe kishte përfunduar në gusht të vitit 2001 nuk kishte përbërë shkelje të të drejtës së tyre për një proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm, siç është e garantuar me nenin 6 § 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ombudspersoni vërejt qe neni 6 § 1 Konventës është i aplikueshëm vetëm në procedurat para gjykatave të cilat i referohen përcaktimit të të drejtave ose detyrimeve civile; në vazhdim, Ombudspersoni vërejt qe e drejta mbi pronën, qe ishte fokusi fillimor i rastit, kualifikohet si e drejtë civile në këtë kuptim, por kërkesa e aplikantëve për të përsëritur procedurën nuk kishte të bëjë me të drejtën mbi pronën por me një pyetje procedurale, respektivisht, nëse procedura e mëparme qe ka përfunduar me vendim të formës së prerë, mund të rishqyrtohet. Sipas të drejtës lëndore të organeve të Konventës, neni 6 nuk është i aplikueshëm në procedura të tilla.

Prandaj, Ombudspersoni konkludoi qe nuk kishte pasur shkelje shkelje të së drejtës për proces të rregullt gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm të garantuar me par.1 të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

## **PËRMBLEDHJE**

Nr. i Regjistrimit 696/02

Lidhur me zgjatjen e procedurës në rastin

**ISUF MIROCI**

Më **12 dhjetor 2003**, Ombudspersoni në Kosovë, në pajtim me Nenin 4.4 dhe 4.9 të Rregullorës së UNMIK-ut Nr. 2000/38 mbi Themelimin e Institucionit të Ombudspersonit



në Kosovë dhe Rregullës 18 dhe 19 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, ka publikuar raportin mbi rastin e lartëpërmendur.

Ombudspersoni vërejtë që në procedurën civile për të fituar kompenzimin prej sigurimit pas një aksidenti në trafik, që ishte në pritje për t'u zgjidhur prej vitit 1994 dhe që ishte ndërprerë në vitin 1999, Gjykatës komunale në Deçan iu nevojitën një vit e dy muaj për të vendosur mbi rastin e aplikantit. Ombudspersoni gjeti që arsyetimi i ofruar nga ana e Gjykatës së Qarkut në Pejë, që ekzistonte vetëm një gjykatës i cili punon me rastet civile, ishte i pamjaftueshëm për vonesat dhe që për këtë arsye kjo situatë kishte përbërë shkelje të të drejtës së aplikantit për një proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm të garantuar me nenin 6 të Konventës për të Drejtat e Njeriut. Ombudspersoni gjithashtu vërejtë që mungesa e një mjeti efektiv ligjor kundër shkeljes së të drejtës së aplikantit për një proces të rregullt brenda afati të arsyeshëm kishte përbërë shkelje të të drejtës për ankim efektiv sipas nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Ombudspersoni rekomandoi që Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (PSSP), do të duhej që, jo më vonë se më 12 janar 2004, të emërojë një numër të mjaftueshëm të gjykatësve në gjykatat në Pejë ose të ndërmarrë masa tjera të domosdoshme për të garantuar shqyrtimin e rasteve brenda një afati të arsyeshëm. Ombudspersoni gjithashtu rekomandoi që PSSP do të duhej të të nxjerrë një Rregullore që siguron një mjet efektiv në kuptim të nenit 13 të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut, që siguron lehtësim në formë të parandalimit apo kompensimit lidhur me ankesat për zgjatje të tepruar të procedurës në rastet civile.

**Më 12 shkurt 2004, PSSP u përgjegj që tani ishin 59 gjykatës në gjykatat në rajonin e Pejës, duke përfshirë 8 gjykatës në Gjykatën e qarkut, 28 gjykatës në gjykatat komunale, katër prej të cilëve në Deçan, dhe 23 gjykatës në gjykatat për kundërvajtje. Ky numër përfaqësonte numrin e plotë të kërkuar të gjykatësve. Lidhur me kërkesën e Ombudspersonit që rasti i aplikantit të zgjidhej pa vonesë të mëtejshme, PSSP vërejtë që periudha kohore për rastet civile varej nga veprimet e palëve të përfshira. PSSP shtoi që propozimi i Ombudspersonit që kishte të bëjë me ofrimin e një mjeti efektiv kundër zgjatjes së tepruar të procedurës në çështjet civile ishte duke u marrë parasysh në mënyrë aktive.**

## **PËRMBLEDHJE**

Nr. i Regjistrimit 810/03

Lidhur me hetimet e UNMIK-ut mbi vrasjen dhe plagosjen e familjarëve të aplikantit

## **GANI XHAKA**

**Më 30 janar 2004**, Ombudspersoni në Kosovë, në pajtim me paragrafin 4.4 dhe 4.9 të Rregullorës së UNMIK-ut nr. 2000/38 mbi Themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë dhe Rregullës 18 dhe 19 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, ka nxjerrë raportin në rastin e lartëpërmendur.

Në këtë rast, Ombudspersoni gjeti që hetimet joadekuate mbi vrasjen e bashkëshortes së aplikantit dhe plagosjen e vajzës së tij në shkurt të vitit 2000 kishin përbërë shkelje të së drejtës së aplikantit për jetë të garantuar me nenin 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ombudspersoni së pari vërejtë që neni 2 kërkon zhvillimin e hetimeve efektive mbi rrethanat e një vdekje të dhunshme dhe që këto hetime duhet të shpiejnë deri te identifikimi dhe dënimi i atyre që janë përgjegjës. Në rastin në fjalë, autoritetet treguan përqëndrimin e duhur në veprimet e tyre të para hetuese, por mungesa e ndonjë veprimi të rëndësishëm hetues në muajt që pasuan, edhe nëse merret parasysh ambienti i rrezikshëm për forcat e sigurisë, dështoi të përmbushë kërkesat e Konventës.

Ombudspersoni rekomandoi që PSSP do të duhej që, jo më vonë se më 18 shkurt 2004, të sigurojë që autoritetet përgjegjëse të vazhdojnë në mënyrë aktive hetimet mbi vrasjen e bashkëshortes së aplikantit dhe plagosjen e vajzës së tij, në kuptim të ngritjes së akuzave dhe ndjekjes penale të atyre që janë përgjegjës për këto vepra penale.

**Nuk ka pasur përgjegjje në këtë Raport.**

## **PËRMBLEDHJE**

Nr. i Regjistrimit 999/03

Lidhur me zgjatjen e procedurës në rastin

**SALIF BECIROVSKI**

Më **3 mars 2004**, Ombudspersoni në Kosovë, në pajtim me Nenin 4.4 dhe 4.9 të Rregullorës së UNMIK-ut Nr. 2000/38 mbi Themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë dhe Rregullës 18 dhe 19 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, ka publikuar raportin mbi rastin e lartëpërmendur.

Në këtë rast, Ombudspersoni gjeti që ngecjet e procedurës pranë Gjykatës së qarkut në Prishtinë mes 9 prillit 2003 dhe 6 janarit 2004 kishin përbërë shkelje të së drejtës së aplikantit për një proces të rregullt për një kohë të arsyeshme të garantuar me paragrafin 1 të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Duke analizuar arsyeshmërinë e dy ngecjeve të ndara dhe duke marrë parasysh rrethanat e rastit, që kishte të bëjë me qiranë mujore për lokalet afariste të aplikantit, Ombudspersoni gjeti që ngecja e parë gjatë procesit të ankimit, prej 12 shkurtit 2002 deri më 3 tetor 2002, nuk kishte qenë e tepruar. Megjithatë, mosveprimi i gjykatës gjatë ngecjes së dytë për shkak të stërngarkesës me raste dhe që zgjati prej 9 prillit 2003 deri më 6 janar 2004, nuk ishte në proporcion me obligimin e gjykatës për të ofruar drejtësi brenda një kohe të arsyeshme edhe nëse merren parasysh ndikimet penguese të shkaktuara nga konflikti ose trazirat në Kosovë. Konsiderata ndaj interesit të konsiderueshëm ekonomik të aplikantit e që ishte pjesë e rastit edhe më shumë e perkrahu këtë konkludim.

Ombudspersoni gjithashtu vërejtë që mungesa e ndonjë mjeti juridik kundër shkeljes së të drejtës për një proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm kishte përbërë shkelje të të drejtës për ankim efektiv sipas nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Ombudspersoni rekomandoi që Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (PSSP), do të duhej që, jo më vonë se më 22 mars 2004, të sigurojë që Gjykata komunale, duke marrë parasysh vonesat e mëparshme, të ekzekutojë pa vonesë të metutjeshme aktgjykimin e Gjykatës së qarkut të datës 6 janar 2004. Ombudspersoni më tutje rekomandoi që PSSP do të duhej të emërojë një numër të mjaftueshëm të gjykatësve në Gjykatën e qarkut në Prishtinë ose të ndërmarrë masa tjera të domosdoshme për të garantuar shqyrtimin e rasteve dhe dorëzimin e aktgjykimeve brenda një afati të arsyeshëm. Në fund, Ombudspersoni rekomandoi që PSSP të lëshojë një Rregullore që siguron një mjet efektiv në kuptim të nenit 13 të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut, që siguron lehtësim në formë të parandalimit apo kompensimit lidhur me ankesat për zgjatje të tepruar të procedurës në rastet civile.

**Përmes letrës së 14 qershorit 2004, ushtruesi i detyrës së PSSP-së e informoi Ombudspersonin që aktykimi në fjalë ishte përmbaaruar si duhet. Gjithashtu, nga pesëmbëdhjetë pozita gjyqësore që i ishin ndarë Gjykatës së qarkut në Prishtinë, katërmëdhjetë tashmë ishin plotësuar. Në mes të majit të vitit 2004, një gjykatës shtesë ishte transferuar në Gjykatën e qarkut në Prishtinë nga Gjykata komunale në Podujevë, për të ndihmuar rreth ngarkesës së madhe me raste që ishin në pritje për t'u zgjidhur. Ushtruesi i detyrës së PSSP-së shtoi që Këshilli Gjyqësor dhe i Prokurorisë i Kosovës, si autoritet që këshillon PSSP-në lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me emërimin e gjykatësve, prokurorëve dhe gjykatësve porotë, do të shqyrtonte numrin momental të pozitave gjyqësore dhe të prokurorisë të parashikuara me buxhet sipas rezultateve që priteshin të dalin nga një studim i përgjithshëm që ishte bërë për të vlerësuar gjendjen rreth punonjësve në gjykatat dhe prokuroritë në Kosovë. Ky raport me siguri do të rezultonte me rekomandimet lidhur me numrin e posteve të gjykatësve të parashikuara me buxhet. Në fund, ushtruesi i detyrës së PSSP-së theksoi që Zyrja e Këshilltarit Ligjor të UNMIK-ut dhe Departamenti i Drejtësisë pranë UNMIK-ut ishin duke e shqyrtuar në mënyrë aktive rekomandimin e Ombudspersonit për të përpiluar një rregullore që ofron mjet efektiv për zgjatje të tepruar të procedurës.**

## **PËRMBLEDHJE**

Nr. i Regjistrimit 320/01

Lidhur me mospëmbaarimin e aktgjykimit në rastin

**KADRI AHMETAJ**

Më **31 mars 2004**, Ombudspersoni në Kosovë, në pajtim me paragrafin 4.4 dhe 4.9 të Rregullorës së UNMIK-ut nr. 2000/38 mbi Themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë dhe Rregullës 18 dhe 19 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, ka nxjerrë raportin në rastin e lartëpërmendur.

Në këtë rast, Ombudspersoni konkludoi që dështimi i gjyqtarit përgjegjës përmbaarues dhe i të gjitha organeve tjera mbikqyrëse për të siguruar përmbaarimin e aktgjykimit të Gjykatës komunale në Suharekë të datës 11 prill 2000 ia kishte mohuar aplikantit në mënyrë efektive të drejtën e tij për gjykatë sipas nenit 6 të Konventës Evropiane të për Drejtat e Njeriut.

Duke vërejtur që qasja në një gjykatë efektive ishte pjesë përbërëse e garancioneve të nenit 6 të Konventës, Ombudspersoni gjeti që shumë palë kishin qenë fajtores për mospërmbarimin e aktgjykimit, me të cilin Gjykata komunale në Suharekë i kishte urdhëruar të pandehurit të përmbahen nga veprimet që e pengonin aplikantit ta shfrytëzojë pronën e tij. Dështimi i gjyqtarit përmbarues për të vepruar pas refuzimit të kërkesës së tij për të qenë i liruar nga ky rast, dështimi i kryetarit të Gjykatës komunale në Suharekë për të reaguar në pajtim me këtë, dhe dështimi i kryetarit të Gjykatës së qarkut në Prizren për të vepruar në pajtim me kërkesat e aplikantit, që të gjitha nuk ishin në pajtim me obligimet e këtyre organeve sipas nenit 6 të Konventës. Për më tepër, UNMIK gjithashtu dështoi të përmbushë obligimet e tij, pasi që as Njësia për Inspeksion Gjyqësor (NjIGJ), as Këshilli Gjyqësor dhe i Prokurorisë i Kosovës (“Këshilli”) nuk i kishin ofruar ndihmë efektive aplikantit.

Ombudspersoni rekomandoi që PSSP do të duhej që, jo më vonë se më 23 prill 2004, ta udhëzojë kryetarin e Gjykatës komunale në Suharekë të garantojë përmbarimin e aktgjykimit të prerë të datës 11 prill 2000 pa vonesë të mëtejshme. Për më tepër, PSSP do të duhej të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që NjIGJ dhe Këshilli të zhvillojnë hetimet kundër gjykatësve kompetentë që do të përfundohen me raport.

**Përmes letrës së 29 prillit 2004, ZPSSP për Polici dhe Drejtësi u përgjegj në këtë raport duke e informuar Ombudspersonin që gjykatësi në fjalë, që kishte qenë përgjegjës për zvarritjen e paarsyeshme në rastin në fjalë, kishte qenë fajtor për sjellje të pahijshme. Megjithatë, para se Departamenti i Drejtësisë të mund të fillonte procedurën disiplinore kundër tij në bazë të raportit të NjIGJ-së, ky gjykatës kishte dhënë dorëheqje nga posti i tij. Pasi që NjIGJ nuk kishte konstatuar sjellje të pahijshme nga ana e kryetarit të Gjykatës komunale në Suharekë në lidhje me rastin e aplikantit, rasti ishte mbyllur.**

Sa i përket rekomandimeve të Ombudspersonit që kryetari i Gjykatës komunale në Suharekë do të duhej të udhëzohet që ta përmbarojë aktgjykimin në fjalë pa vonesë të mëtejshme, ZPSSP e informoi Ombudspersonin që NjIGJ kishte gjetur që, më 13 tetor 2003, kjo gjykatë kishte marrë vendimin për të ndëprerë procedurën e mëtejshme mbi këtë rast. Për më tepër, në procedurën kontestimore mbi pronën që e kishte filluar aplikanti më 25 qershor 2002 lidhur me të njejtën temë të lëndës dhe pranë të njejtës gjykatë, ishte nxjerrë një aktgjykimi i shkallës së parë më 5 shtator 2003. Aplikanti kishte pasur rastin të kundërshtojë këto dy aktvendime pranë gjykatës kompetente të qarkut.

## **PËRMBLEDHJE**

Nr. i Regjistrimit 485/01

Lidhur me mospërmbarimin e aktgjykimit në rastin

**ISAK AHMETI**

Më 2 prill 2004, Ombudspersoni në Kosovë, në pajtim me paragrafin 4.4 dhe 4.9 të Rregullorës së UNMIK-ut nr. 2000/38 mbi Themelimin e Institucionit të Ombudspersonit

në Kosovë dhe Rregullës 18 dhe 19 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, ka nxjerrë raportin në rastin e lartëpërmendur.

Në këtë rast, Ombudspersoni gjeti që dështimi i Gjykatës komunale në Ferizaj për ta përmbuar aktgjykimin e 27 nëntorit 1992, bashkë me dështimin e organeve mbikqyrëse dhe të UNMIK-ut për të siguruar që ky aktgjykim të përmbarohet, kishin përbërë shkelje të drejtës së aplikantit për gjykatë të garantuar me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Aktgjykimi në fjalë kishte urdhëruar punëdhënësin e aplikantit që ta kompenzojë atë përmes rentës mujore për lëndimet që ai i kishte pësuar në vendin e tij të punës. Ombudspersoni gjeti që kërkesat për një proces të rregullt dhe publik sipas nenit 6 të Konventës gjithsesi nënkuptonin edhe kërkesën e ngajshme për të mbrojtur zbatimin e vendimeve gjyqësore. Si përgjegje në arsyetimin e dhëna nga ana e gjyqtarit përmbarues, Ombudspersoni gjeti që as ushtrimi i të drejtave procedurale të aplikantit, as vështirësitë praktike që kishin të bëjnë me mungesën e mjeteve financiare nuk kishin qenë të mjaftueshme për të arsyetuar mosveprimin e gjykatës ndaj mospajtit të punëdhënësit. Në këtë situatë, aplikantit i ishte mohuar e drejta e tij për gjykatë sipas nenit 6 të Konventës.

Ombudspersoni rekomandoi që PSSP do të duhej që, jo më vonë se më 23 prill 2004, të ndërmarrë hapa urgjentë për të siguruar që aktgjykimi të përmbarohet pa vonesë të mëtejshme. Për më tepër, PSSP do të duhej të të marrë në konsiderim zgjerimin e kompetencave të Këshillit Gjyqësor dhe të Prokurorisë së Kosovës në atë mënyrë që ato të përfshijnë edhe të drejtën për ta urdhëruar ndonjë gjykatës të caktuar nën hetime që të kryejë detyrat e tij në mënyrë të shpejtë dhe që, në rastet e mospërfilljes së funksioneve gjyqësore nga ana e ndonjë gjyqtari, PSSP do të duhej të sigurojë që Departamenti i Drejtësisë të udhëzojë kryetarin e gjykatës përkatëse të ndërmarrë veprimet e nevojshme në mënyrë që mospërfillja e një gjykatësi të mos shkaktojë zvarritje të tepruara në procedurë të gjykatës.

**Përmes letrës së 29 prillit 2004, ZPSSP për Polici dhe Drejtësi u përgjegj në këtë raport duke e informuar Ombudspersonin që ai do të këshillonte kryetarin e gjykatës përkatëse dhe gjyqtarin përmbarues përkatës t'i dhënë prioritet përmbarimit të aktgjykimin të aplikantit dhe ta informojnë ZPSSP-në lidhur me veprimet që janë ndërmarrë në këtë drejtim.**

**Rekomandimet e Ombudspersonit lidhur me zgjerimin e kompetencave të Këshillit Gjyqësor dhe të Prokurorisë së Kosovës do të merreshin në konsiderim të nevojshëm nga ana e Departamentit të Drejtësisë. Në fund, në raste kur Këshilli Gjyqësor dhe i Prokurorisë i Kosovës do të konstatonte mospërfillje të funksioneve gjyqësore një gjyqtari, Departamenti i Drejtësisë do të këshillonte gjykatën përkatëse që rastet e ndikuara nga ajo sjellje e pahijshme të procesohen në mënyrën më të mirë të mundshme.**

## **PËRMBLEDHJE**

Nr. i Regjistrimit *ex officio* 23/02

Lidhur me të drejtën për jetë të A.Q.

Më **29 prill 2004**, Ombudspersoni në Kosovë, në pajtim me Nenin 4.4 dhe 4.9 të Rregullorës së UNMIK-ut Nr. 2000/38 mbi Themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë

dhe Rregullës 18 dhe 19 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, ka publikuar raportin mbi rastin e lartëpërmendur.

Në këtë rast, gjatë analizimit sa kishin qenë adekuate hetimet penale mbi zhdukjen e aplikantit, Ombudspersoni konkludoi që hapat e ndërmarrë nga ana e autoriteteve të zbatimit të ligjit nuk i kishin përmbushur obligimet për të mbrojtur të drejtën për jetë të vendosura mbi to në pajtim me nenin 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Zvarritje të ndryshme në procesin hetues, të mveshura njësisë të ndryshme të policisë së UNMIK-ut, xhandarmërisë franceze dhe autoriteteve tjera kompetente, kishin pasqyruar mungesë të përqëndrimit të duhur të kërkuar nga ana e Konventës në lidhje me hetimet e krimeve serioze. Duke vërejtur që efikasiteti i kërkuar nga hetimet nuk ka të bëjë me obligimin për të arritur rezultat por më shumë për t'u zhvilluar ato, Ombudspersoni gjeti që zhvillimi i hetimeve në rastin në fjalë nuk kishte qenë i mjaftueshëm për të mbrojtur të drejtën për jetë të A.Q.

Ombudspersoni rekomandoi që PSSP do të duhej që, jo më vonë se më 19 maj 2004, të sigurojë që autoritetet kompetente të vazhdojnë hetimet e tyre mbi rrethanat e zhdukjes së A.Q. në kuptim të ngritjes së aktakuzës dhe ndjekjes penale të personave përgjegjës, si dhe që hetimet penale të zhvillohen në pajtim me ligjin në fuqi.

**Përmes letrës së 3 qershorit 2004, ZPSSP për Polici dhe Drejtësi u përgjegj në raportin mbi rastin duke e informuar Ombudspersonin që policia e UNMIK-ut kishte vazhduar të hetojë rrethanat e rastit dhe kishte mbetur e vendosur që të zgjidhë fatin e A.Q. Si rezultat i kësaj, ishte gjetur automjeti i viktimës dhe ishin identifikuar dhe intervistuar dëshmitarët përkatës. Për më tepër, hetimet e policisë kishin konfirmuar që vdekja e A.Q. kishte qenë vrasje. Një i dyshuar ishte identifikuar. Së shpejti, rasti do të paraqitej nga ana e prokurorit, në kuptim të arrestimit të të dyshuarit dhe nxjerrjes së vendimit zyrtar për të zhvilluar hetimet në pajtim me Kodin e Përkohshëm mbi Procedurën Penale të Kosovës.**

## **PËRMBLEDHJE**

### Raporti Special Nr. 7

Mbi pajtueshmërinë e dispozitave të caktuara të Ligjit të RSFJ-së mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (1977) me standardet e njohura ndërkombëtare

Më **5 maj 2004**, Ombudspersoni në Kosovë, në pajtim me Nenin 4.3 dhe 4.9 të Rregullorës së UNMIK-ut Nr. 2000/38 mbi Themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë dhe Rregullës 22 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, ka publikuar raportin mbi rastin e lartëpërmendur.

Në këtë raport, Ombudspersoni analizoi nëse dispozita të caktuar të Ligjit të RSFJ-së mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale lidhur me të drejtën e respektimit të letërkëmbimit të personave të dënuar ishin në pajtim me standardet e njohura ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Neni 107 i këtij ligji e kufizonte të drejtën e letërkëmbimit të personit të dënuar në anëtarë të familjes së ngushtë, kurse për letërkëmbimin tjetër nevojitej leja e autoriteteve të

burgut. OMB gjeti që kjo dispozitë ishte në kundërshtim të drejtëpërdrejtë me nenin 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, i cili garanton respektimin e jetës private dhe letërkëmbimit dhe mbron çdo person nga ndërhyrjet e autoriteteve publike, tjera nga ato që janë të parashikuara me ligj dhe të nevojshme në një shoqëri demokratike. Në fakt, neni 107 mundësonte ndërhyrje të qartë të autoriteteve publike në të drejtën e personave të dënuar për letërkëmbim dhe nuk ishte në pajtim me standardet e vendosura me nenin 8 pasi që ua lejonte autoriteteve të burgut një diskrecion të pakufizuar për ta censuruar postën e dërguar dhe të pranuar.

Ombudspersoni rekomandoi që PSSP, jo më vonë se më 26 maj 2004, të sigurojë që Ligji mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale të ndryshohet në pajtim me gjetjet e tij në këtë raport dhe që ligji i ndryshuar të shpërndahet në tërë Kosovën nëpërmjet të gjitha kanaleve të duhura.

**Përmes letrës së datës 25 qershor 2004, ZPSSP për Polici dhe Drejtësi u përgjegj në raportin e mësipërm. Ai vërejti që, sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/24 të 12 dhjetorit 1999, personeli i Divizionit të Menaxhmentit Penal/Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe Departamentit të Drejtësisë pranë UNMIK-ut janë të obliguar t'i respektojnë standardet e njohura ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe ata në praktikë nuk e kufizojnë të drejtën e personave të dënuar për letërkëmbim. Letërkëmbimi i personave të tillë nuk hapet përveç nëse ka arsye për të besuar që ajo përmban ndonjë objekt të paautorizuar ose nëse ka informata që i dënuari në fjalë planifikon të angazhohet në veprime ilegale. Letërkëmbimi i një personi të dënuar që paraqet rrezik për sigurinë është i mbikqyrur me kujdes, mirëpo nuk është as i kufizuar, as i censuruar.**

**Nëse Ombudspersoni do të ishte në posedim të ndonjë dëshmie që e drejta e një personi të dënuar për letërkëmbim është shkelur, Departamenti i Drejtësisë pranë UNMIK-ut do të bënte çdo gjë që do të ishte e mundur për ta hetuar këtë rast.**

**Në fund, ZPSSP e informoi Ombudspersonin që, sipas udhëzimeve të Zyrës së Këshilltarit Ligjor të UNMIK-ut dhe në konsultim me bashkësinë vendore ligjore dhe anëtarët e bashkësisë ndërkombëtare ligjore, Ligji mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale ishte duke u reviduar në mënyrë që të jetë në pajtim me standardet ndërkombëtare. ZPSSP parashikoi që ky tekst do të shpallej në të ardhmën e afërt. Dispozitat që kishin të bëjnë me letërkëmbimin e personave të dënuar ishin ndryshuar në masë të madhe dhe tani ishin plotësisht në pajtim me standardet e njohura ndërkombëtare.**

## **PËRMBLEDHJE**

Nr. i Regjistrimit 810/03

Lidhur dështimin për ta ekzekutuar vendimin e DÇPB-së në rastin

**STAMENKO KOVAČEVIĆ**

Më **5 maj 2004**, Ombudspersoni në Kosovë, në pajtim me paragrafin 4.4 dhe 4.9 të Rregullorës së UNMIK-ut nr. 2000/38 mbi Themelimin e Institucionit të Ombudspersonit

në Kosovë dhe Rregullës 18 dhe 19 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, ka nxjerrë raportin në rastin e lartëpërmendur.

Në këtë rast, Ombudspersoni gjeti që dështimi i autoriteteve kompetente për ta ekzekutuar në mënyrë efektive vendimin e DÇPB-së të datës 26 tetor 2001, me të cilin aplikantit i lejohej ta kthejë në posedim pronën e tij, kishte përbërë shkelje të së drejtës së aplikantit për respektimin e vendbanimit të tij sipas nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Përkundër shumë përpjekjeve për ta zbatuar këtë vendim, banorët në shtëpinë e aplikantit vazhdimisht kanë mospërfillur urdhërat dhe janë kthyer në shtëpi edhe pas dëbimit me forcë nga e njëjta, duke shkuar aq larg sa edhe ta kërcënojnë aplikantin me shkatërrim të shtëpisë poqëse ai do të kërkonte përsëri ekzekutimin e vendimit. Ombudspersoni konkludoi që, derisa qëllimi kryesor i nenit 8 është që ta mbrojë individin nga ndërhyrjet arbitrare nga ana e autoriteteve, në rastet e tilla obligimi mund të zgjatet më tej se ky zotim negativ e deri te obligimet pozitive të përmbajtura në një respektim efektiv të të drejtave të aplikantit. Duke i balancuar interesin publik dhe atë privat në fjalë, Ombudspersoni gjeti që obligimet e tilla ishin prezente në rastin në fjalë. Për më tepër, ai konkludoi që Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2000/60 mbi kërkesat pronësore dhe banesore nuk kishte qenë e përpiluar në atë mënyrë që të lejojë veprimet përkundër papajtueshmërisë së banorëve të palgshëm. Ombudspersoni nuk e gjeti të nevojshme të analizojë nëse kishte pasur shkelje të nenit 1 të Protokolit Nr. 1, pasi që kërkesat e këtij neni ishin të përfshira nën ato të nenit 8 të Konventës.

**Nuk ka pasur përgjegjje në këtë Raport.**

## **PËRMBLEDHJE**

Nr. i Regjistrimit 1041/03 dhe 1042/03

Lidhur me zgjatjen e procedurës në rastet

MUHARREM DEMIRI dhe EDIM ADEMI

Më **7 maj 2004**, Ombudspersoni në Kosovë, në pajtim me paragrafin 4.4 dhe 4.9 të Rregullorës së UNMIK-ut nr. 2000/38 mbi Themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë dhe Rregullës 18 dhe 19 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, ka nxjerrë raportin në rastin e lartëpërmendur.

Në këto raste, që kishin modele identike të fakteve dhe konkludimeve, Ombudspersoni gjeti që dështimi i Gjykatës komunale në Mitrovicë dhe organeve kompetente të UNMIK-ut për të ndërmarrë veprimet e nevojshme për të siguruar zgjidhjen e rasteve të aplikantëve brenda një afati të arsyeshëm kishte përbërë shkelje të së drejtës së aplikantëve për një proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm, të garantuar me par. 1 të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në këto raste, në të cilat aplikantët kishin kërkuar të ktheheshin në vendet e tyre të mëparshme të punës nga të cilat i kishin larguar më 1991, Ombudspersoni gjeti që shkelja nuk kishte rezultuar nga ndonjë mosveprim i gjykatës; në fakt, katër vendime gjyqësore ishin nxjerrë gjatë periudhës së procedurave. Më parë se kjo, zvarritjet ishin shkaktuar nga rishqyrtimi i përsëritur i rastit, që reflektonte një defekt serioz në strukturën funksionuese hierarkike të sistemit gjyqësor vendor. Për më tepër, UNMIK-u



nuk e përmbushi përgjegjësinë e tij për të siguruar që procedura të përfundojë në mënyrë të shpejtë.

Ombudspersoni gjithashtu vërejtë që mungesa e ndonjë mjeti juridik kundër shkeljes së të drejtës për një proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm kishte përbërë shkelje të të drejtës për ankim efektiv sipas nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Ombudspersoni rekomandoi që PSSP do të duhej që, pa vonesë të mëtejshme dhe jo më vonë se më 28 maj 2004, të sigurojë që Gjykata komunale në Mitrovicë të nxjerrë aktgjykimet në rastet e aplikantëve. Për më tepër, PSSP do të duhej të emërojë një numër të mjaftueshëm të gjykatësve në gjykatë ose të ndërmarrë veprime tjera të nevojshme për të garantuar shqyrtimin e rasteve dhe dorëzimin e aktgjykimeve brenda një afati të arsyeshëm. Ombudspersoni gjithashtu rekomandoi që PSSP të lëshojë një Rregullore që siguron një mjet efektiv në kuptim të nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që siguron lehtësim në formë të parandalimit apo kompensimit lidhur me ankesat për zgjatje të tepruar të procedurës në rastet civile.

**Përmes letrës së 14 qershorit 2004, PSSP u përgjegj në raport duke e informuar Ombudspersoni që, derisa numri i parashikuar me buxhet i gjykatësve në Gjykatën komunale në Mitrovicë ishte nëntë, vetëm shtatë gjykatës ishin duke punuar në këtë gjykatë në atë kohë. Këshilli Gjyqësor dhe i Prokurorisë i Kosovës do të shqyrtonte numrin momental të pozitive gjyqësore dhe të prokurorisë të parashikuara me buxhet sipas rezultateve që priteshin të dalin nga një studim i përgjithshëm që, mes tjerash, do të vlerësonte gjendjen rreth punonjësve në gjykatat dhe prokuroritë në Kosovë. Ky studim pritej të rezultojë me rekomandimet që do të kishin ndikim në numrin e pozitive për gjykatës të parashikuara me buxhet. Megjithatë, nëse në rastet e aplikantëve do të paraqiteshin zvarritje tjera të paarsyeshme, Ombudspersoni do të duhej t'i këshillojë aplikantët që këtë sjellje të pahijshme të ia raportojnë Departamentit të Drejtësisë pranë UNMIK-ut.**

**Zyrja e Këshilltarit Ligjor të UNMIK-ut dhe Departamenti i Drejtësisë pranë UNMIK-ut ishin duke e shqyrtuar në mënyrë aktive rekomandimin e Ombudspersonit për të përpiluar një rregullore që ofron mjet efektiv për zgjatje të tepruar të procedurës.**

## **PËRMBLEDHJE**

Nr. i Regjistrimit 728/02

Lidhur me zgjatjen e procedurës në rastin

**MUHARREM PAQARADA**

Më **7 maj 2004**, Ombudspersoni në Kosovë, në pajtim me paragrafin 4.4 dhe 4.9 të Rregullorës së UNMIK-ut nr. 2000/38 mbi Themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë dhe Rregullës 18 dhe 19 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, ka nxjerrë raportin në rastin e lartpërmendur.

Në këtë rast, më 5 maj 2001, aplikanti ngriti një padi civile pranë Gjykatës komunale në Prishtinë, duke kërkuar zgjatjen e kontratës së tij të punës pranë Shërbimit Doganor të UNMIK-ut. Ombudspersoni vërejti që arsyeshmëria e zgjatjes së procedurës, që në rastin në fjalë ishte ende në zhvillim e sipër edhe më datën kur ishte nxjerrë ky raport mbi rastin, duhet të vlerësohet duke marrë parasysh rrethanat e veçanta të rastit, me përqëndrim të posaçëm në komplikueshmërinë e rastit dhe sjelljen dhe interesat e palëve të përfshira. Duke e konsideruar rastin si jo të komplikuar dhe me rëndësi të madhe për aplikantin, i cili kishte qenë i papunë për më shumë se tri vite në kohën e këtij raporti, Ombudspersoni konkludoi që zvarritjet nuk mund të arsyetoheshin me mungesë të punonjësve në gjyqësi. Si të tilla, këto zvarritje kishin përbërë shkelje të së drejtës së aplikantit për një proves të rregullt brenda një afati të arsyeshëm, të garantuar me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Ombudspersoni gjithashtu vërejti që Ombudspersoni gjithashtu vërejti që mungesa e ndonjë mjeti juridik kundër shkeljes së të drejtës për një proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm kishte përbërë shkelje të të drejtës për ankim efektiv sipas nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Ombudspersoni rekomandoi që Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (PSSP), do të duhej që, pa vonesë të mëtejshme dhe jo më vonë se më 28 maj 2004, të sigurojë që Gjykata e qarkut në Prishtinë të vazhdojë procedurën në rastin e aplikantit, të të emërojë një numër të mjaftueshëm të gjykatësve në Gjykatën e qarkut në Prishtinë ose të ndërmarrë masa tjera të domosdoshme për të garantuar shqyrtimin e rasteve dhe dorëzimin e aktgjykimeve brenda një afati të arsyeshëm. Ombudspersoni gjithashtu rekomandoi që PSSP të lëshojë një Rregullore që siguron një mjet efektiv në kuptim të nenit 13 të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut, që siguron lehtësim në formë të parandalimit apo kompensimit lidhur me ankesat për zgjatje të tepruar të procedurës në rastet civile.

**Përmes letrës së 14 qershorit 2004, ushtruesi i detyrës së PSSP-së e informoi Ombudspersonin që, nga pesëmbëdhjetë pozita gjyqësore që i ishin ndarë Gjykatës së qarkut në Prishtinë, katërmëdhjetë tashmë ishin plotësuar. Në mes të majit të vitit 2004, një gjykatës shtesë ishte transferuar në Gjykatën e qarkut në Prishtinë nga Gjykata komunale në Podujevë, për të ndihmuar rreth ngarkesës së madhe me raste që ishin në pritje për t'u zgjidhur. Ushtruesi i detyrës së PSSP-së shtoi që Këshilli Gjyqësor dhe i Prokurorisë i Kosovës, si autoritet që këshillon PSSP-në lidhur më çështjet që kanë të bëjnë me emërimin e gjykatësve, prokurorëve dhe gjykatësve porotë, do të shqyrtonte numrin momental të pozitave gjyqësore dhe të prokurorisë të parashikuara me buxhet sipas rezultateve që priteshin të dalin nga një studim i përgjithshëm që ishte bërë për të vlerësuar gjendjen rreth punonjësve në gjykatat dhe prokuroritë në Kosovë. Ky raport me siguri do të rezultonte me rekomandimet lidhur me numrin e posteve të gjykatësve të parashikuara me buxhet. Në fund, ushtruesi i detyrës së PSSP-së theksoi që Zyrja e Këshilltarit Ligjor të UNMIK-ut dhe Departamenti i Drejtësisë pranë UNMIK-ut ishin duke e shqyrtuar në mënyrë aktive rekomandimin e Ombudspersonit për të përpiluar një rregullore që ofron mjet efektiv për zgjatje të tepruar të procedurës.**

## PËRMBLEDHJE

### Raporti Special Nr. 8

Mbi ligjshmërinë e veprimeve të autoriteteve publike që kanë për qëllim ndalimin e mbajtjes së simboleve fetare nga ana e nxënësve në shkollat publike në tërë Kosovën

Më **4 qershor 2004**, Ombudspersoni në Kosovë, në pajtim me autoritetin e dhënë atij sipas nenit 1.1 dhe 4.1 të Rregullorës së UNMIK-ut nr.2000/38 mbi Themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë dhe paragrafeve 3 dhe 4 të Rregullës 22 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit, Ombudspersoni ka publikuar Raportin e lartëpërmendur Special.

Në këtë raport, Ombudspersoni ka gjetur se çdo veprim i ndërmarrë nga ana e autoriteteve publike që kishte për qëllim ndalimin e mbajtjes së simboleve fetare nga ana e nxënësve në institucionet publike arsimore nëpër Kosovë nuk do të kishte qenë i ligjshëm në kuptim të nenit 9 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, i cili, mes tjerash, garanton lirinë e fesë. Ministri i Arsimit, në letrën e tij drejtuar Institucionit të Ombudspersonit më 4 prill 2004, ka cekur që bazë ligjore për veprime të tilla ishte neni 4.7 i Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë. Në këtë dispozitë thuhet që "Institucionet publike arsimore do të përmbahen nga mësimdhënia fetare ose veprimtaritë tjera, të cilat propagojnë ndonjë fe të caktuar". Ombudspersoni ka theksuar që ndalimi i përshkruar në dispozitën e mësipërme u dedikohet shprehimisht dhe veçanërisht institucioneve publike arsimore dhe anëtarëve të stafit e tyre e jo nxënësve. Për këtë arsye, dispozita e mësipërme ligjore nuk shërben si bazë ligjore për çfarëdo veprime të autoriteteve publike që kanë për qëllim ndërhyrjen në lirinë e nxënësve për të shprehur besimin e tyre fetar nëpër shkolla.

Ombudspersoni rekomandoi që, në mungesë të ndonjë dispozite adekuate ligjore, autoritetet publike do të duhej të përmbahen nga çfarëdo veprimi që do të mund të përbëjë ndërhyrje në lirinë e nxënësve për të shprehur fenë e tyre nëpër shkolla përmes mbajtjes së simboleve fetare. Ai më tutje rekomandoi që PSSP do të duhej që, pas pranimit të këtij Raporti, ta shpërndajë atë përmes të gjitha kanaleve përkatëse në të gjitha institucionet arsimore në Kosovë.

**Nuk ka pasur përgjegje në këtë Raport.**

## PËRMBLEDHJE

Nr. i Regjistrimit 1163/03

Lidhur me refuzimin nga ana e Policisë së UNMIK-ut në kërkesën për të organizuar një protestë paqësore në rastin

### LËVIZJA POPULLORE E KOSOVËS

Më **28 qershor 2004**, Ombudspersoni në Kosovë, në pajtim me Nenin 4.4 dhe 4.9 të Rregullorës së UNMIK-ut Nr. 2000/38 mbi Themelimin e Institucionit të Ombudspersonit

në Kosovë dhe Rregullës 18 dhe 19 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, ka publikuar raportin mbi rastin e lartëpërmendur.

Në këtë raport, duke analizuar bazat ligjore të ofruara nga ana e UNMIK-ut për të mos e lejuar aplikantin të organizojë një protestë paqësore para Kuvendit të Kosovës, Ombudspersoni konkludoi që Ligji mbi Rendin dhe Qetësinë Publike, në të cilin ishte thirrur Policia e UNMIK-ut dhe i cili rregullon në mënyrë të përgjithshme sjelljen e qytetarëve në publik, nuk mbulonte në mënyrë specifike kërkesat për ta marrë lejen për të organizuar një tubim publik. Prandaj, ky ligj nuk mund të përbënte bazën për një vendim që e kufizon të drejtën e tubimit sipas nenit 11 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në vend të tij, ligji i aplikueshëm në situata të tilla ishte Ligji mbi Tubimet Publike. Megjithatë, edhe nëse supozohet që Policia e UNMIK-ut do të ishte thirrur në këtë ligj me rastin e refuzimit të kërkesës së aplikantit, Ombudspersoni vërejtë që ky ligj nuk definonte parimet që qeverisin ushtrimin e kontrollit efektiv mbi tubimet publike. Për më tepër, asnjë dispozitë e këtij ligji apo çfarëdo ligji tjetër të aplikueshëm nuk ofronte ndonjë mjet ligjor që do të ia mundësonte një personi të kontestojë mënyrën ose përmasat e një mase që kufizon të drejtën e lirisë së tubimit. Ligji mbi Tubimet Publike, edhe po të thirrej për të shërbyer si bazë ligjore, nuk përmbush kërkesat e nenit 11 të Konventës dhe si i tillë është në kundërshtim me këtë nen.

Ombudspersoni rekomandoi që PSSP do të duhej që, jo më vonë se më 15 shtator 2004, të garantojë miratimin dhe shpalljen e një ligji të ri mbi të drejtën për tubim publik dhe paqësor, i cili do të ishte në pajtim me standardet e nenit 11 të Konventës, në veçanti me ato apekte të nenit 11 që ishin me rëndësi për Raportin në këtë rast.

## PËRMBLEDHJE

Nr. i Regjistrimit 1046/03

Lidhur me zgjatjen e procedurës pranë Komisionit të Ankesave pranë DÇPB-së në rastin

MILENA RISTIĆ DHE TË TJERËT

Më **29 qershor 2004**, Ombudspersoni në Kosovë, në pajtim me Nenin 4.4 dhe 4.9 të Rregullorës së UNMIK-ut Nr. 2000/38 mbi Themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë dhe Rregullës 18 dhe 19 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, ka publikuar raportin e lartëpërmendur.

Në këtë rast, Ombudspersoni gjeti që dështimi i Komisionit të Ankesave pranë DÇPB-së për të vendosur në rastet e aplikantëve brenda një afati të arsyeshëm kishte përbërë shkelje të të drejtave të aplikantëve për respektimin e vendbanimit sipas nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Derisa qëllimi kryesor i nenit 8 është që ta mbrojë individin nga ndërhyrjet arbitrare nga ana e autoriteteve, Ombudspersoni erdhi në konkludim që, në rastin në fjalë, autoritetet publike gjithashtu kishin edhe obligimin pozitiv që të mbrojnë të drejtën e aplikantëve për vendbanimin e tyre. Duke vërejtur që DÇPB ishte e vetmja mundësi përmes së cilës aplikantët mund të përpiqeshin të kthejnë në posedim vendbanimet e tyre, Ombudspersoni konkludoi që hapat e ndërmarrë nga ana DÇPB-së për të zgjidhur rastet e aplikantëve nuk kishin qenë të shpejtë sa duhet për të përmbushur

kërkesat e nenit 8 të Konventës. Problemi i mungesës së fondeve dhe si pasojë e kësaj numri i vogël i punonjësve të stërngarkuar me raste të pazgjidhura do të mund të shërbente si arsye për ngecje të tilla të procedurës vetëm nëse një stërngarkesë e tillë ishte e papritur dhe e përkohshme. Megjithatë, në rastin në fjalë, autoritetet kompetente të UNMIK-ut kishin qenë të vetëdijshme për një kohë të gjatë lidhur me këtë stërngarkesë me raste pranë Komisionit të Ankesave pranë DÇPB-së, por nuk kishin bërë aq sa duhet për të riorganizuar DÇPB-në dhe për të përmirësuar veprimet e këtij institucioni në atë mënyrë që do të mundësonte DÇPB-në të merret me ngarkesën e madhe me raste në një mënyrë më të shpejtë. Ombudspersoni nuk e gjeti të nevojshme të analizojë nëse kishte pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit Nr. 1, pasi që kërkesat e këtij neni ishin të përfshira nën ato të nenit 8 të Konventës.

Ombudspersoni rekomandoi që PSSP do të duhej që, jo më vonë se më 15 shtator 2004, përmes masave përkatëse ligjore dhe praktikave administrative, të sigurojë që të drejtat për vendbanim dhe pronë të aplikantëve, si dhe të gjithë personave tjerë në të njejtën situatë, të zbatohen në një mënyrë të shpejtë në pajtim me standardet për të drejtat e njeriut të vendosura me nenin 8 të Konventës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1.

## **PËRMBLEDHJE**

### **Raporti Special Nr. 9**

Mbi pajtueshmërinë e aspekteve të caktuara të paraburgimit të kryerësve të veprave penale në gjendje të papërgjegjshmërisë ose papërgjegjshmërisë së pakësuar esencialisht me standardet e pranuar ndërkombëtare

**Më 29 qershor 2004**, Ombudspersoni në Kosovë, në pajtim me Nenin 4.3 dhe 4.9 të Rregullorës së UNMIK-ut Nr. 2000/38 mbi Themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë dhe par. 3 dhe 4 të Rregullës 22 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, ka publikuar raportin e lartpërmendur.

Në këtë raport, Ombudspersoni së pari analizoi nëse sipas ligjit të aplikueshëm deri më 6 prill 2004, praktika e vendosjes së kryerësve të veprave penale në gjendje të papërgjegjshmërisë ose papërgjegjshmërisë së pakësuar esencialisht në burgje të rregullta para pranimit të tyre në Klinikën e Neuropsikijatrisë në Prishtinë kishte shkelur të drejtën e këtyre personave për liri sipas par. 1 të nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Duke vërejtur që ligjet e atëhershme të aplikueshme të RSFJ-së nuk kishin lënë shumë vend për një praktikë të tillë, Ombudspersoni prapë se prapë vërejt që do të ishte joreale dhe tejet jofleksibile të pritej nga autoritetet kompetente që në çdo kohë të sigurojnë vende të lira në institucione të tilla shëndetësore. Megjithatë, duke marrë parasysh që vendosja e tillë në burgje të rëndomta kishte zgjatur për një periudhë të konsiderueshme kohore, duke arritur edhe në gati dhjetë muaj dhe me këtë rast duke rrezikuar suksesin e mjekimit psikijatrik të këtyre personave, si dhe duke marrë parasysh faktin që autoritetet kompetente të UNMIK-ut dhe IPVQ-ve kishin qenë të vetëdijshme për një kohë të gjatë për mungesën e përgjithshme strukturore të kapacitetit në institucionet shëndetësore të kësaj

natyre në Kosovë, Ombudspersoni erdhi në konkludim që praktika në fjalë kishte shkelur të drejtat e këtyre personave sipas par. 1 të nenit 5 të Konventës.

Pas hyrjes në fuqi të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, më 6 prill 2004, Ombudspersoni vërejti që ligjet jugosllave më nuk ishin të aplikueshme në këtë situatë. Megjithatë, Kodi i ri Penal nuk përmbante kurrfarë dispozita lidhur me kërkesat dhe procedurën e urdhërimit të mjekimit të detyrueshëm psikijatrik. Në vend të kësaj, Kodi Penal ia referon këtë çështje një ligji tjetër të veçantë. Megjithatë, një ligj i tillë ende nuk është miratuar apo shpallur. Prandaj, Ombudspersoni erdhi në konkludim që më nuk ekzistonte bazë ligjore për ruajtjen e kryerësve të veprave penale në gjendje të papërgjegjshmërisë ose papërgjegjshmërisë së pakësuar në insitucionet përkatëse shëndetësore, dhe që çfarëdo ruajtje të tilla ishin në shkelje të nenit 5 të Konventës.

Ombudspersoni rekomandoi që PSSP të sigurojë që një ligj përkatës lidhur me ruajtjen e kryerësve të veprave penale në gjendje të papërgjegjshmërisë ose papërgjegjshmërisë së pakësuar të miratohet dhe të shpallet menjëherë dhe që PSSP dhe Ministria e Shëndetit, jo më vonë se më 15 shtator 2004, të bëjnë çdo gjë që të jetë e mundur për të gjetur një zgjidhje që do të mundësonte që këtyre kategorive të personave të u ofrohet mjekimi i nevojshëm dhe i kërkuar psikijatrik në institucionet përkatëse shëndetësore.

## PËRMBLEDHJE

Nr. i Regjistrimit *ex officio* 39/04

Lidhur me të drejtat për një proces të rregullt gjyqësor të dymbëdhjetë anëtarëve të suspenduar të Trupave Mbrojtëse të Kosovës

Më **30 qershor 2004**, Ombudspersoni në Kosovë, në pajtim me Nenin 4.4 dhe 4.9 të Rregullorës së UNMIK-ut Nr. 2000/38 mbi Themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë dhe Rregullës 18 dhe 19 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, ka publikuar raportin e lartpërmendur.

Ky raport kishte të bëjë me suspendimin gjashtëmuor të dymbëdhjetë anëtarëve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) nga vendet e tyre të punës përmes një vendimi të PSSP-së të datës 3 dhjetor 2003, që pastaj ishte revokuar në maj të vitit 2004. PSSP e kishte bazuar këtë vendim në informata të besueshme të cilat i kishin lidhur këta persona me “aktivitete të natyrës serioze që qartas nuk ishin në pajtim me pjesëmarrjen e tyre në TMK” dhe gjithashtu kishte udhëzuar që të hapen hetimet penale lidhur me këto informata. Duke gjetur që ky vendim mund të konsiderohet si akuzë e qartë penale në kuptim të lirë të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, i cili mbron të drejtën e çdo personi për një proces të rregullt gjyqësor, Ombudspersoni konkludoi që oficerët e suspenduar të TMK-së nuk ishin informuar në mënyrë të hollësishme për bazën faktike dhe ligjore të akuzave kundër tyre. Si rrjedhim i kësaj, ata nuk kishin qenë në gjendje ta mbrojnë vetën në mënyrë adekuate kundër këtyre akuzave. Ombudspersoni konkludoi që me këtë rast ishin shkelur të drejtat e këtyre personave për një proces të rregullt gjyqësor sipas nenit 6 të Konventës.

## PËRMBLEDHJE

Nr. i Regjistrimit 596/02

Lidhur me keqtrajtimin në rastin

DRITON HOXHA

Më **30 qershor 2004**, Ombudspersoni në Kosovë, në pajtim me paragrafin 4.4 dhe 4.9 të Rregullorës së UNMIK-ut nr. 2000/38 mbi Themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë dhe Rregullës 18 dhe 19 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, ka nxjerrë raportin në rastin e lartëpërmendur.

Në këtë raport, duke analizuar sa ishin adekuate hetimet penale mbi pohimet e aplikantit rreth keqtrajtimit nga ana e një polici të UNMIK-ut, Ombudspersoni së pari vërejtí që, për shkak të mungësë së bashkëpunimit nga ana e policisë e UNMIK-ut, ai nuk kishte mundur të marrë informata të mjaftueshme për të vërtetuar nëse aplikanti në fakt ishte keqtrajtuar nga ana e një pjesëtari të policisë së UNMIK-ut. Ombudspersoni më tutje vërejtí që autoritetet vendore të prokurorisë në Kosovë nuk kishin qenë kompetente për të zhvilluar hetimet në këtë rast për shkak të imunitetit të anëtarëve të policisë së UNMIK-ut ndaj gjykatave në Kosovë. Në të njejtën kohë, hetimet e brendshme të zhvilluara nga ana e vetë policisë së UNMIK-ut kishin për qëllim vetëm zhvillimin e procedurës disiplinore, e jo për ta çuar kryerësin e pohuar përpara një gjykate penale. Prandaj, për shkaqe të ndryshme, autoritetet publike përgjegjëse vendore dhe ndërkombëtare nuk qenë në gjendje që përmbushin obligimin procedural të vendosur mbi to përmes nenit 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, pra të zhvillojnë hetime efektive mbi pohimet e keqtrajtimit të mundshëm nga ana e personave që veprojnë brenda ushtrimit të detyrave të tyre zyrtare. Fakti që ligji i aplikueshëm në Kosovë nuk ofron qasje efektive në procedurën penale ose procedurën e kompenzimit në raste të këtilla është gjithashtu në shkelje të nenit 13 të Konventës, i cili ia garanton çdo personi të drejtën për ankim efektiv. Në fund, Ombudspersoni gjeti që dështimi i policisë së UNMIK-ut për të bashkëpunuar me Ombudspersonin duke ia refuzuar qasjen në dosjen përkatëse të policisë kishte përbërë shkelje të obligimit të UNMIK-ut për ta ndihmuar Ombudspersonin në hetimet e tij sipas nenit 4.7 të Rregullores së

Ombudspersoni rekomandoi që PSSP do të duhej që, jo më vonë se më 30 gusht 2004, të sigurojë që të hapen hetimeve penale kundër policit të UNMIK-ut i cili kishtë përdorur forcë të tepruar kundër aplikantit në qershor të vitit 2002, kudo që mund të jetë e mbuluar me juridiksion. Për të tepër, ai do të duhej të shpallë një rregullore ose të sigurojë që të miratohet një akt përkatës ligjor për të garantuar që secili individ që ka qenë viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut apo keqpërdorimit të autorizimeve nga ana e personave që veprojnë brenda ushtrimit të detyrave të tyre zyrtare, përfshirë këtu edhe stafin e UNMIK-ut, të ketë në dispozicion një ankim efektiv, edhe në Kosovë, në kuptim të nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në fund, PSSP do të duhej të sigurojë që administrata e përkohshme civile dhe çdo institucion lokal dhe qëndror që krijohet të bashkëpunojnë me Ombudspersonin duke i ofruar atij informatat përkatëse, dokumentet dhe dosjet, në pajtim me nenin 4.7 të Rregullorës së UNMIK-ut Nr. 2000/38.

#### **Aneksi 4: Përmbledhje e letrave të përzgjedhura (1 korrik 2003 – 30 qershor 2004)**

##### **Vendosja e kriminelëve me paaftësi mendore dhe atyre me aftësi të kufizuara mendore në Klinikën për Shëndet Mendor në Prishtinë**

*Më 2 korrik 2003, Ombudspersoni pranoi letër nga mjekët e Klinikës për Shëndet Mental në Prishtinë, të cilët ankoreshin rreth faktit se kriminelët me paaftësi mendore dhe kriminelët me aftësi mendore të kufizuara të dërguar në klinikë për kontrollë psikiatrike nga mjekët ligjor ishin vendosur në të njëjtin repart me të sëmurit e rëndomtë psiqik.*

**19 gusht 2004:** Ombudspersoni i dërgoi një letër Zëvendës PSSP-së për Polici dhe Drejtësi, duke kërkuar intervenim serioz, adekuat dhe të menjëhershëm me qëllim që personat e lartpërmendur të vendoseshin në ndërtesë tjetër në mënyrë që të ndaheshin nga pacientët e rëndomtë.

**25 gusht 2003:** Ombudspersoni pranoi letër nga Zëvendës PSSP-ja për Polici dhe Drejtësi, i cili informonte Ombudspersonin se ai ishte duke e shqyrtuar çështjen e ngritur nga Ombudspersoni.

**22 tetor 2003:** Ombudspersoni i dërgoi letrën e dytë Zëvendës PSSP-së për Polici dhe Drejtësi duke përsëritur kërkesat e mëparshme.

**12 dhjetor 2003:** Ombudspersoni pranoi letër nga Zëvendës PSSP-ja për Polici dhe Drejtësi, i cili informonte Ombudspersonin rreth dy zgjidhjeve të mundshme. Zgjidhja e parë e propozuar nga Departamenti i Drejtësisë së UNMIK-ut kishte të bënte me sigurimin e një reparti të klinikës, i cili do të përdorej për të paraburgosurit. Zgjidhja e dytë kishte të bënte me ndërtimin e një objekti brenda kompleksit të klinikës, enkas për pacientët e sektorit të drejtësisë. Zëvendës PSSP-ja theksonte në letrën e tij se objekti i ri mund të ndërtohej shpejt dhe pa shpenzime të mëdha.

**26 janar 2004:** Ombudspersoni i dërgoi një letër Kryeministrit, duke e informuar atë lidhur me hapat që ishin ndërmarrë nga Zëvendës PSSP-ja për Polici dhe Drejtësi për të zgjidhur problemet lidhur me Klinikën për Shëndet Mendor në Prishtinë. Në letrën e tij, Ombudspersoni poashtu theksonte se zgjidhja e parë e propozuar nga Departamenti i Drejtësisë së UNMIK-ut ishte refuzuar nga Ministria e Shëndetësisë, dhe se vetëm zgjidhja e dytë mund të diskutohej. Duke theksuar urgjencën e çështjes, Ombudspersoni kërkoi nga qeveria të ndërmarrë hapa të shpejtë ndërmjetësues për të përmirësuar situatën derisa instituti i mjekësisë ligjore të bëhej funksional.

##### **Nuk ka pasur përgjegjje për këtë letër.**

**16 mars 2004:** Ombudspersoni pranoi një letër nga Zëvendës PSSP-ja për Polici dhe Drejtësi, i cili, përveç tjerash, sqaronte se Ministria e Shëndetësisë ishte pajtuar me propozimin e Departamentit të UNMIK-ut për Drejtësi për ndërtimin e një ndërtese të re për nevojat e sektorit të drejtësisë për të vendosur pacientët. Për të zgjidhur problemin përkohësisht është marrë vendim që një pjesë e klinikës për shëndet mental të modifikohet.

**15 qershor 2004:** Ombudspersoni pranoi një letër nga Drejtori i Departamentit për Drejtësi në UNMIK në të cilën, përveç tjerash, theksonte përgjegjësinë që ka Ministria e Shëndetësisë për themelimin e objekteve për akomodimin e pacientëve të sektorit të drejtësisë dhe bëri më dije se kjo do të ishte mënyra e vetme për të gjetur një zgjidhje për çështjen e lartpërmendur



## Regjistrimi i automjeteve në Kosovën veriore

*Më 4 gusht 2003, Ombudspersoni pranoi letër nga Kryetari i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, në të cilën ai shprehte brengën për urdhërat ekzekutiv të UNMIK-ut si dhe urdhërat dhe rregullat tjera lidhur me regjistrimin e veturave private në Kosovë. Sipas mendimit të tij, regjimi legal i paraqitur nga UNMIK-u në këtë fushë shkelte standardet e të drejtave të njeriut, posaçërisht principin e mos-diskriminimit dhe barazisë para ligjit.*

**19 gusht 2003:** Ombudspersoni i dërgoi një letër Zëvendës PSSP-së për Polici dhe Drejtësi, duke i kërkuar kopje të urdhërave përkatës ekzekutiv, si dhe rregullave tjera relevante lidhur me regjistrimin e veturave private në Kosovën veriore. Në po të njejtën letër, Ombudspersoni kërkonte shpjegim lidhur me arsyet që kishin sjellur deri te përdorimi i një regjimi të tillë.

**6 tetor 2003:** Ombudspersoni pranoi letër nga PSSP-ja, në të cilën ai shpjegonte se planifikohej një urdhër ekzekutiv si masë e përkohshme për të arritur angazhimin ligjor të UNMIK-ut për serbët e Kosovës, në mënyrë që “të rritej liria e lëvizjes përmes lëshimit falas të targave për serbët e Kosovës”. Urdhëri i lartpërmendur kishte skaduar më 31 gusht 2003. Më 30 gusht 2003 u nënshkrua vendimi ekzekutiv për regjistrimin e veturave private në Kosovë. Ky vendim lironte të gjithë banorët e Kosovës nga pagimi i taksës për regjistrimin fillestar të veturave private në Kosovë. Në po të njejtën letër PSSP-ja informonte Ombudspersonin për progresin në përgatitjen e protokollit për lëvizjen e lirë të veturave të regjistruara dhe për sigurimin e kthimit falas të targave të ish-RFJ-së në targa të Kosovës, pa marrë parasysh përkatësinë etnike të aplikuesit.

**20 nëntor 2003:** Ombudspersoni i dërgoi një letër Kryetarit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë. Pas marrjes së përgjegjjes nga PSSP-ja, Ombudspersoni konsideronte se problemet e ngritura nga Kryetari i Gjykatës së Qarkut ishin zgjedhur, dhe se nuk kishte nevojë që Ombudspersoni të involvohej më tutje në këtë çështje të veçantë.

### Mungesa e hetimit përkatës lidhur me bombardimin e autobusit “Nish Express”

*Më 8 gusht 2003, Ombudspersoni pranoi letër një aplikacion lidhur me mungesën e hetimit përkatës të bombardimit të autobusit të Nis Express-it që kishte ndodhur në fshatin Merdare afër kufirit administrativ me Serbinë. Aplikanti ankohej se ai nuk kishte pranuar asnjë dokument zyrtar lidhur me rezultatet e hetimeve policore.*

**1 shtator 2003:** Ombudspersoni i dërgoi një letër Komisarit të Policisë së UNMIK-ut duke kërkuar informata lidhur me fazën e hetimeve si dhe duke kërkuar kopje të çfarëdo dokumenti zyrtar lidhur me rastin.

**22 shtator 2003:** Ombudspersoni pranoi letër nga Komisari i Policisë së UNMIK. Sipas kësaj informate, hetimet lidhur me bombardimin e Nis Express-it po vazhdonin dhe ishte arritur sukses në këtë drejtim. Komisioneri i Policisë së UNMIK-ut refuzoi t’i siguronte Ombudspersonit dokumentet e kërkuara, duke pasur parasysh se rasti ishte ende nën hetime.

**5 dhjetor 2003:** Ombudspersoni i dërgoi një letër PSSP-së duke përsëritur kërkesën e tij për qasje në dokumentet e lartpërmendura. Në rast refuzimi, ai kërkoi një deklaratë të shkruar nga PSSP-ja lidhur me arsyet e refuzimit. Nuk ka pasur përgjegje për këtë letër.

### **Nuk ka pasur përgjegjje në këtë letër.**

**26 janar 2004:** Ombudspersoni i dërgoi letrën e dytë PSSP-së, në të cilën përsëriti kërkesat e letrës së mëparshme.

### **Nuk ka pasur përgjegjje në këtë letër.**

#### **Dorëzimi i vendimeve të gjykatës të të arrestuarve**

**8 qershor 2003:** Ombudspersoni i dërgoi një letër Drejtorit të Departamentit të Drejtësisë, duke shprehur shqetësimin e tij lidhur me vonesën e dorëzimit të vendimeve të gjykatës të të arrestuarve, posaçërisht në rastet e lirimit të individëve nga paraburgimi. Në veçanti, ai i referohej rasteve kur të arrestuarit mbaheshin në paraburgim më shumë se 48 orë pas lëshimit të vendimit për lirim nga ana e gjykatës. Në këtë letër, Ombudspersoni poashtu kërkonte masa urgjente dhe konkrete në përputhje me standardet e të drejtave të njeriut si dhe dispozita relevante të Procedurës së aplikueshme Jugosllave të Aktit Kriminal

### **Nuk ka pasur përgjegjje për këtë letër**

**11 nëntor 2003:** Ombudspersoni i dërgoi një letër PSSP-së, duke përsëritur kërkesën e letrës së tij të mëparshme.

**29 dhjetor 2003:** Ombudspersoni pranoi letër nga Zëvendës PSSP-ja për Polici dhe Drejtësi, në të cilën ai informonte Ombudspersonin rreth hapave të ndërmarrë nga Departamenti i Drejtësisë në mënyrë që të gjindej një zgjidhje për problemin e lartpërmendur. Ai poashtu ilustronte përmbajtjen e letrës qarkore rreth dorëzimit të dokumenteve të gjykatës të të arrestuarve, e lëshuar rishtas nga Departamenti i Drejtësisë për të siguruar se në të ardhmen dorëzimi i dokumenteve të gjykatës për të arrestuarit do të zhvillohej në bazë të ligjit të aplikueshëm.

#### **Dorëzimi i kompetencave nga stafi ndërkombëtar te homologët e tyre lokal në Departmentin e Administratës Juridike**

**24 tetor 2003:** Ombudspersoni i dërgoi një letër PSSP-së, duke shprehur shqetësimin e tij lidhur me dorëzimin e kompetencave të stafit ndërkombëtar të Departamentit të Administratës Juridike te homologët e tyre lokal. Sipas Ombudspersonit, projekti i lartpërmendur ishte i parakohshëm, duke pasur parasysh rolin kritik të Departamentit të Administratës Juridike brenda sistemit gjyqësor të Kosovës si dhe ndikimin direkt të Departamentit të Administratës Juridike mbi funksionimin e gjykatave individuale. Ombudspersoni theksonte se çfarëdo reduktimi në angazhim, çfarëdo moskompetence ose anim subjektiv brenda Departamentit të Administratës Juridike mund të pengonte funksionimin e duhur të gjykatave të Kosovës dhe të ndikonte në mënyrë jo të favorshme në efikasitetin e sistemit juridik dhe do të rezultonte në dekurajim të stafit. Në letrën e tij, për më tepër, Ombudspersoni shprehte shqetësimin e tij lidhur me mungesën e minoriteteve etnike në pozitat të rëndësishme në Departamentin e Administratës Juridike, duke nënvizuar se rekrutimi i anëtarëve të minoriteteve etnike në pozita me autoritet më të lartë do të rezultonte në një sistem të kontrolluar dhe të balancuar kundër diskriminimit subjektiv.

**Nuk ka pasur përgjegjje për këtë letër.**

### **Ligji Për Barazi Gjinore**

**30 Tetor 2003:** Ombudspersoni i dërgoi një letër Kryetarit të Parlamentit të Kosovës, duke shprehur shqetësimet e tij për disa dispozita të caktuara në Projektligjin për Barazi Gjinore. Këto dispozita, lidhur me themelimin e një Zyreje për Barazi Gjinore dhe me caktimin e një Ombudspersoni për Barazi Gjinore sipas Ombudspersonit ishin në kundërshtim me Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme. Ombudspersoni theksoi se çështjet të cilat kishin të bënin me barazi gjinore ishin plotësisht nën juridksionin e tij ashtu siç ishte edhe detyrë e tij, mes tjerash, që t'i jipte prioritet të veçantë akuzave të bazuara në diskriminim, të cilat mes tjerash përfshinin çështjen e barazisë gjinore. Për më tepër, Institucioni i Ombudspersonit për Barazi Gjinore do të dyfishonte aktivitetet e ndërmarra nga Institucioni i Ombudspersoni në Kosovë, duke kushtëzuar shpenzime qeveritare të panevojshme dhe konfuzion në publikun e Kosovës. Në fund, Ombudspersoni kërkoi nga Kryetari i Parlamentit të Kosovës që të informonte Parlamentin e Kosovës lidhur me shqetësimet e shprehura në letër si dhe ti kushtojë rendësi të posaçme argumenteve të ngritura para se të miratohej projektligji për barazi gjinore.

**Nuk ka pasur përgjegjje për këtë letër.**

**12 shkurt 2004:** Ombudspersoni i dërgoi letrën e dytë Kryetarit të Parlamentit të Kosovës, duke përsëritur pozitën e tij dhe kërkesat e paraqitura në letrat e tij të mëparshme.

**Nuk ka pasur përgjegjje për këtë letër.**

**1 mars 2004:** Gjatë promovimit të Projektligjit për Barazi Gjinore, Kryetarja e Komitetit për Barazi Gjinore, duke iu referuar letrës së Ombudspersonit, e akuzoi publikisht Ombudspersonin për ndërhyrje flagrante në kompetencat e institucioneve lokale në Kosovë.

**2 mars 2004:** Si përgjegjje ndaj këtyre akuzave publike, Ombudspersoni lëshoi një deklaratë për media, të cilën ia dërgoi edhe Kryetarit të Parlamentit të Kosovës. Në deklaratën e tij, Ombudspersoni thoshte se kritika e tij ndaj Projektligjit për Barazi Gjinore nuk kishte pasur në shënjestër qëllimin dhe synimin e Projektligjit, por themelimin e një Ombudspersoni të specializuar në mbrojtjen e barazisë gjinore. Ombudspersoni sqaroi arsyet e kritikës së bërë dhe nënvizoi mungesën e ndonjë përgjegjjeje nga Kryetari i Parlamentit të Kosovës në letrat e tij të mëparshme.

**3 mars 2004:** Ombudspersoni i dërgoi një letër PSSP-së, duke përsëritur qëndrimin e tij lidhur me çështjet e lartëpërmendura. Ombudspersoni edhe njëherë përsëriti se caktimi i një Ombudspersoni të dytë, i cili do të merrej vetëm me problemet lidhur me barazinë gjinore nuk ishte i nevojshëm. Ai paralajmëroi për pasojat që mund të shkaktonte një hap i tillë, veçanërisht konfuzioni që do të krijohet rreth kompetencave të dy Ombudspersonëve si dhe shpenzimet shtesë nga ana e Qeverisë.

**11 mars 2004:** Ombudspersoni pranoi një kopje të letrës, të cilën PSSP-ja ia kishte dërguar Kryetarit të Parlamentit të Kosovës. Në këtë letër PSSP-ja shprehte shqetësimet e tij se Parlamenti i Kosovës nuk kishte marrë parasysh komentet e bëra nga Zyrtari Ligjor i UNMIK-ut dhe Ombudspersoni lidhur me Projektligjin për Barazi Gjinore. PSSP-ja theksonte se Projektligji për Barazi Gjinore, siç ishte miratuar nga Parlament i Kosovës, përmbante elemente të cilat nuk ishin në pajtim me Kornizën Kushtetuese të Kosovës. PSSP-ja theksoi se projektligji nuk mund të promulgohej pa u bërë rregullimet përkatëse.

**4 maj 2004:** Pas takimit të mbajtur më 24 prill me Komitetin për Barazi Gjinore dhe dy avokatë nga Zyra e Këshilltarit Ligjor të UNMIK-ut, Ombudspersoni i dërgoi një letër Kryetarit të Komisionit të lartëpërmendur duke shprehur qëndrimin e tij lidhur me Projektligjin për Barazi Gjinore. Kjo letër përmbante propozimin për modifikimin e dispozitave të rëndësishme të këtij ligji. Sipas Ombudspersonit, organi i autorizuar për pranimin dhe hetimin e ankesave lidhur me barazi gjinore duhet të caktohet nga Ombudspersoni i Kosovës dhe duhet të zbatonte Rregullat Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit. Ai poashtu theksoi se Institucioni i Ombudspersonit të Kosovës kishte themeluar Ekip për Mosdiskriminim që do të merret në mënyrë adekuate me të gjitha format e diskriminimit në Kosovë, përfshirë diskriminimet gjinore.

**Nuk ka pasur përgjegjje për këtë letër.**

**3 qershor 2004:** Si rezultat i disa takimeve në Zyrën e Këshilltarit Ligjor të UNMIK-ut, Ombudspersoni pranoi një kopje të letrës të cilën Këshilltari Ligjor i UNMIK-ut ia kishte dërguar Kryetarit të Komisionit për Barazi Gjinore, që përmbante indikacione për ndryshime në Projektligjin e lartëpërmendur. Ndryshimet kishin të bënin me themelimin e Njësisë për Barazi Gjinore në kuadër të Institucionit të Ombudspersonit të Kosovës.

**17 qershor 2004:** Ombudspersoni i dërgoi një letër Këshilltarit Ligjor të UNMIK-ut, duke kërkuar informata lidhur me promulgimin e Projektligjit për Barazi Gjinore.

**25 qershor 2004:** Ombudspersoni pranoi letër nga Këshilltari Ligjor i UNMIK-ut, i cili e informonte se Ligji për Barazi Gjinore ishte promulguar nga PSSP-ja më 7 qershor 2004, përmes Rregullës 2004/18 të UNMIK-ut, e cila përmbante ndryshime për të cilat ishte arritur pajtim.

### **Sjellja e policëve gjatë hetimeve**

**5 nëntor 2003:** Ombudspersoni i dërgoi një letër Zëvendës PSSP-së për Polici dhe Drejtësi, duke shprehur shqetësimin e tij lidhur me sjelljen e Policisë së UNMIK-ut gjatë hetimeve. Në veçanti ai theksonte se kur gjërat personale konfiskoheshin përkohësisht për tu përdorur si prova gjatë procedurave gjyqësore, policia shpesh nuk përgatiste raport rreth kontrollimit e as dokument lidhur me gjërat e konfiskuara. Në letrën e tij Ombudspersoni theksonte se një sjellje e tillë shkelte dispozitat relevante të procedurave penale të aplikueshme, prandaj kërkonte ndryshim urgjent të kësaj praktike policore.

**Nuk ka pasur përgjegjje për këtë letër**

### **Standardet për Kosovën**

**26 nëntor 2003:** Ombudspersoni i dërgoi një letër Koordinatorit për Standarde të UNMIK-ut, në të cilën ai përfshinte listen e çështjeve të caktuara të cilat Ombudspersoni i konsideronte të ishin të një rëndësie të veçantë kur të diskutoheshin caktimi i standardeve për të ardhmen e Kosovës. Në këtë listë Ombudspersoni theksonte rolin e autoriteteve publike të Kosovës në zhvillimin e vetëdijes së popullatës së Kosovës rreth të drejtave të njeriut, si dhe obligimin e autoriteteve publike për të bashkëpunuar me Ombudspersonin dhe për të përcjellur rekomandimet e tij gjatë gjithë kohës. Sa i përket çështjeve lidhur me sundimin e ligjit, Ombudspersoni fokusohej, mes tjerash, në rëndësinë e themelimit të një sistemi ligjor të qëndrueshëm përmes përmirësimit sigurimit të të gjitha ligjeve në të gjitha gjuhët zyrtare

të përdorura në Kosovë, rëndësinë e përmirësimit të kushteve në burg në pajtim me standardet e përgjithshme Evropiane, dhe forcimin e garancive themelore për të siguruar pavarësinë e gjyqësorit sipas standardeve të njohura ndërkombëtarisht. Ombudspersoni poashtu nënvizoi rëndësinë e sigurimit të ekzistencës së kornizës ligjore, e cila do ti garantonte çdo personi, të drejtat e të cilit janë shkelur nga autoritetet publike, mundësinë të mbante shtetin përgjegjës dhe të pranonte kompenzim adekuat. Poashtu ishte i domosdoshëm sigurimi i sistemit pensional dhe skemave të tjera themelore të sigurisë sociale në një nivel adekuat dhe të sigurohet se sistemet e tilla aplikohen pa diskriminime. Ombudspersoni më tutje thoshte se masat duhet të sigurohen në mënyrë që të përsëri të vendoset sundimi i ligjit në sektorin e ndërtimit.

Sa i përket çështjeve lidhur me kthim të qëndrueshëm dhe të drejtat e njeriut, Ombudspersoni theksoi, mes tjerash, se autoritetet dhe e tërë shoqëria e Kosovës ishin të obliguar të siguronin mbrojtje adekuate të objekteve historike dhe religjioze që iu përkisnin të gjitha komuniteteve. Për më tepër, ai theksoi nevojën për të siguruar përdorimin e gjuhëve zyrtare të Kosovës në të gjitha institucionet publike dhe të zgjeroj këtë përdorim në nivelin punues. Sa u përket çështjeve lidhur me të drejtat e njeriut, Ombudspersoni theksoi, mes tjerash, rëndësinë e sigurimit që të gjitha ankesat dhe kontestet, së paku në instancën e fundit, brenda juridiksionit të gjykatës.

### **Dështimi i Policisë së UNMIK-ut për të ju përgjegjur letrave të dërguara nga Ombudspersoni**

**27 nëntor 2003:** Ombudspersoni i dërgoi një letër PSSP-së, duke i shprehur dëshpërimin e tij për mos gatishmërinë e policisë së UNMIK-ut për t'i siguruar Ombudspersonit informata dhe/ose qasje në dosjet e policisë lidhur me rastet e shkeljeve të të drejtave të njeriut ose keqpërdorimin e detyrës nga ana e policisë. Ombudspersoni, i cili pa sukses kishte ngritur këtë çështje te PSSP-ja në dy letrat e mëparshme të dërguara në mars dhe prill 2003, drejtoi vëmendjen e PSSP-së rreth faktit se në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/38, autoritetet policore ishin të obliguara të siguronin Ombudspersonit qasje në dosje dhe dokumente si dhe të siguronin kopje të dokumenteve relavante të hetimeve. Ombudspersoni, poashtu kërkoi nga PSSP-ja që të drejtoj autoritetet kompetente policore t'i sigurojnë atij dosjet e kërkuara pa vonesë, ose të tregonin se ku dhe kur Ombudspersoni mund të ketë qasje në këto dosje. Në fund ai theksoi se pa ndonjë bashkëpunim adekuat të administratës së UNMIK-ut dhe stafit të saj, do të ishte e vështirë, në mos e pamundur, për Institucionin e Ombudspersonit që të ushtronte detyrën e tij.

**16 dhjetor 2003:** Ombudspersoni pranoi letër nga PSSP-ja, në të cilën PSSP-ja theksonte se Komisarit i Policisë së UNMIK-ut tashmë i kishte siguruar Ombudspersonit informata mbi të gjitha rastet, të cilat ky i fundit i kishte kërkuar.

**19 janar 2004:** Ombudspersoni i dërgoi njëletër Komisarit të Policisë së UNMIK-ut lidhur me letrën e PSSP-së, duke e informuar Komisarin e Policisë së UNMIK-ut se ai nuk kishte pranuar informatat e përmendura nga PSSP-ja. Ombudspersoni i siguroi Komisarit të Policisë së UNMIK-ut informata të mëtutjeshme për një numër të rasteve të përmendura në letrat e tij të mëparshme dhe përsëriti kërkesën e tij për informata dhe qasje në dosje relevante.

**Nuk ka pasur përgjegjje për këtë letër.**

## Shtimi i ndërtimeve të egra në tërë territorin e Kosovës

**27 nëntor 2003:** Ombudspersoni i dërgoi një letër Kryeministrit të Kosovës, duke shprehur shqetësimin e tij lidhur me rritjen e numrit të shtëpive të ndërtuara ilegalisht. Ombudspersoni theksonte se autoritetet publike nuk po reagonin në mënyrë adekuate ndaj kësaj situate joligjore. Si rrjedhim, nuk kishte nxitje për qytetarët e Kosovës që të respektonin ligjin. Ai kërkoi nga Kryeministri që të intervenonte në mënyrë që ky mos respektim i ligjit ekzistues për ndërtim të përfundonte.

**Nuk ka pasur përgjegjje për këtë letër.**

## Fotografitë në stacionet policore

*Më 21 nëntor 2003, Ombudspersoni pranoi ankesa, sipas të cilave fotografitë e disa individëve të caktuar, të cilat ishin varur në mur të brenda Stacionit Policor në Obiliq/Obilic dukeshin nga hyrja e stacionit policor.*

**2 dhjetor 2003:** Ombudspersoni i dërgoi një letër PSSP-së, duke i terhequr vëmendjen se kjo mund të dëmtonte të drejtën e aplikantit për jetë private dhe familjare dhe të drejtën për tu konsideruar si i pafajshëm derisa të shpallet i fajshëm nga gjykata. Prandaj, Ombudspersoni kërkonte nga PSSP-ja që të hetonte këtë dhe ratste të tjera potenciale si dhe të ndërmirte hapat e domosdoshëm për të përfunduar këtë praktikë në stacionin e policisë në Obiliq/Obilic ose kudo në Kosovë, ku aplikoheshin praktika të tilla.

**18 maj 2004:** Ombudspersoni pranoi letër nga Zëvendës PSSP-ja për Polici dhe Drejtësi, i cili mes tjerash e informonte Ombudspersonin se Policia e UNMIK-ut kishte marrë të gjitha masat adekuate në mënyrë që të siguronte se fotografitë e personave të cilët nuk ishin objekt i fletëarrestimeve zyrtare, si dhe dokumenteve zyrtare, nuk do të ishin të dukshme për publikun.

## Vështirësitë në sigurimin e dokumenteve të udhëtimit të UNMIK-ut

*Më 11 dhjetor 2003, Ombudspersoni pranoi një ankesë lidhur me vështirësitë me të cilat parashtruesja e ankesës ishte ballafaquar gjatë marrjes së dokumenteve të udhëtimit. Me sa duket, nëpunësi përgjegjës në Komunën e Vushtrrisë/Vucitrn kishte refuzuar aplikacionin e parashtruesës së ankesës për përtëritjen e dokumentit të saj të udhëtimit të UNMIK-ut për shkak të kriterëve të reja të caktuara nga Administrata Civile e UNMIK-ut, e cila kishte kërkuar dorëzimin e dokumenteve Jugosllave si dëshmi për identitetin e personit, përveç atyre të lëshuara nga UNMIK.*

**13 janar 2004:** Ombudspersoni i dërgoi një letër Drejtorit të Çështjeve Administrative të Regjistrimit Civil Qëndror të UNMIK-ut, duke shprehur shqetësimin e tij lidhur me situatën e lartpërmendur. Ombudspersoni theksoi se kishte shumë Kosovarë që nuk posedonin dokumente jugosllave të udhëtimit dhe të cilët nuk kishin pasur mundësi të pajiseshin me to, pasi që dokumentet e tilla mund të merreshin në Serbi. Në letrën e tij Ombudspersoni kërkoi nga Drejtori i Çështjeve Administrative t'a informonte atë nëse Zyra e Regjistrimit Civil të UNMIK-ut kishte caktuar kriterë të reja për lëshimin e dokumenteve të udhëtimit, dhe nëse po, ti siguronte një kopje të shkruar të këtyre kriterëve.

**27 janar 2004:** Ombudspersoni pranoi letër nga Drejtori i Çështjeve Administrative të Zyrës së regjistrimit civil të UNMIK-ut, në të cilën Drejtori spjegonte se në mënyrë që të parandaloheshin rastet e regjistrimit dhe/ose dokumentet e udhëtimit të UNMIK-ut të bazuara në prova të rrejshme, joligjore apo të papranueshme, Regjistrimi Civil i UNMIK-ut kishte themeluar një proces ekzaminues për regjistrimin civil. Ai theksoi se në këtë proces të ri, të caktuar nga Urrdhëresa Administrative 2003/20 e 7 gushtit 2003 nga PSSP-ja, nuk paraqiste kriteret e reja për të drejtën e individit për regjistrim civil dhe shërbime të dokumenteve të udhëtimit. Në letrën e tij, Drejtori i Çështjeve Administrative për më tepër spjegonte se një procedurë që përfshinte Regjistrimin Civil të UNMIK-ut dhe Komisionin e Ankesave të Regjistrimit të UNMIK-ut ishte themeluar për ato raste në të cilat dokumentet e kërkuara nuk mund të dorëzoheshin.

### **Përpyjekjet për njohje zyrtare të dëmeve të shkaktuara viktimave gjatë bombardimit të urës së Luzhanit/Luzane në vitin 1999**

*Që nga themelimi i Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë më 2000, një numër i madh i banorëve të Kosovës kishin vizituar Ombudspersonin lidhur me humbjen e anëtarëve të familjes gjatë sulmeve ajrore të NATO-s të vitit 1999. Shumë prej këtyre rasteve i referoheshin incidenteve, për të cilat edhe vet NATO kishte pranuar ti ketë bërë gabimisht, p.sh. bombardimi i autobusit të udhëtarve afër urës së fshatit Luzhan/Luzane.*

**22 janar 2004:** Pas kërkesës së mëparshme të pasuksesshme drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s më 2001 për kompenzim të viktimave të gabimeve të tilla ushtarake, Ombudspersoni ngrii sërish këtë çështje me Sekretarin e Përgjithshëm aktual. Ai pyeste pse NATO këmbëngulte në mosgatishmërinë për të ofruar ndonjë lloj kompenzimi dhe nënvizonte se një kompenzim i tillë mund të bëhej brenda suazave të mundësisë për kompenzim.

**20 shkurt 2004:** Ombudspersoni i përcolli Komandantit të KFOR-it një letër të cilën ai e kishte pranuar nga një kosovar, i cili kishte humbur tetë anëtarë të familjes gjatë sulmit në urën afër fshatit Luzhan/Luzane. Ky person, i cili në të njëjtën kohë përfaqësonte familjet e viktimave tjera të këtij incidenti, ankohej kundër mosnjohjes së dëmeve të cilat iu ishin shkaktuar civilëve gjatë këtij sulmi.

**25 maj 2004:** Ombudspersoni pranoi letër nga Këshilltari Ligjor Kryesor i Shtabit Kryesor të KFOR-it, i cili informonte Ombudspersonin se letra e lartpërmendur i ishte dërguar nivelit më të lartë të zingjirit komandues të NATO-s për të shqyrtuar dhe kërkuar detaje specifike lidhur me familjet në fjalë.

**4 qershor 2004:** Ombudspersoni informoi ankuesin lidhur me letrën e KFOR-it dhe kërkoi prej tij informata të domosdoshme lidhur me këtë rast.

**7 qershor 2004:** Ombudspersoni i dergoi Këshilltarit Ligjor Kryesor të KFOR-it dokumentet, të cilat ai i kishte marrë nga ankuesi, dhe kërkonte prej tij që këto dokumente t'ia përcillte NATO-s.

**22 qershor 2004:** Ombudspersoni pranoi një letër nga Sekretari Gjeneral i NATO-s, në të cilën ai spjegonte se NATO shprehte keqardhje të thellë për të gjithë personat civil të lënduar pa qëllim nga Forcat Operative Aleate dhe se kishte marrë hapa të shumtë për të minimizuar rreziqet e dëmeve kolaterale.

Ai poashtu nënvizonte se NATO nuk mund të mbahej përgjegjëse për dëmet kolaterale që i ishin shkaktuar individëve si rezultat i Forcave Operative Aleate, ngase ky operacion kishte qenë rezultat direkt i politikave të ndjekura nga ish-kryetari Milloshevic.

## **Përfaqësimi i punonjësve shqiptarëve në Qendrën për Paraburgimit në Mitrovicë**

**28 janar 2004:** Ombudspersoni i dërgoi një letër Zëvendës PSSP-së për Polici dhe Drejtësi, duke kërkuar informata lidhur me përfaqësimin e punonjësve shqiptar në Qendrën për Paraburgimin në Mitrovicë dhe pyeste nëse ishin marrë ose planifikuar hapa për rritjen e numrit të tyre.

**16 mars 2004:** Ombudspersoni pranoi letër nga Zëvendës PSSP-ja për Polici dhe Drejtësi. Letra përmbante informacione të hollësishme lidhur me përfaqësimin aktual në qendrën e lartpërmendur të paraburgimit si dhe informonte Ombudspersonin lidhur me hapat që ishin marrë në mënyrë që të shtohet numri i shqiptarëve në mesin e punonjësve.

## **Lirimi i të burgosurve dhe i të arrestuarve të sjellur nga Serbia në Kosovë në bazë të urdhëresave administrative të UNMIK-ut**

*Më 29 dhjetor 2003, Ombudspersoni pranoi letër nga një individ që ankohej se një person i cili kishte qenë i akuzuar dhe dënuar nga Gjykata e Qarkut në Mitrovicë para vitit 1999, për vrasjen e motrës të aplikantit, pas transferit nga burgu i Serbisë në një burg të Kosovës, ishte liruar edhe pse vendimi i Gjykatës së Qarkut nuk ishte përfundimtar. Lirimi ishte bazuar në një urdhër administrativ të UNMIK-ut. Pas lirimit, ky person thuhej se kishte kërcënuar familjen e aplikantit.*

**29 janar 2004:** Ombudspersoni i dërgoi një letër Zëvendës PSSP-së për Polici dhe Drejtësi, duke shprehur brengosjen e tij lidhur me situatën e lartpërmendur dhe duke kërkuar informata lidhur me bazat ligjore, në të cilat ishte referuar administrata kur kishte marrë vendimin për lirim. Në një vërejtje më të përgjithshme, Ombudspersoni ngriti çështjen se si UNMIK-u mendonte të merrej me rastet e krimeve serioze, ku personat ishin kthyer në Kosovë nga burgjet e Serbisë dhe pastaj ishin liruar pa marrë parasysh se a kishin përfunduar gjykimet e tyre me vendim final apo jo.

**2 shkurt 2004:** Ombudspersoni pranoi kopje të letrës të cilën Zëvendës PSSP-ja për Polici dhe Drejtësi ia kishte dërguar aplikantit, në të cilën premtuhej se Departamenti i Drejtësisë i UNMIK-ut do tu dërgonte kërkesë zyrtare autoriteteve Serbe në mënyrë që të merrte dokumente relevante nga gjykata rreth rastit, përfshirë këtu edhe vendimin final të gjykatës. Për më tepër, ai siguronte se posa të merrte këto dokumente përkatëse do të vazhdohej me rishikimin e mëtutjeshëm të rastit.

**10 shkurt 2004:** Ombudspersoni i dërgoi një letër PSSP-së duke theksuar se letra e pranuar më 2 shkurt 2004, nuk përmbante përgjegjje të mjaftueshme dhe adekuate lidhur me rregullën e përgjithshme serioze të ligjit të ngritur në letrën e tij të 29 janarit 2004.

**30 mars 2004:** Ombudspersoni pranoi letër nga Zëvendës PSSP-ja për Polici dhe Drejtësi, e cila, mes tjerash, përmbante disa informata shtesë lidhur me urdhëresën administrative të lartpërmendur. Letra poashtu përmbante informata lidhur me lirimimin e personave të tjerë të dënuar në Serbi, por megjithatë nuk i përgjigjej pyetjes së parashtruar nga Ombudspersoni lidhur me mënyrën se si UNMIK-u mendonte të merrej me raste të ngjashme.

## **Trajtimi i anëtarëve të Koalicionit “Povratak” në Parlamentin e Kosovës**

*Më 19 janar 2004, Ombudspersoni pranoi letër nga një anëtar i Koalicionit Kthimi, në të cilën mes tjerash ai ankohej se gjatë seancës së parë parlamentare të vitit 2004, delegatët*



*shqiptarë kishin kërkuar të mbahej një minutë heshtje në nderim të personave që masakruar në Reçak/Racak në vitin 1999. Aplikanti ankohej se Parlamenti i Kosovës nuk aplikonte këtë praktikë për rastet kur viktimat ishin serb. Për më tepër, ai theksonte përdorimin e një gjuheje diskriminuese dhe ofenduese nga delegatët, si kundër Koalicionit Kthimi, ashtu edhe kundër anëtarëve tjerë të kombësisë jo-shqiptare.*

**29 janar 2004:** Ombudspersoni i dërgoi një letër PSSP-së, duke shprehur shqetësimin e tij lidhur me incidentin e lartpërmendur dhe kërkonte prej tij informata lidhur me hapat që UNMIK-u mendonte t'i mirrte lidhur me këtë çështje.

**9 mars 2004:** Ombudspersoni pranoi letër nga PSSP-ja, i cili ndante të njejtin shqetësim me Ombudspersonin. Për më tepër, PSSP-ja spjegonte se i kishte tërhequr vërejtjen Kryetarit të Parlamentit se një sjellje e tillë ishte e papranueshme, duke e bërë të qartë mes tjerash se kjo sjellje do të kishte ndikim në arritjen e standardeve për Kosovën.

### **Ndalimi i faljes në Institucionet publike arsimore në Kosovë**

*Më 30 janar 2004, gazeta e përditshme e Kosovës “Koha Ditore” publikoi një artikull në lidhje me problemet me të cilat ballafaqoheshin besimtarët e fesë Islame të cilët nuk do të lejoheshin më të falen në hapsirat e institucioneve publike arsimore të Kosovës. Me sa duket, ky vendim u bë publik nga Ministri i Arsimit, pas një takimi me kryetarin e bashkësisë islame të Kosovës.*

**9 shkurt 2004:** Ombudspersoni i dërgoi një letër Ministrit për Arsim, në të cilën i shprehte shqetësimin e tij në lidhje me kufizimin e të drejtës të individëve për të shfaqur fenë e tyre dhe kërkonte informata rreth dispozitave ligjore në të cilat Ministri i lartpërmendur e ka bazuar vendimin e tij për të ndaluar faljen në hapsirat e institucioneve publike arsimore në Kosovë.

### **Nuk ka pasur përgjegjëje për këtë letër**

**8 qershor 2004:** Ombudspersoni i dërgoi një letër Kryeministrit të Kosovës në të cilën shprehte shqetësimet e tij në lidhje me dështimin e Ministrit të Arsimit për tu përgjegjës letrës së tij të mëparshme dhe përsëriste përmbajtjen e letrës së mëparshme.

### **Nuk ka pasur përgjegjëje për këtë letër**

#### **Çështja e largimit të postit të sigurimit të KFOR-it nga Manastiri i Kryeengjëjve të Shenjtë**

*Në fillim të shkurtit të vitit 2004, agjencia serbe e lajmeve Beta publikoi lajmin lidhur me vendimin e Komandantit të KFOR-it gjerman për largimin e postit të sigurisë së KFOR-it nga Manastiri i Kryeengjëjve të Shenjtë afër Prizrenit si dhe për ndalimin e përdorimit të gjeneratorit ushtarak të vendosur para manastirit. Sipas pohimeve të murgëve të Manastirit të Kryeengjëjve të Shenjtë, qëllimi i KFOR-it gjerman ishte t'i denonte ata për shkak se kishin zbuluar lajmin për incidentin që kishte ndodh në Gjakovë/ Đakovica, kur një grup shqiptarësh kishin sulmuar një automjet të KFOR-it.*

**9 shkurt 2004:** Ombudspersoni i dërgoi një letër Komandantit të KFOR-it gjerman, duke kërkuar informata se a ishin të vërteta faktet e publikuara, dhe nëse po atëherë të spjegonte pse Komandanti i KFOR-it kishte vendosur të largonte postin e sigurimit nga Manastiri i

Kryeengjëjve të Shenjtë. Ombudspersoni poashtu theksonte rendësinë e ofrimit të sigurisë dhe ndihmës për Kishën serbe dhe kërkonte informata lidhur me përgatitjet alternative që KFOR-i gjerman kishte ndër mend t'i bënte për të siguruar mbrojtje përkatëse për murgët si dhe për monumente aq vitale religjioze dhe historike.

**Nuk ka pasur përgjegjje për këtë letër.**

### **E drejta e nxënësve Goran për arsimim**

*Në janar 2004, gjatë takimit me Ombudspersonin, një anëtar i parlamentit të Kosovës me përkatësi gorane, parashtrroi ankesë lidhur me sfidat me të cilat nxënësit e komunitetit goran po ballafaqoheshin rreth shkollimit të lartë pas aplikimit të reformave në Kosovë. Këto reforma planifikoheshin të fillonin me klasën e 9-të. Anëtarët e komunitetit goran refuzuan të regjistronin fëmijët e tyre në klasën e 9-të, ngase ata do të humbnin një vit shkollor në kontekstin rajonal, për shkak se shkollat jashtë Kosovës ende nuk kishin aplikuar reforma të ngjashme. Kështu nxënësit goran ballafaqoheshin me pengesa të shumta lidhur me edukimin e lartë në universitete brenda rajonit. Në vitin 2002, implementimi i reformave për klasën e 9-të ishte shtyer për një vit në shkollat ku ndiqnin mësimet fëmijët goran. Atëherë, komuniteti goran kërkoi nga Ministria e Edukimit, Shkencës dhe Teknologjisë të zgjaste këtë përjashtim për vitin e ardhshëm, pasi që kushtet për përjashtim ende ekzistionin. Me sa duket, Ministria e Edukimit, Shkencës dhe Teknologjisë nuk kishte krijuar kushtet adekuate në mënyrë që studentët goran të vazhdonin edukimin në Kosovë bazë të nevojave dhe pritjeve.*

**10 shkurt 2004:** Ombudspersoni i dërgoi një letër PSSP-së, duke e informuar atë për vështirësitë me të cilat po ballafaqoheshin studentët goran dhe duke kërkuar prolongim të përshtatshëm për këta studentë edhe për një apo dy vite shkollore. Sipas Ombudspersonit, prolongimi i përjashtimit do t'i mundësonte Ministrisë së Edukimit, Shkencës dhe Teknologjisë të ndërronte sistemin mësimor Kosovar në mënyrë që të ofronte kushte më të përshtatshme për studentët e lartëpërmendur. Më tutje, Ombudspersoni kërkonte nga PSSP-ja që të ndërmernte hapa urgjent në mënyrë që studentët goran të lejoheshin të gëzonin të drejtën e tyre për arsimim.

**10 mars 2004:** Ombudspersoni pranoi letër nga Zëvendës PSSP-ja për Administrim Civil, në të cilën Zëvendës PSSP-ja, mes tjerash, spjegonte se ai tashmë kishte diskutuar me Ministrinë e Edukimit, Shkencës dhe Teknologjisë nevojën për të marrë hapa në mënyrë që studentët e komunitetit goran të mund të vazhdonin mësimet pandërprerë. Më tutje, ai shtonte se që nga viti 2002, Ministria e Edukimit, Shkencës dhe Teknologjisë kishte qenë e angazhuar pandërprerë për zhvillimin e plan programeve për të gjitha komunitetet, duke botuar tekstet shkollore, si dhe kishte pasur projekte për trajnim adekuat të arsimtarëve dhe drejtorëve të shkollave. Më në fund, UNMIK-u konsideronte si prioritet gjetjen e një zgjidhjeje reciprokisht të pranueshme për implementimin e planprogrameve të përshtatshme për klasën e 9-të dhe reforma të tjera në shkollat ku fëmijët goran ndjekin mësimet.

**17 maj 2004:** Ombudspersoni pranoi letër nga Ministria e Edukimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në të cilën Ministri e informonte atë lidhur me themelimin e grupit punues për të zhvilluar programin themelor studiues për studentët goran, të cilët nuk i kishin ndjekur mësimet gjatë vitit shkollor 2003/2004.

**1 qershor 2004:** Ombudspersoni pranoi kopje të letrës të cilën Zëvendës PSSP-ja për Administratë Civile ia kishte dërguar përfaqësuesit të komunitetit goran në Parlamentin e

Kosovës. Në këtë letër, Zëvendës PSSP-ja informonte përfaqësuesin e lartëpërmendur se studentët goran ishin autorizuar të ndiqnin mësim plotësues dhe të regjistrohen në klasën e 2-të të sistemit të vjetër që nga shtatori i vitit 2004. Më tutje ai shkruante se Administrata Civile e UNMIK-ut dhe Ministria e Edukimit, Shkencës dhe Teknologjisë kishte bërë përpjekje që të zgjidhte problemet e komunitetit goran në përputhje me Ligjin për Edukim Fillor dhe të Mesëm.

**15 qershor 2004:** Ombudspersoni i dërgoi një letër Ministrit për Edukim, Shkencë dhe Teknologji, duke theksuar sërish se pa pasur mundësinë të vazhdonin edukimin në vendet e tjera të rajonit, anëtarët e komunitetit goran (dhe boshnjak) nuk do të mund të ndiqnin shkollimin e lartë në gjuhën e tyre amtare, pasi që institucionet edukative të Kosovës nuk kishin siguruar kurse të tilla. Ombudspersoni theksoi se çështja e lartëpërmendur ishte e një rendësie vitale, pasi që personat në fjalë nuk mund të gëzonin të drejtën e tyre për edukim dhe do të detyroheshin të braktisnin Kosovën nëse nuk gjindej ndonjë zgjidhje e cila do të ishte në interes të të gjitha palëve në fjalë. Ai kërkoi nga Ministria e Edukimit, Shkencës dhe Teknologjisë të konsideronte këtë çështje si prioritare.

**21 qershor 2004:** Ombudspersoni pranoi një letër nga Këshilltari Ligjor i UNMIK-ut për Ministrinë e Edukimit, Shkencës dhe Teknologjisë, duke shpjeguar se ngjarjet e fundit do të siguronin që nxënësit e lartëpërmendur do të kishin qasje në edukimin e lartë në rajon. Ai informonte Ombudspersonin se Ministria e Edukimit, Shkencës dhe Teknologjisë kishte inicuar protokol për bashkëpunim në të gjitha fushat e edukimit, nënshkruar nga UNMIK-u në emër të Ministrisë së Edukimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë. Një nga temat që trajtoheshin në këtë protokol ishte njohja e certifikatave shkollore të Kosovës nga ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, e cila së shpejti do të aplikonte reforma të ngjashme me ato të aplikuara në Kosovë. Pas vizitës së Kryeministrit të Kosovës në Mal të Zi, të dy palët kishin treguar gatishmëri për të arritur marrëveshje të ngjashme në të ardhmen. Ishte e arsyeshme që gjatë dy viteve të ardhshme të mendohej se do të bëhej e mundur shqyrtimi i çështjes së certifikatave shkollore me vendet fqinje. Lidhur me nxënësit goran, Këshilltari Ligjor vërejti se më 12 dhe 17 qershor 2004, Ministri i Edukimit bëri disa udhëzime duke i liruar 38 nxënës goran nga vazhdimi i klasës të 9-të në shkollat Kosovare. Ata do të përfundonin shkollimin sipas sistemit të vjetër serb. Ministri i Edukimit, Shkencës dhe Teknologjisë poashtu kishte ndërmarrë hapa për përgatitjen e materialeve në mënyrë që të integronin fëmijët goran në reforma që nga shtatori i vitit 2004. Më tutje, Këshilltari Ligjor e informonte Ombudspersonin se sistemi bashkëkohorë i arsimit u ofronte këtyre fëmijëve që flisnin serbisht qasje në të gjitha format e edukimit në vendet ku fliteshin gjuhët sllave, por edhe në shtetet e tjera të Evropës.

### ***Largimi i pikave të kontrollit të KFOR-it nga fshatrat e banuara kryesisht nga komuniteti serb***

**10 shkurt 2004:** Ombudspersoni i dërgoi një letër Komandantit të KFOR-it, duke shprehur brengën e tij lidhur me vendimin e KFOR-it për të larguar postbllloqet nga fshatrat e banuara kryesisht ose ekskluzivisht nga komuniteti serb dhe kërkonte informata lidhur me arsyet të cilat kishin sjellur deri te një vendim i tillë. Ombudspersoni theksonte se banorët e fshatrave në fjalë nuk ndiheshin të sigurtë pa prezencën e personelit të KFOR-it dhe se mungonin shërbimet adekuate telefonike ose mjetet e tjera të komunikimit, të cilat ishin fundamentale për kërkim të ndihmës në raste emergjente. Në po të njëjtën letër, Ombudspersoni kërkonte informata lidhur me përgatitjet tjera për siguri që KFOR-i kishte

siguruar ose kishte ndër mend t'i mirrte në fshatrat e lartpërmendura në mënyrë që të siguronte mbrojtje përkatëse për popullatën që jetonte atje.

**5 mars 2004:** Ombudspersoni pranoi letër nga Këshilltari Ligjor i Shtabit Kryesor të KFOR-it, i cili në emër të Komandantit të KFOR-it spjegonte se në përputhje me Strategjinë e KFOR-UNMIK-ut për Tranzicion të Sigurisë, të gjitha detyrat jo-ushtarake tani ishin ndërmarrë nga UNMIK-u, së bashku me Policinë e UNMK-ut si dhe Shërbimin Policor të Kosovës (SHPK), ndërsa KFOR-i siguronte vetëm mjetet dhe kapacitetet e nevojshme. Ai poashtu spjegonte se arsyeja për këtë transfer të detyrave ishte rezultat i situatës së përmirësuar të sigurisë. Për më tepër, Këshilltari Ligjor spjegonte se në mënyrë që të inkurajonte zhvillimin e SHPK-së, gjatë tri viteve të fundit Policia e UNMIK-ut kishte qenë e angazhuar në ngritjen e profesionalizmit të SHPK-së dhe të siguronte se përbërja e SHPK-së do të reflektonte komunitetet etnike në Kosovë. Sa i përket mungesës së mjeteve të komunikimit në fshatra, ai sugjeronte që t'i dërgohej kërkesë komunave ose Organizatave jo-Qeveritare (OJQ), të cilat ishin të gatshme të siguronin telefona celularë nëpër këto fshatra “nëse kjo konsiderohej si e domosdoshme”.

### **Uzurpimi i paligjshëm i ndërtesës së gjykatës në Deçan**

*Më 24 nëntor 2003, e përditshmja Koha Ditore botoi një artikull lidhur me problemet me të cilat po ballafaqohej Gjykata Komunale në Deçan/Decani, stafi i së cilës ishte i detyruar të punonte në baraka të ndërtuara para tridhjetë viteve, pa siguri dhe rrethojë. Në fillim ndërtesa aktuale e gjykatës ishte përdorur si strehimore për refugjatët serb në vitin 1991. Që nga viti 1999, ajo ishte okupuar ilegalisht nga familje shqiptare kosovare. Sipas këtij artikulli, institucionet ndërkombëtare dhe lokale ishin informuar për këtë problem, por nuk kishin ndërmarrë asgjë për t'a zgjedhur atë.*

**11 shkurt 2004:** Ombudspersoni i dërgoi një letër Drejtorit të Departmentit të Administratës Juridike të UNMIK-ut, duke shprehur brengën e tij se as UNMIK e as autoritetet kompetente publike nuk kishin ndërmarrë hapa efektiv për zgjidhjen e këtij problemi. Ai kërkonte zgjidhje adekuate të problemit, në mënyrë që të sigurohej ambient i përshtatshëm pune për Gjykatën Komunale si the të rithemelohej kontrolli dhe menagjimenti publik i kësaj ndërtese.

**19 mars 2004:** Ombudspersoni pranoi letër nga Drejtori i Departamentit të Administratës Juridike të UNMIK-ut, në të cilën ai theksonte se ai dhe Kryetari i Gjykatës Komunale i kishin dërguar Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut dhe Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore (HPD) disa letra lidhur me këtë çështje. Në këtë letër Drejtori e informonte Ombudspersonin se në vitin 2002 PSSP-ja kishte aprovuar kërkesën e Administratorit Regjional dhe një vendim të Asamblesë Komunale të Deçanit/Decan për të ndërtuar një objekt të ri, por Gjykata Komunale as nuk kishte mjete financiare për të ndërtuar objekt të ri dhe as nuk kishte marrë përgjegjje në kërkesën e saj për ndihmë financiare.

**18 maj 2004:** Ombudspersoni i dërgoi një letër PSSP-së, duke përsëritur brengën e tij për mosreagim ndaj mungesës së kontrollës dhe menagjimentit publik të ndërtesës së lartpërmendur dhe ambientit joadekuat të punës në Gjykatën Komunale të Deçanit/Decan. Më tutje ai përsërste kërkesën e tij për ndërmarrje të një veprimi të shpejtë për të zgjidhur këtë çështje.

**Nuk ka pasur përgjegjje për këtë letër.**

## Përdorimi i paligjshëm i prangave nga policët

*Më 16 qershor 2004, Ombudspersoni pranoi shtatë aplikacione, në të cilat aplikantët ankoheshin, mes tjerash, për arrestime të paligjshme të kryera nga policët e SHPK-së. Me sa duket, me 5 shkurt 2004, policët e SHPK-së kishin ardhur në shtëpinë e aplikantit në Obiliq/Obilic, dhe pa treguar fletëarrestin i kishin arrestuar ata në mënyrë që të siguroheshin se ata do të paraqiteshin në gjyq për shkak të mospagesës së faturave të rrymës elektrike. Në rrugë për në Gjykatën Komunale të Prishtinës, policët i kishin vënë aplikantit prangat, dhe nuk ia kishin hequr ato derisa aplikanti ishte paraqitur para gjykatësit.*

**18 shkurt 2004:** Ombudspersoni i dërgoi një letër Komandantit Rajonal të Policisë së UNMIK-ut, duke shprehur brengosjen e tij për informatën lidhur me bazat ligjore për arrestimin dhe duke kërkuar sqarim rreth përdorimit të prangave. Ai poashtu kërkonte një kopje të fletëarrestit dhe dokumenteve tjera lidhur me rastet e lartpërmendura.

**18 maj 2004:** Ombudspersoni pranoi letër nga Komisari i Policisë së UNMIK-ut, i cili sqaronte se Policia e UNMIK-ut kishte intervenuar në këtë rast në bazë të fletëarrestit të lëshuar nga Gjykata Komunale e Prishtinës, në mënyrë që të siguronte se aplikanti do të paraqitej para gjykatës për shkak të mospagesës së faturave të rrymës. Ai poashtu theksonte se në bazë të rregullave policore dhe për mbrojtje të policisë, të gjithë personave të arrestuar duhet t'u vihen prangat.

**7 qershor 2004:** Ombudspersoni i dërgoi një letër Zëvendës PSSP-së për Polici dhe Drejtësi duke shprehur brengosjen e tij lidhur me përmbajtjen e letrës, të cilën ai e kishte pranuar nga Komisari i Policisë së UNMIK-ut. Ombudspersoni theksonte se praktika e përgjithshme policore për përdorimin e vetvetishëm të prangave, pa marrë parasysh rrethanat e rasteve individuale, nuk dukej të ishte plotësisht në vijë me standardet e të drejtave të njeriut. Ai poashtu informonte Zëvendës PSSP-në se më 18 mars 2004, përfaqësuesi i Institutionit të Ombudspersonit kishte vizituar gjyqtarin përgjegjës në Gjykatën komunale të Prishtinës, i cili kishte spjeguar se ai kishte lëshuar fletëarrestin në mënyrë që të siguronte se personat e lartpërmendur do të paraqiteshin në gjykatë, por se të gjitha fletëarrestimet obligonin policinë që të kryenin arrestimin “pa përdorur forcën”. Më tutje, Ombudspersoni kërkoi intervenim urgjent nga Zëvendës PSSP-ja për Polici dhe Drejtësi.

**28 qershor 2004:** Ombudspersoni pranoi letër nga Zëvendës PSSP-ja për Polici dhe Drejtësi, i cili theksonte se Policia e UNMIK-ut ishte e vetëdijshme për faktin se përdorimi i prangave konsiderohet si “përdorim i forcës”. Përdorimi i prangave rregullohej përmes qëndrimeve rreth “përdorimit të forcës” brenda policisë së UNMIK-ut. Zëvendës PSSP-ja poashtu sqaronte se policia e UNMIK-ut kishte përcaktuar se, përdorimi i prangave në përgjithësi kishte për qëllim garantimin e redukimit të kërcënimit të mundshëm nga ana e të arresuarit dhe minimizimin e mundësisë së ikjes. Sidoqoftë, policia duhet të kishte parasysh rrethanat individuale dhe, për shembull, nuk do të duhej t'i vendoste prangat një gruaje shtatzënë ose personave me duar të lënduara. Në fund, Zëvendës PSSP-ja e siguroi Ombudspersonin se zhvillimi, trajnimi dhe aktivitetet e policisë së UNMIK-ut gjithmonë ishin dhe do të duhej të vazhdonin të ishin të udhëhequra në bazë të standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

## **Mungesa e informatave për hetimet policore rreth vrasjes së 14 njerëzve në Staro Gracko/Grackë e Vjetër në komunën e Lipjanit/Lipljan**

*Më 26 shkurt 2004, Ombudspersoni pranoi një aplikacion, në të cilin aplikanti ankohej për mungesë të informatave rreth hetimeve policore lidhur me vrasjen e 14 njerëzve në fshatin Staro Gracko/Grackë e Vjetër, në komunën e Lipjanit/Lipljan më 23 korrik 1999.*

**27 shkurt 2004:** Ombudspersoni i dërgoi një letër Komisarit të Policisë së UNMIK-ut duke kërkuar informata lidhur me fazën e hetimeve lidhur me këtë rast.

**12 mars 2004:** Ombudspersoni pranoi letër nga Komisioneri i Policisë së UNMIK-ut, në të cilën ai spjegonte se Njësi Qëndror i Hetimeve të Policisë së UNMIK-ut po e hetonte rastin. Më tutje ai informonte Ombudspersonin se hetuesit përgjegjës kishin kontaktuar familjet e viktimave për t'i siguruar ata se Policia e UNMIK-ut ende po e hetonte rastin.

### **Kompensimi për viktimat e krimeve të dhunshme dhe familjeve të tyre**

*Gjatë katër viteve të fundit, institucioni i Ombudspersonit ka pranuar shumë ankesa prej viktimave të krimeve të dhunshme dhe/ose familjeve të tyre. Me sa duket, kërkesat e këtyre personave për përfitime sociale janë refuzuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ngase situata e tyre nuk plotësonte kërkesat e caktuara.*

**1 mars 2004:** Ombudspersoni i dërgoi njëletër PSSP-së dhe Kryeministrit të Kosovës, duke shprehur shqetësimet e tij lidhur me mungesën e mekanizmave për mbrojtjen e viktimave të krimeve të dhunshme. Ombudspersoni theksoi se Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/66 e 21 dhjetorit 2000, sipas së cilës invalidët e luftës dhe të afërmit e atyre që kishin vdekur si rezultat i konfliktit të armatosur në Kosovë mund të marrin beneficione të caktuara, nuk vlen për shumicën e këtyre personave, ngase ajo ofron beneficione të tilla vetëm për incidentet që kishin ndodhur para 20 qershorit 1999. Ombudspersoni sugjeronte përgatitjen e projektligjit për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme në mënyrë që t'u siguronte atyre një asistencë përkatëse.

**Nuk ka pasur përgjegjje për këtë letër.**

**31 mars 2004:** Ombudspersoni i dërgoi një letër PSSP-së dhe Kryeministrit duke përsëritur kërkesën që e kishte bërë në letrat e tij të mëparshme. Për më tepër, pas ngjarjeve të dhunshme të marsit, Ombudspersoni theksoi se poashtu viktimat e këtyre ngjarjeve të fundit duhet të marrin kompensim adekuat për lëndimet dhe dëmet e shkaktuara, si dhe për vdekjen e të afërmeve të tyre.

**Nuk ka pasur përgjegjje për këtë letër.**

### **Publikimi i ligjeve**

**3 mars 2004:** Ombudspersoni i dërgoi njëletër Kryeministrit të Kosovës, duke shprehur shqetësimin e tij për mungesë të kornizës ligjore për publikim zyrtar të ligjeve në Kosovë. Ai e konsideronte këtë mungesë si të papranueshme nga këndvështrimi standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, prandaj kërkonte urgjentisht që të hartohesh një ligj i tillë.

**Nuk ka pasur përgjegjje për këtë letër.**

### **Projektligji për Shëndetin Mental**

**3 mars 2004:** Ombudspersoni i dërgoi një letër Zëvendës PSPP-së për Polici dhe Drejtësi, duke kërkuar prej tij informata lidhur me gjendjen aktuale të procedurës lidhur me projektligjin për trajtim të detyrueshëm të personave që vuajnë nga çrregullime mentale, i cili ishte duke u përgatitur që nga viti 2001.

**16 mars 2004:** Ombudspersoni pranoi letër nga Zëvendës PSPP-ja për Polici dhe Drejtësi, në të cilën ai sqaronte se Projektligji ende ishte duke u diskutuar. Disa ndryshime i ishin bërë projektligjit, i cili ishte ndarë në dy projektligje. Projektligji i parë kishte të bënte me mbrojtjen e personave me çrregullime mentale, derisa Projektligji i dytë kishte të bënte me personat të cilët mbaheshin në Entin për Përkujdesje Sociale në Shtime/Stimlje.

**Deri në datën e këtij Raporti, Parlamenti i Kosovës nuk ka diskutuar apo miratur një ligj të tillë.**

### **Vlefshmëria e dokumenteve të udhëtimit të UNMIK-ut para autoriteteve kompetente në Gjermani**

*Më 29 janar 2004, Ombudspersoni pranoi një peticion të inicuar nga iniciativa e qytetarëve të Kosovës nga Éartburg-u, Gjermani. Peticioni përmbante 18,000 nënshkrime, në të cilin përfaqësuesit e kësaj iniciative shfaqnin shqetësimin e tyre rreth mos vlefshmërisë të dokumenteve të udhëtimit të UNMIK-ut para autoriteteve kompetente në Gjermani, si dhe vështirësitë me të cilat ata ballafaqoheshin gjatë dorëzimit të kërkesave për vazhdimin e lejeqëndrimit në Gjermani.*

**9 mars 2004:** Ombudspersoni i dërgoi një letër Zëvendës PSSP-së për Administratë Civile, duke kërkuar informata lidhur me veprimet që ishin ndërmarrë për të lehtësuar dhe/ose për të krijuar kushte për këta individë për të aplikuar për vazhdimin e qëndrimit të tyre dhe lejet e punës bazuar në dokumentet e udhëtimit të lëshuara nga UNMIK-u.

**25 mars 2004:** Ombudspersoni pranoi letër nga Zëvendës PSSP-ja për Administratë Civile në të cilën, përveç tjerash, Zëvendës PSSP-ja spjegonte se dokumentet e udhëtimit të UNMIK-ut ishin dokumente (sui generis) të llojit të veçantë, të lëshuara me qëllim për të lehtësuar udhëtimin dhe lëvizjen e Kosovarëve. Sidoqoftë, ishin organet kompetente të çdo shteti ato të cilat duhej të vlerësonin dokumentet në lidhje me lejet e qëndrimit. Ai poashtu informonte Ombudspersonin se kishte kërkuar të takohej me Shefin e Zyrës Diplomatike Gjermane dhe me përfaqësuesit e nënshkruesve të peticionit dhe siguronte Ombudspersonin se do të informohej lidhur me rezultatet e këtyre takimeve, si dhe me masat e ndërmarra.

### **Përdorimi i gjuhës serbe në të folur dhe në të shkruar nga autoritete publike në Kosovë**

**12 mars 2004:** Ombudspersoni i dërgoi një letër Kryeministrit të Kosovës, duke ia drejtuar vëmendjen rreth problemeve lidhur me përdorimin publik të gjuhës serbe në të folur dhe në të shkruar në Kosovë. Sipas të gjitha informatave dhe dokumenteve të pranuar, anëtarët e komunitetit Serb pohonin se ishte shkelur e drejta e tyre për përdorim publik të gjuhës serbe në të folur dhe në të shkruar, brenda institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë. Kjo situatë ishte bërë e evidente posaçërisht në Komunën e Pristinës, Novo

Brdo/Novo Bërdës, Lypjanit/Lipljan, Fushë Kosovës/Kosovo Polje, Obiliqit/Obiliç, Kamenicës/Kamenica and Štrpce/Shtërcës, ku banonte një numër i madh i popullates serbe. Korespondenca mes këtyre organeve komunale dhe organeve dhe autoriteteve të ndryshme në Kosovë ishte kryer kryesisht në gjuhën shqipe dhe angleze. Kjo përbënte, mes tjerash, shkelje të Kornizës Kushtetuese. Në këtë letër Ombudspersoni kërkonte urgjentisht nga Kryeministri që të ndërmernte hapa urgjent për të siguruar përdorimin publik të gjuhës serbe, në pajtim me Kornizën Kushtetuese dhe instrumentet ligjore përkatëse.

#### **Nuk ka pasur përgjegjje për këtë letër.**

**7 maj 2004:** Ombudspersoni i dërgoi letrën e dytë Kryeministrit të Kosovës duke shprehur shqetësimin e tij lidhur me vazhdimësinë e situatës së lartëpërmendur. Ombudspersoni përsëriti kërkesat e bëra në letrën e mëparshme, duke nënvizuar mos pranueshmërinë e situatës së tillë, që kufizon komunikimin mes institucioneve të ndryshme në Kosovë.

**27 maj 2004:** Ombudspersoni pranoi përgjegjje, vetëm në gjuhën shqipe nga U.D. e Sekretarit Përhershëm në Zyren e Kryeministrit, e cila spjegonte se Institucionet e Përkoshshme Vetëqeverisëse të Kosovës, si në nivelin qendror, ashtu edhe në atë lokal janë duke bërë respektimin dhe zbatimin e Kornizës Kushtetuese, duke përkthyer të gjitha dokumentet zyrtare në të tri gjuhët zyrtare në Kosovë (shqipe, serbe dhe angleze) sa here që njësitë e përkthimit kanë qenë në dispozicion. Ajo në veçanti spjegonte se kur është fjala për Qeverinë dhe Parlamentin e Kosovës komunikimi bëhej në të tri gjuhët zyrtare, dhe se kuvendet komunale kishin angazhuar përkthyes ose kishin themeluar njësi për përkthim në mënyrë që të respektohet Korniza Kushtetuese dhe dispozitat e tjera relevante.

**4 qershor 2004:** Ombudspersoni i dërgoi një letër U.D. në Zyren e Kryeministrit, në të cilën ai e përkujtonte atë që të dërgonte verzionin serb të letrës së saj të 27 majit 2004, duke theksuar se gjuha serbe ishte gjuhë zyrtare në Kosovë. Edhe njëherë ai përmendi se përdorimi i gjuhës serbe nga autoritetet publike në Kosovë ishte pikërisht objekt i hetimeve të Ombudspersonit në këtë kontekst.

#### **Nuk ka pasur përgjegjje për këtë letër.**

### **Projektligji kundër Diskriminimit**

**15 mars 2004:** Ombudspersoni i dërgoi letër Kryetarit të Kuvendit të Kosovës me të cilën i shprehte shqetësimin e tij në lidhje me disa dispozita të caktuara të Projektligjit kundër Diskriminimit rreth themelimit të një Qendre për Trajtim të Barabartë. Ombudspersoni e mirëpriti idenë e themelimit të një qendre të tillë e cila do të garantonte mbrojtje efektive kundër diskriminimit, por në të njejtën kohë ai theksoi se kompetencat e kësaj qendre nuk duhet të ndërhyjnë në juridiksionin e Ombudspersonit. Sipas Ombudspersonit, kompetencat e kësaj qendre ishin shumë të ngjashme dhe më të mëdha se ato të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë. Veç kësaj, Ombudspersoni vërejti se dhënia e kompetencave të tilla qendres së lartëpërmendur do të krijonte konfuzion për publikun dhe nuk do të ishin shumë të dobishme për qëllimin e promovimit dhe mbrojtjes të të drejtave të njeriut në Kosovë.

#### **Nuk ka pasur përgjegjje në këtë letër**



## Dëbimi me forcë i familjeve nga Mitrovica veriore më 21 mars 2004

*Pas trazirave të dhunshme të marsit 2004, zyra e Ombudspersonit në Mitrovicë pranoi shumë ankesa nga familjet shqiptare, të cilat ishin dëbuar me forcë nga shtëpitë e tyre në Mitrovicën Veriore nga grupe njerëzish të maskuar dhe njerëz tjerë që iu kishin bashkangjitur këtyre grupeve.*

**26 mars 2004:** Ombudspersoni i dërgoi një faks urgjent komandantit të Stacionit Verior të Mitrovicës, duke shprehur brengosjen e tij lidhur me situatën e lartpërmendur, dhe duke kërkuar masa adekuate dhe reagim në kohë nga autoritetet kompetente, në rend të parë nga policia e UNMIK-ut.

**30 mars 2004:** Ombudspersoni pranoi letër nga Shefi i Zyres së UNMIK-ut dhe Zyrtari i Përgjithshëm i Administratës, në të cilën, mes tjerash, ai e informonte Ombudspersonin se një Ekip i Mirëqenies Sociale, i përbërë nga stafi vendor dhe policisë përcjellëse të UNMIK-ut kishin vizituar shtëpitë e viktimave të dëbimeve të lartpërmendura, por nuk kishin gjetur ndonjë uzurpues të paligjshëm, përveç një rasti. Më tutje, ai e informonte Ombudspersonin se Drejtorati për çështje Pronësore dhe Banesore (HPD) do të zhvillojë hetime në mënyrë që të konstatohet se mos ishin shkelur të drejtat pronësore.

**2 prill 2004:** Ombudspersoni i dërgoi një letër Komisarit të Policisë së UNMIK-ut, duke i tërhequr vëmendjen rreth gjetjeve të Ekipit për Mirëqenie Sociale. Ombudspersoni informoi Komisarin e Policisë së UNMIK-ut se, pas takimit me ankuesit, dhe në bazë të provave të cilat ata i kishin dorëzuar, ai kishte arritur në konkluzion se personat e lartpërmendur ishin dëbuar me forcë nga shtëpitë e tyre. Në letrën e tij Ombudspersoni kërkonte që ky problem të zgjidhej me kohë.

**31 maj 2004:** Ombudspersoni pranoi letër nga Komisari i Policisë së UNMIK-ut, në të cilën ai spjegonte se rasti i lartpërmendur ishte hetuar. Ai poashtu spjegonte se HPD-ja kishte pranuar të administronte të gjitha pronat në fjalë në mënyrë që të mbronte të drejtat pronësore derisa të vërtetohej pronësia e këtyre pronave, dhe se policia e UNMIK-ut kishte zhvilluar hetime pas raportimeve për kërcënim dhe sulme fizike, verbale dhe psikologjike të personave në fjalë. Komisari i Policisë së UNMIK-ut theksonte se kthimi i sigurtë i banorëve të ligjshëm, si dhe identifikimi dhe ndjekja e personave për të cilët thuhej të kishin marrë pjesë në aktivitete kriminale, ishin objektivat e Policisë së UNMIK-ut.

## Interpretimi i nenit 180 të Ligjit të RSFJ-së mbi Detyrimet

*Pas dhunës që ndodhi në Kosovë në mars 2004, Institucioni i Ombudspersonit filloi hetimet rreth mundësisë për kompenzim për personat të cilët ishin vrarë ose plagosur aksidentalisht gjatë këtyre demonstratave të dhunshme.*

**2 prill 2004:** Ombudspersoni i dërgoi një letër PSSP-së duke e përkujtuar lidhur me përmbajtjen e Nenit 180 të Ligjit Jugosllav për Obligime. Ombudspersoni konkludoi se neni i lartpërmendur përfshinte përgjegjësinë shtetërore në rast se personat lëndoheshin ose vriteshin gjatë akteve terroriste, demonstratave të dhunshme ose manifestimeve publike. Ombudspersoni kërkonte nga PSSP-ja informata lidhur me procedurat të cilat duhet t'i ndjekin personat të cilët do të kompenzoheshin në mënyrë që ata të mund të gëzonin këtë të drejtë.

**21 prill 2004:** Ombudspersoni pranoi letër nga PSSP-ja, i cili nuk pajtohej me interpretimin e Ombudspersonit lidhur me dispozitën e lartpërmendur. Sipas PSSP-së, Neni 180 nuk obligonte autoritetet publike të mbanin përgjegjësi të përgjithshme për humbjen dhe dëmet

e shkaktuar me rastin e vdekjes ose lëndimeve trupore të shkaktuara përmes akteve të dhunës dhe terrorit gjatë demonstratave. Sipas interpretimit të PSSP-së, autoritetet publike ishin përgjegjëse vetëm nëse në bazë të ligjit në forcë ata kishin për obligim të parandalonin humbje dhe dëme të tilla, dhe ata nuk kishin arritur t'i parandalonin ato. Ata nuk mund të mbaheshin përgjegjës nëse kishin vepruar sipas ligjit. Ai poashtu theksonte se sipas Nenit 181 të ligjit të lartëpërmendur, organizuesi i demonstratave të mëdha duhej të mbahej përgjegjës për humbjet, dëmet dhe lëndimet e shkaktuara gjatë rrethanave të jashtëzakonshme të krijuara në një situatë të tillë.

**23 prill 2004:** Ombudspersoni i dërgoi një letër PSSP-së, duke përsëritur kërkesën e letrës së tij të mëparshme dhe duke ia bashkangjitur një kopje të një citati nga komenti “Komentari Zakona o Obligationim Odnosima” në serbisht, i cili përmbante interpretimet e Nenit 180 dhe 181 të ligjit të lartëpërmendur. Sipas interpretimeve, autoritetet publike ishin përgjegjëse për dëmet dhe lëndimet e shkaktuara gjatë demonstratave të dhunshme, derisa organizatorët e demonstratave të mos identifikohen.

**Nuk ka pasur përgjegjje për këtë letër.**

### **Pensionet për njerëzit që jetojnë në Kosovë**

*Që nga themelimi i Institutionit të Ombudspersonit të Kosovës më 2000, Ombudspersoni ka pranuar shumë ankesa nga individë, të cilët pohojnë se nuk kishin pranuar pensione nga Fondi i Pensioneve i Serbisë.*

**prill-qershor 2004:** Ombudspersoni i dërgoi disa letra Ministrisë Serbe të Punëve, Punësimi dhe Çështjeve Sociale, duke kërkuar prej tij që të gjente zgjidhje adekuate për këtë çështje.

**30 qershor 2004:** Ombudspersoni pranoi letër nga Ministri Serb i Punëve, Punësimi dhe Çështjeve Sociale, në të cilën ai sqaronte se personat që jetonin në territorin e Kosovës nuk mund të merrnin pensione nga Fondi Serb i Pensioneve, pasi që banorët e kësaj krahine nuk i kishin kontribuar këtij fondi. Ai bëri të ditur se më 2001, UNMIK-u, pa u konsultuar paraprakisht me organet kompetente të Republikës së Serbisë, kishte miratuar Regullën 2001/35 për Pensionet në Kosovë. Kjo rregullore paraqiste sistemin e ri të sigurimeve pensionale në Kosovë, i cili ishte i ndryshëm nga sistemi i pensioneve në Serbi. Në fakt, sistemi i pensioneve i Republikës së Serbisë bazohej në solidaritetin mes gjeneratave. Nëse punëtorët nuk kanë përmbushur obligimet e tyre ndaj këtij fondi, nuk kishte mundësi që ata të merrnin pensione, pa marrë parasysh kohën se kur u ishte njohur e drejta e tyre për pension.

### **Kosovarët që humbën shtëpitë e tyre në Mitrovicën e veriut pas vitit 1999**

*Që nga themelimi i Institutionit të Ombudspersonit në Kosovë në vitin 2000, një numër i madh Kosovarësh, të cilët më parë kishin jetuar në pjesën veriore të Mitrovicës dhe që kishin humbur shtëpitë e tyre pas vitit 1999, i janë drejtuar Ombudspersonit duke u ankuar se autoritetet kompetente ende nuk kishin gjetur zgjidhje për problemin e tyre. Këta persona ishin duke jetuar në kushte jashtëzakonisht të vështira dhe pa strehim.*

**4 maj 2004:** Ombudspersoni i dërgoi një letër Kryeministrit të Kosovës me të cilën ia drejtonte vëmendjen ndaj situatës së lartëpërmendur si dhe vështërsive të tjera me të cilat ballafaqoheshin këta njerëz, siç është furnizim i pamjaftueshëm me energji elektrike dhe ujë. Gjithashtu, Ombudspersoni vërejti se shumica e këtyre familjeve të cilat kishin gjetur

zgidhje të përkohshme nuk kishin marrë kurrfarë ndihme financiare nga autoritetet publike. Gjithashtu, ata nuk kanë mundur të aplikojnë për strehim të përkohshëm pranë HPD-së, sepse, që nga ky vit HPD-ja ka ndryshuar politikën e saj dhe nuk ofron më përkrahje humanitare apo strehim. Në këtë letër, Ombudspersoni propozoi që qeveria e Kosovës të formojë një fond special për të përkrahur këto familje dhe duke pasur parasysh situatën e ndërlikuar politike dhe ekonomike propozoi që qeveria ta shqyrtojë mundësinë që këtyre njerëzve të u reduktohen pagesat për shërbime publike ose të lirohen nga tërësisht nga këto pagesa. Veç kësaj, Ombudspersoni kërkoi nga Kryeministri që ta informojë për çfarëdo hapa që planifikon të ndërmerret për të përmirësuar kushtet jetësore të këtyre familjeve.

**Nuk ka pasur përgjegjje për këtë letër.**

#### **Personat e zhvendosur brenda vendit në Serbi**

**5 maj 2004:** Ombudspersoni i dërgoi letër Kryeministrit të Republikës së Serbisë në mënyrë që të drejtojë vëmendjen e tij ndaj situatës të personave të zhvendosur brenda vendit nga Kosova të cilët janë duke qëndruar në Serbi. Këta njerëz, të cilët për gati pesë vite ishin duke jetuar në kushte varfërie pa marrë kurrfarë ndihme të nevojshme nga qeveria e Serbisë, nuk gëzonin statusin e refugjatit sepse nuk ishin refugjatë nga vendet e huaja. Ombudspersoni kërkoi nga Kryeministri që të gjejë një zgjidhje të përshtatshme për situatën e këtyre njerëzve në mënyrë që atyre tu garantohen së paku disa nga të drejtat dhe përfitimet të cilat i gëzojnë refugjatët. Gjithashtu, Ombudspersoni theksoi rëndësinë që këtyre njerëzve tu jipet e drejta, si qytetarë të Serbisë dhe Malit të Zi, që të zgjedhin nëse dëshirojnë të kthehen në Kosovë apo të ndërtojnë një jetë të re në Serbi.

**Nuk ka pasur përgjegjje për këtë letër.**

#### **Lejet e përkohshme të qëndrimit për të huajt**

*Më 27 mars 2004, Ombudspersoni pranoi ankesë nga një qytetar i Shqipërisë, i cili kishte punuar në Prishtinë rreth dy vite e gjysmë. Për qëllime imigrimi, nga ai ishte kërkuar që të siguronte një vërtetim të policisë për kohën që ai kishte qëndruar në Kosovë. Aplikanti pohonte se, për të marrë këtë vërtetim i ishte drejtuar pothuajse të gjitha institucioneve të Kosovës, përfshirë Zyrën Qëndrore të Policisë në Prishtinë, Gjykatën Komunale të Prishtinës, dhe Gjykatën Supreme të Kosovës, duke kërkuar këshilla për zgjidhjen e këtij problemi. Asnjë nga këto organe nuk i kishte dhënë përgjegjje lidhur me këtë çështje.*

**4 maj 2004:** Ombudspersoni i dërgoi një letër Kryesuesit të Regjistrimit Civil të UNMIK-ut, duke shprehur shqetësimin e tij lidhur me situatën e lartpërmendur dhe duke kërkuar informata se cilat autoritete ishin përgjegjëse për kërkesat në lidhje me leje të përkohshme qëndrimi në Kosovë.

**17 maj 2004:** Ombudspersoni pranoi letër nga Kryesuesi i Regjistrimit Civil të UNMIK-ut, në të cilën ky i fundit e informonte Ombudspersonin se nuk është lëshuar asnjë leje qëndrimi për të huajt në Kosovë që kur UNMIK-u ka filluar të administrojë Kosovën. Më tutje, ai informonte Ombudspersonin se UNMIK-u kishte kërkuar mendimin e Këshilltarit Ligjor të UNMIK-ut rreth aplikueshmërisë së Ligjit Jugosllav për Lëvizje dhe Qëndrim të Huajve të vitit 1980, si dhe rreth autoriteteve përgjegjëse për implementimin e tij.

**16 qershor 2004:** Ombudspersoni pranoi letër nga Shefi i Regjistrimit Civil të UNMIK-ut, me të cilën ky i fundit e informonte Ombudspersonin se UNMIK-u nuk lëshon leje qëndrimi për të huajt. Kryesuesi i Regjistrimit Civil të UNMIK-ut poashtu kishte sqaruar se zyrja ishte duke përgatitur legjislacionin, në bazë të të cilit nga qytetarët e huajt do të kërkohej autorizim për të hyrë dhe qëndruar përkohësisht në Kosovë, sepse sipas interpretimit të Këshilltarit Ligjor të UNMIK-ut, dispozitat e Ligjit Jugosllav për Lëvizje dhe Qëndrim të të Huajve të vitit 1980, lidhur me autorizimin për të huajt, nuk mund të zbatoheshin në mënyrë të vetvetishme në Kosovë.

### **Refugjatët romë nga Kosova të cilët janë duke qëndruar ne IRJM**

**6 maj 2004:** Ombudspersoni i dërgoi një letër Kryeministrit të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë (IRJM) me të cilën ia drejtonte vënendjen ndaj situatës së refugjatëve romë nga Kosova të cilët po qëndronin në IRJM. Ombudspersoni vërejti se, pas mbylljes së kampit “Shuto Orizari” në maj 2003, i cili ishte kampi më i madh në IRJM, refugjatët e këtij kampi u lanë të gjinden si të mundën, pa kurfarrë mbështetje nga qeveria apo organizatat humanitare ndërkombëtare. Ai gjithashtu vërejti se nuk kishte pasur orvajtje të mëtijshme për të përmirësuar gjendjen ligjore, ekonomike dhe sociale të refugjatëve romë të cilët jetonin në IRJM. Gjithashtu, Ombudspersoni theksoi se pas sulmeve të dhunshme të fundit kundër minoriteteve etnike në Kosovë ishte bërë e pamundur të thuhet se për sa kohë situata e krijuar do ti ndalojë këta refugjatë të kthehen në shtëpitë e tyre. Për arësyet e mësipërme, Ombudspersoni kërkoi nga Kryeministri që të gjejë një zgjidhje për këta persona, qoftë në bashkpunim me organizatat humanitare në IRJM apo përmes bisedimeve me shtete të treta.

**Nuk ka pasur përgjegjje në këtë letër.**

### **Pamundësia e nxënësve serbë të ndjekin mësimet në gjuhën e tyre për shkak të mungesës së transportit**

**6 maj 2004:** Ombudspersoni i dërgoi faks urgent PSSP-së duke shprehur brengosjen e tij lidhur me situatën e disa nxënësve Serb nga Prishtina, të cilët ndiqnin mësimet në Gracanica/Graçanicë dhe fshatrat tjera përreth, dhe të cilët nuk mund t’i ndiqnin mësimet për shkak të mungesës së transportit. Ombudspersoni theksoi se pas ngjarjeve të dhunshme të marsit, këtyre nxënësve, që jetonin në ndërtesat e YU Programit në Prishtinë, iu ishte premtuar përcjellje dhe transport në mënyrë që të mund të ndiqnin mësimet në fshatrat përreth të banuara me Serb. Ombudspersoni kërkoi nga PSSP-ja që transporti i domosdoshëm për këta fëmijë të sigurohej me kohë, në mënyrë që këtyre fëmijëve, të cilët për shkaqe sigurie po jetonin prapa telave me gjemba dhe kishin nevojë të mbroheshin pandërprerë nga ushtarët e KFOR-it dhe policia ndërkombëtare dhe ajo lokale, t’u sigurohej e drejta elementare, siç është edukimi.

**17 maj 2004:** Ombudspersoni pranoi përgjegjje nga Zëvendës PSSP-ja për Kthim dhe Komunitete, duke spjeguar se pas ngjarjeve të dhunshme të marsit 2004, vozitësi i cili më parë i kishte transportuar këta fëmijë në shkollë tani refuzonte të bënte këtë. Ajo theksonte se zyrja e saj kishte kontaktuar Drejtoratin për Edukim në Komunën e Prishtinës, duke kërkuar që të siguronte një shofer të ri, i cili do t’i transportonte këta nxënës në shkollë deri në fund të vitit shkollor, përcjellur nga SHPK-ja nga Gracanica/ Graçanica.

## Projektligji për Trashëgiminë Kulturore në Kosovë

**7 maj 2004:** Ombudspersoni i dërgoi letër Kryeministrit të Kosovës me të cilën ia drejtonte vëmendjen në mungesën e një ligji për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, historike dhe natyrore në Kosovë. Në letrën e tij, Ombudspersoni theksoi rëndësinë e miratimit të një ligji të tillë, pas shkatërimit të manastireve dhe kishave në tërë Kosovën gjatë ngjarjeve të dhunshme të marsit 2004 në Kosovë. Përveç kësaj, sipas Ombudspersonit, miratimi i një ligji për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore do të siguronte që kulturës dhe identitetit të përbashkët të Kosovës ti kushtohet rëndësia e merituar.

**27 maj 2004:** Ombudspersoni pranoi një letër nga Këshilltari Ligjorë i Sekretarit të Përhershëm në zyrën e Kryeministrit. Në emër të U.D. të Sekretarit të Përhershëm, Këshilltari Ligjor, veç tjerash, e informoi Ombudspersonin se në planin legjislativ të qeverisë së Kosovës për periudhën tetor 2003 – tetor 2004 është i përfshirë edhe projektligji për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore. Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit kishte hartuar draftin e këtij Ligji, i cili ishte duke u shqyrtuar nga grupi punues në nivel qeveritar.

### **Qasja adekuate në shkollën në gjuhën serbe në fshatin Crkvena Vodica/Caravadicë për nxënësit serbë**

*Më 7 maj 2004, gjatë takimit me Ombudspersonin, disa përfaqësues të komunitetit serbë ngritën çështjen e qasjes adekuate në shkollën e fshatit Crkvena Vodica/Caravadicë. Me sa duket, fëmijët e familjeve serbe që jetonin në rajonin rreth këtij fshati dëshironin t'i ndiqnin mësimet në shkollën e lartëpërmendur, e cila ofronte mësim në gjuhën serbe në paradite dhe mësim në gjuhën shqipe pasdite. Sipas ankuesit, nuk kishte përcjellje të KFOR-it që do të mund të shoqëronte këta fëmijë deri në shkollë dhe situata e sigurisë nuk i lejonte ata që të ndiqnin mësimet atje pa pasur përcjellje.*

**10 maj 2004:** Ombudspersoni i dërgoi një letër Zëvendës Drejtorit të Zyrës së UNMIK-ut për Kthim dhe Komunitete, duke shprehur shqetësimin e tij për situatën e lartëpërmendur. Ombudspersoni theksoi se për shkaqe sigurie, posaçërisht pas trazirave të marsit, serbët të cilët jetonin në Kosovë kishin nevojë për mbrojtje më të mirë nga ana e ushtarëve të KFOR-it dhe policisë ndërkombëtare dhe lokale. Ombudspersoni kërkoi nga Zëvendës Drejtori i Zyrës së UNMIK-ut për Kthim dhe Komunitete që ta informonte atë për çdo hap të ndërmarrë për të zgjidhur këtë problem, në mënyrë që të sigurohet që së paku disa nevoja themelore, siç është edukimi i fëmijëve serbë, të jenë të garantuara përmes të gjitha mjeteve në dispozicion të UNMIK-ut dhe KFOR-it.

**17 maj 2004:** Ombudspersoni pranoi përgjegjje nga Zëvendës Drejtori i Zyrës së UNMIK-ut për Kthim dhe Komunitete, me të cilën e informonte atë se zyrja e saj kishte shqyrtuar nevojën për transport me përcjellje për këta fëmijë dhe se do t'a informonte Ombudspersonin për rezultatet e mëtutjeshme.

### **Problemi i kthimit të refugjatëve romë, ashkali, dhe egjiptian**

**18 maj 2004:** Pas informatave se disa shtete të caktuara Evropiane, përfshirë Belgjikën, Danimarkën, Gjermaninë, Norvegjinë, Suedinë dhe Holandën, kishin në plan që të kthenin së shpejti refugjatët rom, ashkali, dhe egjiptian në Kosovë, Ombudspersoni i dërgoi letër ministrive kompetente të shteteve të lartëpërmendura. Sipas Ombudspersonit, situata e minoriteteve etnike në Kosovë së fundi ishte keqësuar dhe as UNMIK-u e as policia nuk

kishin qenë në gjendje të garantonin sigurinë adekuate për këta persona. Kjo u demonstrua efektivisht në trazirat që ndodhën në mars 17 – 20 2004, kur turma e zemëruar dhe e dhunshme kishte organizuar sulme jo vetëm kundër anëtarëve të komunitetit serb, por edhe personave të komunitetit jo-shqipar. Situata e sigurisë ishte aq e rëndë sa që këta njerëz nuk ishin në gjendje të lëviznin rreth Kosovës pa përcjellje. Në këtë letër, Ombudspersoni paralajmëroi se, duke marrë parasysh ngjarjet e fundit të dhunshme në Kosovë, kthimi i këtyre personave në Kosovë në këtë fazë do të ishte rrezik për jetërat dhe sigurinë e tyre dhe nuk do të ishte në pajtim me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

**18 maj 2004:** Në mënyrë që të tërhiqte vëmendjen e bashkësisë ndërkombëtare lidhur me situatën e lartpërmendur, Ombudspersoni i dërgoi kopje të letrës së lartpërmendur Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, Sekretarit të Përgjithshëm të OSBE-së, Përfaqësuesit të Lartë të BE-së për Politikë të Jashmte dhe Siguri, Kryetarit të Parlamentit Evropian, Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, Kryetarit të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, Komisionerit për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Evropës, Komisionerit të Lartë të KB për Refugjatë, U.D. të Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut, Kryetarit të Komitetit për Çështje Ligjore dhe të Drejta të Njeriut të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, Sekretarit të Përgjithshëm të Storting-ut të Gjermanisë, Kryetarit të Folketing-ut të Danimarkës, Kryetarit të Dhomës Parlamentare të Holandës, Kryetarit të Dhomës së Përfaqësuesve të Parlamentit Federal të Belgjikës, Kryetarit të Riksdag-ut të Suedisë, Kryetarit të Bundestagut të Gjermanisë, PSSP-së – UNMIK-ut, Kryeministrit të Kosovës, Përfaqësuesit Personal në Prishtinë të Përfaqësuesit të Lartë të BE-së për CFSP, Kryetarit të Komitetit për Çështje Ligjore dhe të Drejta të Njeriut të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, Drejtorit Ekzekutiv të Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Kryetarit të Bordit të Drejtorëve të Qendrës Evropiane për të Drejtat e Romëve.

**1 qershor 2004:** Ombudspersoni pranoi letër nga Kryetari i Dhomës së Përfaqësuesve të Parlamentit Federal të Belgjikës, me të cilën e informoi Ombudspersonin se i kishte shkruar Ministrit të Brendshëm të Belgjikës, duke theksuar brengosjen e Ombudspersonit për komunitetin ashkali, egjiptian dhe rom.

**15 qershor 2004:** Ombudspersoni pranoi letër në emër të Kryetarit të Riksdag-ut Suedez, duke spjeguar se letra e Ombudspersonit e datës 18 maj 2004 i ishte dërguar partive politike të përfaqësuar në Riksdag, Komitetit për Siguri Sociale, që mirrej me çështjet e azilit dhe migrimit, si dhe Komitetit për Çështje të Jashtme.

**15 qershor 2004:** Ombudspersoni pranoi letër nga Sekretari të Komitetit për Imigrim dhe Integrim në Danimarkë, i cili në emër të Kryetarit të Folketing-ut të Danimarkës, informonte Ombudspersonin se letra e tij e 18 majit 2004 iu ishte shpërndarë anëtarëve dhe zëvendësve të Komitetit për Integrim të Folketing-ut.

**25 qershor 2004:** Ombudspersoni pranoi letër nga Sekretari Përgjithshëm i Këshillit të Evropës, i cili e informonte atë se Këshilli i Evropës po punonte në mënyrë aktive për të siguruar se të gjitha të drejtat njerëzore të të kthyerve të jenë të mbrojtura. Në fakt, Asambleja Parlamentare e Këshillit miratoi Rekomandimin (PACE R. 1633 (2003)), në të cilin, mes tjerash, theksohej se Shtetet Anëtare të Këshillit të Evropës duhet të sigurojnë se Romët nga Kosova nuk do të ktheheshin me forcë as në Kosovë e as në Serbi e Mal të Zi, derisa situata e sigurisë të lejonte një gjë të tillë. Ai poashtu sqaronte se Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës kishte paralajmëruar Shtetet Anëtare se siguria për romët në Kosovë nuk mund të garantohej, dhe se një ekspert i komitetit ishte duke e përgatitur Draft Kodin e Mirësjelljes për Procedurat e Dëbimit.

## **Personat e zhvendosur brenda vendit në Mal të Zi**

**19 maj 2004:** Ombudspersoni i dërgoi letër Kryeministrit të Republikës së Sërbisë në mënyrë që të drejtojë vëmendjen e tij ndaj situatës të personave të zhvendosur brenda vendit nga Kosova të cilët janë duke qëndruar në Mal të Zi. Këta njerëz, të cilët për gati pesë vite ishin duke jetuar në kushte varfërie pa marrë kurrfarë ndihme të nevojshme nga qeveria e Malit të Zi, nuk gëzonin statusin e refugjatit sepse nuk ishin refugjatë nga vendet e huaja. Ombudspersoni kërkoi nga Kryeministri që të gjejë një zgjidhje të përshtatshme për situatën e këtyre njerëzve në mënyrë që atyre tu garantohen së paku disa nga të drejtat dhe përfitime të cilat i gëzojnë refugjatët. Gjithashtu, Ombudspersoni theksoi rëndësinë që këtyre njerëzve tu jipet e drejta, si qytetarë të Sërbisë dhe Malit të Zi, që të zgjedhin nëse dëshirojnë të kthehen në Kosovë apo të ndërtojnë një jetë të re në Mal të Zi.

**Nuk ka pasur përgjegjje për këtë letër.**

### **Mungesa e publikimit të instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut**

**19 maj 2004:** Ombudspersoni i dërgoi një letër Kryeministrit të Kosovës, në mënyrë që të drejtojë vëmendjen e tij ndaj faktit që deri më atë datë ende nuk ishin publikuar instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, për rrjedhim popullata e Kosovës nuk kishte qasje në këto instrumente. Ombudspersoni vërejti se organet kompetente ndërkombëtare dhe vendore nuk kishin ndërmarrë asnjë veprim për të siguruar që këto instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të cilat në pajtim me kapitullin 3.3 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme të Kosovës ishin të aplikueshme në mënyrë të drejtëpërdrejtë në Kosovë, të publikohen dhe tu ofrohen qytetarëve të Kosovës në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Sipas Ombudspersonit, dështimi i organeve publike për të ndërmarrë veprime në këtë drejtim ka parandaluar banorët e Kosovës që të marrin njohuri të mjaftueshme në lidhje me të drejtat e tyre të njeriut si dhe për instrumentet ligjore të cilat mund të kishin shfrytëzuar për të mbrojtur të drejtat e tyre të njeriut. Në këtë letër, Ombudspersoni kërkoi që instrumentet e lartpërmendura ndërkombëtare të publikohen dhe shpërndahen zyrtarisht dhe në mënyrë urgjente, që do të përbënte një hap themelorë drejtë përmirësimit aq të nevojshëm të mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë.

**Nuk ka pasur përgjegjje për këtë letër.**

### **Mundësia e të burgosurve për të marrë pjesë në zgjedhjet parlamentare në Kosovë në tetor të vitit 2004**

**21 maj 2004:** Ombudspersoni i dërgoi një letër Kryeshefit Ekzekutiv të Komisionit Qëndror Zgjedhor, në të cilën kishte ngritur çështjen që të burgosurit të kenë mundësi të marrin pjesë në zgjedhjet e ardhshme parlamentare në Kosovë që do të mbahen në tetor 2004. Duke i theksuar kushtet jetësore të këtyre personave, të cilët ishin të privuar nga e drejta e lirisë së lëvizjes, Ombudspersoni kishte kërkuar informata mbi procedurën të cilën Komisioni Qëndror Zgjedhor kishte ndërmend të aplikonte për të siguruar që të gjithë të burgosurit në Kosovë të kenë mundësinë për të shfrytëzuar të drejtën e tyre për të votuar. Në të njëjtën letër, përveç kësaj, Ombudspersoni kërkoi informata në lidhje me përpjekjet

që ishin bërë gjatë zgjedhjeve të përgjithshme të mëparshme apo zgjedhjeve komunale për të mbrojtur të drejtën e të burgosurve për të votuar.

**2 qershor 2004:** Ombudspersoni pranoi një letër nga Kryeshefi Ekzekutiv i Komisionit Qëndror Zgjedhor, përmes së cilës e informonte Ombudspersonin se pas publikimit të Rregullave Zgjedhore, Komisioni Qëndror Zgjedhor do ti ofroj informata të reja Ombudspersonit rreth mënyrave se si do të votojnë të burgosurit në tërë Kosovën.

### **Fëmijët e grave të veja të luftës**

*Më 21 maj 2004, një aktivist i OJQ-së “Lift Kosovo” ka paraqitur një ankesë pranë Institucionit të Ombudspersonit. Gjatë disa viteve të fundit, OJQ-ja në fjalë kishte organizuar udhëtime verore në bregdetin e Shqipërisë për fëmijët e grave të veja të luftës të cilët jetojnë në fshatin Krushë e Madhe, në rajonin e Gjakovës. Megjithatë, gjatë këtij viti, policia kufitare e UNMIK-ut nuk i kishte lejuar fëmijët të kalojnë në territorin e Shqipërisë pa dokumentet e nevojshme të UNMIK-ut për udhëtim. Për shkak të situatës së tyre të vështirë ekonomike, nënat e këtyre fëmijëve, të cilat duhet të jetojnë nga ndihmat mujore sociale prej 60 eurosh, nuk ishin në gjendje të paguajnë taksat e domosdoshme të shërbimit në mënyrë që të marrin dokumentet e lartpërmendura për udhëtim.*

**24 maj 2004:** Ombudspersoni i dërgoi një letër Zëvendës PSSP-së për Administratë Civile, me të cilën drejtonte vëmendjen e Zëvendësit të PSSP-së ndaj situatës të këtyre fëmijëve dhe kërkonte që këta fëmijë të lirohen nga pagesa e shërbimeve për dokumentet e udhëtimit.

**2 qershor 2004:** Ombudspersoni pranoi një letër nga Zëvendës PSSP-ja për Administratë Civile sipas të cilës ai i kishte pranuar dhe akorduar që këta fëmijë dhe familjet e tyre të lirohen nga pagesa e shërbimeve të lartpërmendura.

### **Mundësia e gjetjes së vaksinës BCG në repartet e maternitetit në Kosovë**

*Më 15 maj 2004, gazeta e përditshme Kosovare “Koha Ditore” kishte publikuar një artikull në lidhje me mungesën e vaksinës BCG në repartet e maternitetit në Kosovë si dhe shitjes të paligjshme të kësaj vaksine në disa barnatore. Sipas kësaj gazete, Ministria e Shëndetësisë nuk i kishte furnizuar repartet e maternitetit në spitalet publike me vaksinën BCG, deri sa, në të njëjtën kohë vaksinë dukej që kjo vaksinë mund të blehej në mënyrë të paligjshme në disa barnatore në Kosovë pa kaluar testin paraprak mjekësorë, i cili, sipas Institutit të Shëndetësisë në Kosovë është i detyrueshëm para se kjo vaksinë t’u jipet fëmijëve.*

**24 maj 2004:** Ombudspersoni i dërgoi letër Ministrin për Shëndetësi, në të cilën shprehte shqetësimin e tij se deri në atë kohë, as Ministria e Shëndetësisë e as autoritetet kompetente publike nuk kishin ndërmarrë kurfarë hapa efektiv për të gjetur zgjidhje për këtë çështje. Ombudspersoni kërkoi informata nga Ministria e Shëndetësisë për hapat që kjo ministri kishte ndërmend të merrte për të zgjidhur këtë problem.

**27 maj 2004:** Ombudspersoni pranoi një letër nga Ministri për Shëndetësi, në të cilën kjo e fundit theksonte se nga Shqipëria ishin siguruar doza të mjaftueshme të kësaj vaksine të cilat ishin shpërndarë në repartet e maternitetit në Kosovë, në mënyrë që të sigurohet vaksinimi për katër muajt e parë të vitit 2004. Deri sa ishte e vërtetë se në fillim të vitit 2004 kishte periudha kohore kur Ministria e Shëndetësisë nuk kishte doza të mjaftueshme



të kësaj vaksine, ky problem u zgjidh në maj 2004, kur Ministria u furnizua me doza të mjaftueshme për vitin 2004 dhe fillimin e vitit 2005. Ministri i Shëndetësisë theksoi se nuk kishte pasur njohuri rreth shitjes së paligjshme të vaksinës BCG në barnatoret në Kosovë dhe se pas njohjes së këtij fakti, Ministria për Shëndetësi kishte nxitur prindërit që mos ti vaksinonjë fëmijët e tyre me vaksinat që shiteshin në barnatoret private. Në të njëjtën kohë, vakcina BCG e cila u jipej foshnjeve gjatë vitit të parë të jetës nuk duhet të kalonte në teste speciale paraprake.

### **Peticioni i ashkalive pas ngjarjeve të marsit 2004**

**26 maj 2004:** Ombudspersoni ia dërgoi PSSP-së petitionin e nënshkruar nga familjet e komunitetit ashkali, që jetonin në Vushtrri/Vucitrn. Këta njerëz ishin larguar me forcë nga shtëpitë e tyre gjatë ngjarjeve të marsit nga turma violente e njerëzve, të cilët më vonë kishin djegur shtëpitë e tyre. Tani ata nuk kishin ku të banonin dhe për momentin qëndronin te baza e KFOR-it gjerman në Novosellë. Këta persona konsideronin se situata e sigurisë ishte aq e rëndë sa që ata nuk mund të lëviznin nëpër Kosovë pa përcjellje. Në petitionin dërguar Zëvendës PSSP-së, përfaqësuesit e komunitetit ashkali kërkonin nga ai që të gjente për ta një zgjidhje, e cila do t'u mundësonte atyre që të jetonin jashtë Kosovës, së paku për momentin. Ombudspersoni përkujtoi Zëvendës PSSP-në për urgjencën e kësaj çështjeje dhe kërkoi që të gjindej një zgjidhje për këta persona, në mënyrë që t'u mundësohej jetë e lirë, pa frikë, të mos vuanin nga rreziqet e përditshme, të cilat ata i kishin përjetuar gjatë dhe pas ngjarjeve të marsit.

**12 qershor 2004:** Ombudspersoni pranoi letër nga Zëvendës PSSP-ja, i cili spjegonte se UNMIK ishte i vetëdijshëm për situatën në të cilën gjindej komuniteti ashkali dhe se kishte qenë vazhdimisht i involvuar në shqyrtimin e problemeve të tyre që nga ngjarjet e marsit. Zëvendës PSSP-ja theksonte se në fillim të muajit prill, pas vizitës së Kryeministrit të Kosovës, ishte mbajtur një takim në kampin e KFOR-it francez me përfaqësuesit ashkali, gjatë të cilit zyrtarët e UNMIK-ut kishin pranuar një petition të ngjashëm me atë që e kishte dërguar Ombudspersoni. Zëvendës PSSP-ja poashtu informonte Ombudspersonin se në fund të muajit maj, Zyra për Kthim dhe Komunitete kishte mundësuar një takim në mes të zyreve diplomatike të Britanisë, Francës dhe Suedisë në Prishtinë dhe këshillit ashkali. Zyret diplomatike të lartëpërmendura kishin refuzuar kërkesën për azil për ashkalinjtë në shtetet e tyre. Pas kësaj, Zyra për Kthim dhe Komunitete kishte vizituar rajonin në komunën e Vushtrrisë/Vucitrn, i cili mund të shërbente si strehim i përkohshëm humanitar për ashkalinjtë. Zëvendës PSSP-ja më tutje theksonte se në rend të parë IPVQ-të janë përgjegjëse për plotësimin e nevojave humanitare të këtyre njerëzve dhe kërkonte nga Ombudspersoni t'i shkruante letër Kryeministrit të Kosovës lidhur me situatën e komunitetit ashkali, duke kërkuar nga IPVQ-të që të plotësonin përgjegjësitë e veta në përputhje me Kornizën Kushtetuese, duke ofruar ndihmë humanitare dhe ambient më të sigurt për këtë grup njerëzish.

**17 qershor 2004:** Ombudspersoni i dërgoi një letër Kryeministrit të Kosovës, në të cilën ai e përkujtonte Kryeministrin rreth situatës në të cilën gjindeshin familjet e komunitetit ashkali në Vushtrri/Vucitrn dhe pyeste për hapat që Qeveria e Kosovës planifikonte t'i mirrte për të gjetur zgjidhje për këta persona në mënyrë që ata të mund të kishin një jetë normale.

**Nuk ka pasur përgjegjeje për këtë letër.**

## “Treni i Lëvizjes së Lirë”

*Më 18 maj 2004, linja hekurudhore mes Lipjanit/Lipljan dhe Leshak/Lesak ishte suspenduar, me sa duket për shkak se Agjencia Kosovare e Mirëbesimit dhe Shtylla e UNMIK-ut për Administratë Civile nuk mund të nënshkruanin marrëveshje ngase Ministria e Financave nuk kishte arritur t’i siguronte të gjitha fondet e nevojshme.*

**2 qershor 2004:** Ombudspersoni i dërgoi një letër Zëvendës PSSP-së për Administratë Civile, duke shprehur brengën e tij për pengesën e lartëpërmendur, duke theksuar veqanërisht se ky tren ishte i vetmi mjet për transport publik dhe komunikim mes enklavave serbe në Kosovën qëndrore dhe Mitrovicës Veriore si dhe rajoneve përreth. Ombudspersoni poashtu theksonte rëndësinë e ruajtjes së linjës së lartëpërmendur në mënyrë që të sigurohej liria e lëvizjes për këta persona, duke pasur parasysh se situata e sigurisë në Kosovë iu kufizonte atyre lirinë e lëvizjes.

**7 qershor 2004:** Ombudspersoni pranoi letër nga Shefi i Zyrës për Çështje të Komuniteteve, i cili informonte se linja e lartëpërmendur ishte rivendosur.

**9 qershor 2004:** Ombudspersoni pranoi letër nga Zëvendës PSSP-ja për Administratë Civile, duke spjeguar se Ministria e Ekonomisë dhe Financave (MEF) kishte shpërfillur ndarjen e fondeve për shërbim për buxhetin e këtij viti fiskal. Të gjitha palët kishin pranuar këtë shpërfillje. Sipas Zëvendës PSSP-së, hekurudhat e UNMIK-ut dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave kishin arritur një zgjidhje të përkohshme, në bazë të së cilës ky shërbim duhej të financohej. Ai nuk i dinte arsytet të cilat kishin sjellur deri te suspendimi i linjes gjatë muajit maj. Zëvendës PSSP-ja për më tepër informonte Ombudspersonin se një zgjidhje tjetër e përkohshme ishte gjetur dhe se PSSP-ja kishte aprovuar mjete tjera për financimin e operacioneve të linjes së lartëpërmendur deri në fund të vitit 2004.

### **Sigurimi i mundësisë për njerëzit e zhvendosur brenda vendit nga Kosova që janë duke qëndruar në Mal të Zi për të marrë pjesë në zgjedhjet në Serbi**

**2 qershor 2004:** Ombudspersoni i dërgoi një letër Kryetarit të Komisionit Republikian të Zgjedhjeve në Serbi, duke ia drejtuar vëmendjen rreth mundësisë që personat e zhvendosur brenda vendit që janë duke qëndruar në Mal të Zi, të merrnin pjesë në zgjedhjet e ardhshme presidenciale në Serbi. Ombudspersoni theksoi se, sipas ligjit të aplikueshëm në Serbi, çdo qytetar i Serbisë kishte të drejtë vote. Sidoqoftë, personat e zhvendosur brenda vendit me qëndrim në Mal të Zi nuk ishin në gjendje të merrnin pjesë në zgjedhjet parlamentare të Serbisë të mbajtura në dhjetor 2003. Më tutje Ombudspersoni theksoi se gjatë dhe pas zgjedhjeve, serbët që jetonin jashtë nuk kishin pasur probleme në dorëzimin e votes. Ombudspersoni kërkoi nga Komisioni Republikian i Zgjedhjeve ta informonte atë se në çfarë mënyre Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve mendonte ti krijonte mundësinë për të votuar njerëzve që po qëndronin në Mal të Zi.

**4 qershor 2004:** Ombudspersoni pranoi letër nga Kryetari i Komisionit Republikian të Zgjedhjeve në Serbi, në të cilën, mes tjerash, ky i fundit sqaronte se nuk ishte e mundur që në Serbi të organizohej pjesëmarrja në zgjedhjet e ardhshme presidenciale për personat që përkohësisht qëndronin në Mal të Zi, pasi që autoritetet Serbe nuk kishin juridiksion ose kompetenca në Mal të Zi.

**8 qershor 2004:** Ombudspersoni i dërgoi faks urgjent Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, duke shprehur shetësimin e tij lidhur me situatën e lartëpërmendur. Në veçanti,

Ombudspersoni theksoi se për shkak të problemeve të brendshme në mes të dy etnive që përbëjnë Unionin Serbi-Mal i Zi, personat e zhvendosur nga Kosova në Mal të Zi nuk ishin në gjendje të ushtronin të drejtën e tyre për të marrë pjesë në zgjedhjet e ardhshme presidenciale, dhe kështu ata privoheshin nga e drejta themelore në demokraci funksionale. Duke pasur parasysh faktin se Unioni Serbi-Mal i Zi ishte anëtar i Këshillit të Evropës dhe se për këtë arsye ishte e obliguar të respektojë principet themelore dhe vlerat e këtij organi, ai kërkonte informata rreth reagimit të Këshillit të Evropës ndaj kësaj çështjeje.

**18 qershor 2004:** Ombudspersoni pranoi letër nga Sekretari i Përgjithshëm i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, duke informuar Ombudspersonin se Asambleja nuk kishte monitoruar zgjedhjet në nivel kombëtar, por në të njëjtën kohë letra e Ombudspersonit i ishte dërguar komitetit monitorues të Asamblesë, kështu që ky komitet mund të merrte parasysh çështjet e ngritura marrë parasyshë procedurën e vazhdueshme monitoruese lidhur me Serbinë dhe Malin e Zi.

**25 qershor 2004:** Ombudspersoni pranoi letër nga Sekretari Përgjithshëm i Këshillit të Evropës, në të cilën ai theksonte përkushtimin e Këshillit të Evropës për respektimin e plotë të të drejtave demokratike dhe njerzore për të gjithë qytetarët e Kosovës. Ai poashtu i dërgoi Ombudspersonit një kopje të letrës të cilën ia kishte dërguar Ministrin të Jashtëm të Serbisë dhe Malit të Zi, në të cilën shprehte keqardhjen e tij lidhur me heqjen e të drejtës të votimit personave të zhvendosur nga Kosova brenda Unionit Shtetëror Serbi-Mal i Zi. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës shpreh zhgënjimin e tij rreth faktit se Republika e Serbisë kishte qenë në gjendje të bëjë përpjekje të rëndësishme që të lejoj qytetarët që jetonin jashtë vendit të votonin, por nuk kishte bërë përpjekje që të sigurohe po atë mundësi për personat e zhvendosur që qëndronin në Mal të Zi.

### **Kalimi i afatit të parashkrimit për padi civile**

**9 qershor 2004:** Ombudspersoni i dërgoi një letër Ushtresit të Detyrës të PSSP-së, me të cilën i drejtonte vëmendjen këtij të fundit në kalimin e afatit të parashkrimit për padi civile sipas ligjit të aplikueshëm në Kosovë. Ombudspersoni vërejti që, si pasojë e konfliktit të vitit 1999, shumë pjestarë të komuniteteve jo-shqiptare në Kosovë ishin zhvendosur apo ishin detyruar të lëshojnë shtëpitë e tyre. Në të njëjtën kohë, gjykatat në Kosovë nuk kishin funksionuar për një kohë të caktuar dhe zyrtarisht kishin vazhduar me punë vetëm pas disa muajsh apo në disa raste pas një viti. Edhe pas konfliktit, situata e sigurisë i kishte ndaluar një numër të madhë të personave të lartpërmendur që t'i qasen gjykatave kompetente. Në shumë raste kur këta njerëz kishin ndërmend të paraqesin padi civile pranë gjykatës, periudhat e parashkrimit për këto padi mund të kishin kaluar ose mund të kalonin brenda një kohe të shkurtër. Ombudspersoni kërkoi nga Ushtresi i Detyrës PSSP-së që ky i fundit të gjejë një zgjidhje me të cilën këtij grupi njerëzish do ti mundësohej që edhe më tej të vazhdojnë procedurën rreth padive të tyre përkundër faktit që periudhat përkatëse të parashkrimit mundë të kenë kaluar ose do të kalojnë shumë shpejt.

**Nuk ka pasur përgjegjje në këtë letër.**

**Mundësitë e barabarta për personat me të meta fizike në përdorimin e automjeteve**


*Gjatë takimit me Kryetarin e Handikos-it, një OJQ e cila merret me personat me të meta fizike, përfaqësuesit e Ombudspersonit, në mes tjerash, pranuan një ankesë lidhur me mungesën e mundësive që personat me të meta fizike të marrin patent shoferin. Me sa duket, autoshkollat private nuk posedonin automjete speciale të adaptuara për vozitës të*

*tillë. Nuk kishte as garazha speciale në të cilat këta persona do të mund të adaptonin automjetet e tyre në mënyrë që të plotësoheshin nevojat e tyre speciale. Përveç kësaj, instruktorët e vozitjes nuk kanë ndjekur trajnimin e domosdoshëm për t'i mësuar vozitjen personave me të meta fizike. Kryetari i Hendikos-it theksoi se nuk ekzistonte asnjë rregullore për identifikimin e automjeteve për persona me të meta fizike, situatë kjo e cila solli shumë implikime praktike serioze, siç janë situatat në të cilat personat janë konsideruar të kenë shpërfillur urdhërat e policëve, kur janë urdhëruar të dilinin jashtë automjetit për kontrolla rutinore të trafikut.*


**17 qershor 2004:** Ombudspersoni i dërgoi një letër Ministrin të Transportit dhe Telekomunikacionit, duke shprehur brengosjen e tij për situatën e lartëpërmendur dhe duke kërkuar nga ai që të ndërmarë të gjitha masat përkatëse për të shmangur diskriminime të tilla.

**Nuk ka pasur përgjegjje për këtë letër.**

## Aneksi 5. Skema Organizative e Institucionit të Ombudspersonit



Institucioni i Ombudspersonit  
Skema Organizative



## **Aneksi 6: Lista e stafit**

### Anëtarët e stafit (më 30 qershor 2004)

<b>Ombudspersoni</b>	<b>Marek Antoni Nowicki</b>
<b>Zëvendës i Ombudspersonit</b>	<b>Ljubinko Todorovic</b>
<b>Zëvendës i Ombudspersonit</b>	<b>Hilmi Jashari</b>
<b>Drejtor Ekzekutiv</b>	<b>Agron Berisha</b>
<b>Drejtor i Hetimeve</b>	<b>Veton Vula</b>
<b>Zëvendëse e Drejtorit për Projekte Speciale</b>	<b>Violeta Rexha</b>
<b>Zëvendës Drejtor i i Hetimeve për Zyre Rajonale</b>	<b>Sefadin Blakaj</b>
<b>Jurist i Lartë, Prishtinë</b>	<b>Gjylbehare Murati</b>
<b>Jurist i Lartë, Prishtinë</b>	<b>Avni Hasani</b>
<b>Jurist i Lartë, Prishtinë</b>	<b>Dragana Ristic</b>
<b>Kryesues i Zyrës Rajonale në Gjilan</b>	<b>Goroljub Pavic</b>
<b>Kryesues i Zyrës Rajonale në Mitrovicë</b>	<b>Naim Krasniqi</b>
<b>Kryesues i Zyrës Rajonale në Pejë</b>	<b>Ilijana Çollaku</b>
<b>Kryesues i Zyrës Rajonale në Prizren</b>	<b>Murlan Prizreni</b>
<b>Jurist, Prishtinë</b>	<b>Enis Shatri</b>
<b>Jurist për GDF</b>	<b>Thëllënza Arifi</b>
<b>Jurist për GMD</b>	<b>Dragana Rodic</b>
<b>Jurist për GMD</b>	<b>Merita Syla</b>
<b>Jurist, Mitrovica veriore</b>	<b>Miljana Scekić</b>
<b>Jurist, Pejë</b>	<b>Besim Tafa</b>
<b>Jurist, Prizren</b>	<b>Hunaida Pasuli</b>
<b>Asistent Special i Ombudspersonit</b>	<b>Leonora Visoka</b>
<b>Zyrtar për Informim dhe Media</b>	<b>Ibrahim Arslan</b>
<b>Drejtor i Administratës</b>	<b>Përparim Vula</b>

<b>Përgjegjës për IT</b>	<b>Flamur Gogolli</b>
<b>Zyrtar për prokurim</b>	<b>Gëzim Latifi</b>
<b>Udhëheqëse e Përkthyesve/Asistentëve Ligjor, Prishtinë</b>	<b>Branislava Stojilovic</b>
<b>Përkthyes i Lartë/Asistent Ligjor, Prishtinë</b>	<b>Lirak Hamiti</b>
<b>Përkthyes/Asistent Ligjor, Prishtinë</b>	<b>Safete Sadrija</b>
<b>Përkthyes/Asistent Ligjor, Prishtinë</b>	<b>Alban Stafai</b>
<b>Përkthyes/Asistent Ligjor, Prishtinë</b>	<b>Isak Skenderi</b>
<b>Përkthyes/Asistent Ligjor, Gjilan</b>	<b>Meliha Brestovci</b>
<b>Përkthyes/Asistent Ligjor, Mitrovicë</b>	<b>Merita Gara</b>
<b>Përkthyes/Asistent Ligjor, Pejë</b>	<b>Aida Nela</b>
<b>Përkthyes/Asistent Ligjor, Prizren</b>	<b>Abdullah Kryeziu</b>
<b>Asistente Ekzekutive</b>	<b>Arta Ibrahim</b>
<b>Asistente Ekzekutive</b>	<b>Shqipe Paçarada</b>
<b>Asistent Ligjor, Prishtinë</b>	<b>Venera Rizvanolli</b>
<b>Asistent Ligjor, Prishtinë</b>	<b>Xhafer Tahiri</b>
<b>Recepcionist</b>	<b>Bedri Kamberi</b>
<b>Udhëheqës i Vozitësve</b>	<b>Shpëtim Reçica</b>
<b>Vozitës</b>	<b>Sami Kuqi</b>
<b>Vozitës</b>	<b>Fatmir Pireva</b>
<b>Vozitës</b>	<b>Goran Stevic</b>
<b>Udhëheqës i Rojtarëve</b>	<b>Bekim Bunjaku</b>
<b>Rojtar</b>	<b>Xhevat Cakolli</b>
<b>Rojtar</b>	<b>Tamer Gas</b>
<b>Rojtar</b>	<b>Gëzim Hadri</b>
<b>Rojtar</b>	<b>Skender Krasniqi</b>
<b>Rojtar</b>	<b>Mentor Myftari</b>



<b>Rojtar</b>	<b>Avni Osmani</b>
<b>Rojtar</b>	<b>Besim Osmani</b>
<b>Rojtar</b>	<b>Arben Plakaj</b>
<b>Pastruese</b>	<b>Vesna Cvejic</b>
<b>Pastruese</b>	<b>Nekibe Hoxha</b>

Këshilltarët Ndërkombëtarë (më 30 June 2004)

<b>Këshilltare Ndërkombëtare e Drejtorit Ekzekutiv</b>	<b>Antonella Ingravallo</b>
<b>Këshilltare Ndërkombëtare e Drejtorit të Hetimeve</b>	<b>Alice Thomas</b>
<b>Këshilltare Ndërkombëtare për Projekte Speciale</b>	<b>Francesca Marzatico</b>

Personat që u larguan nga Institucioni i Ombudspersonit gjatë periudhës për të cilën raportohet

**Donna Gomien (Zëvendëse ndërkombëtare e Ombudspersonit, më vonë Konsultante Ndërkombëtare)**

**Nikë Lumezi (Zëvendës i Ombudspersonit)**

**Halit Kadriu (Drejtor Ekzekutiv)**

**Mexhit Berisha (Head of the Field Office in Gjilan/Gnjilane)**

**Gabbriella Yates (Konsultante Ndërkombëtare për Projekte Speciale)**

**Nebojsa Boricic (Jurist i Lartë, Prishtinë)**

**Isuf Mehmeti (Zyrtar për Financa)**

**Atogent Gojani (Asistent Ligjor/Përkthyes)**

**Dua Dauti (Asistent Ligjor)**

**Aleksandar Simic (Vozitës)**

**Zoran Stojilovic (Vozitës)**

**Ilir Rraci (Vozitës)**

**Liridon Xërxa (Rojtar)**

**Atila Gorica (Rojtar)**

**Remzije Haliti (Pastruese)**

## **Aneksi 7: Lista e shkurtesave**

CR-Rastet	Rastet për Veprim (një kategori speciale e rasteve në Institucionin e Ombudspersonit)
GDF	Grupi për të Drejtat e Fëmijëve pranë Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë
ZPSSP	Zëvendësi i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm
KEDNj	Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore
IRJM	Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë
DÇPB	Drejtoria e KB-ve për Çështje Pronësore dhe Banesore
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KFOR	Forcat e NATO-s në Kosovë
SHPK	Shërbimi Policor i Kosovës
NATO	Aleanca Veri-Atlantike
GMD	Grupi për Mos-diskriminim pranë Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë
OJQ	Organizata joqeveritare
ZIDDNj	Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
IPVQ	Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
KB	Kombet e Bashkuara
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë